



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

17/2019

# KRIMET E PËRGJITHSHME NË KOSOVË, ligji VS praktika

Prishtinë, nëntor 2019

Autorët: Gzime Hashani dhe Mirvet Thaqi

Ekipi i Redaktorëve: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Yll Zekaj dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

#### RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

Nëntor 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

## Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive .....	5
II.	Metodologjia.....	7
III.	Korniza ligjore dhe garancat kushtetuese .....	8
IV.	Mandati ligjor i Prokurorive dhe Gjykatave në trajtimin e krimeve të përgjithshme .....	9
V.	Ngarkesa totale me lëndë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës .....	11
	Ngarkesa e DP-ve të GjTh-ve gjatë vitit 2018 .....	11
	Ngarkesa më lëndë dhe mënyra e kryerjes së lëndëve në DP të GjTh-ve sipas kategorive të veprave penale .....	15
VI.	Ngarkesa totale me lëndë e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës .....	22
	Ngarkesa me lëndë në DP të PTh-ve gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmuorit të parë të vitit 2019 ..	22
	Ngarkesa me lëndë në DP të PTh sipas kategorive të veprave penale dhe mënyra e kryerjes së lëndëve .....	26
VII.	Performanca e gjykatësve të DP-ve në gjashtë vitit 2018 dhe gjashtë muorit të parë të vitit 2019 .....	29
VIII.	Performanca e prokurorëve të DP-ve në PTh gjatë vitit 2018 dhe gjashtë muorit të parë të vitit 2019 .....	31
IX.	Gjetjet e IKD-së në trajtimin e rasteve të përgjithshme.....	34
X.	Anex: Analizë e detajuar e rasteve të përzgjedhura karakteristike.....	38
XI.	Rekomandimet .....	93

## Shkurtesat

DP	Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
DPDP	Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
GjTh	Gjykata Themelore
GjTHDP	Gjykata Themelore, Departamenti i Përgjithshëm
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedures Penale i Republikës së Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KRPRK	Kodi i Ri Penal i Republikës së Kosovës
LDP	Ligji për deklarimin e pasurisë
LGJ	Ligji për Gjykatat
LKGJ	Ligji për Këshillin Gjyqësor
LKP	Ligji për Këshillin Prokurorial
LPSH	Ligji për Prokurorin e Shtetit
PTH	Prokuroria Themelore

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 ka ndërmarr reforma si në aspektin institucional ashtu edhe atë ligjor në fushën e sistemit të drejtësisë, mirëpo sundimi i ligjit mbetet një ndër sfidat më të mëdha që po përballet vendi, pasi gjyqësori ende nuk është në gjendje që kompetencat dhe përgjegjësitë e tij t'i ushtroj në mënyrë të pavarur, të drejtë, paanshme dhe efikase.

IKD me qëllim të monitorimit të punës dhe performancës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial, gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, ka zhvilluar monitorim sistematik në të gjitha Departamentet e Përgjithshme – Divizionet Penale të të gjitha Gjykatave Themelore, në tërë territorin e Kosovës përfshirë edhe degët e tyre. IKD gjatë kësaj periudhe kohore ka monitoruar gjithsej 2,694 seanca ku përfshihen 2,015 lëndë penale.

Sipas raporteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sa i përket dënimeve të shqiptuara në këto raste, gjatë vitit 2018, dënimi më i shpeshtë që kanë shqiptuar gjyqtarët e DP-ve të GjTh-ve ka qenë dënimi me gjobë, në gjithsej 7,929 raste, pasuar nga dënimi me kusht në 7,478 raste, derisa në 848 raste gjykatat kanë shqiptuar dënim me burgim efektiv. Edhe sa i përket periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019 prinë dënimi me gjobë në gjithsej 4,245 raste, pasuar nga dënimi me kusht në gjithsej 3,485 raste, derisa në 517 raste është shqiptuar dënimi me burgim efektiv.

Por, statistika më shqetësuese sa i përket vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2019 është parashkrimi i lëndëve. Gjatë vitit 2018, sipas statistikave zyrtare të KGJK-së janë parashkruar gjithsej 2,843 raste. Prej tyre, 2,663 kanë arritur parashkrimin absolut, derisa 180 raste të tjera kanë arritur parashkrimin relativ. Nëse kalkullohet numri i lëndëve të parashkruara me numrin e ditëve gjatë një viti, atëherë rezulton se mesatarisht, në sistemin gjyqësor në Departamentet e Përgjithshme – Divizionet Penale, çdo ditë parashkruhen nga 7.7 lëndë, ndërsa çdo muaj nga afërsisht 237 lëndë. Ndërsa, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 në sistemin gjyqësor janë parashkruar gjithsej 1,269 raste, prej të cilave 1,187 raste kanë arritur parashkrimin absolut, ndërsa 82 raste të tjera kanë arritur parashkrimin relativ. Në mesatare, i bie se në DP-të e GjTh-ve, gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, çdo ditë janë parashkruar mesatarisht nga 7 raste, apo çdo muaj nga 211 lëndë.

Ndonëse akterët e sistemit gjyqësor nuk e kanë adresuar asnjëherë si duhet dukurinë e parashkrimit të rasteve brenda sistemit gjyqësor, duke thënë se kjo është dukuri në rënie për shkak të ngritjes së numrit të gjyqtarëve, statistikat thonë ndryshe.

Nga raportet vjetore zyrtare të Prokurorit të Shtetit, vërehet se në raport me numrin e lëndëve të kryera, përqindja e numrit të lëndëve të zgjidhura në Prokurorin e Shtetit ka rënë vazhdimisht në mënyrë rapide, derisa numri i lëndëve të pranuar ka qenë jo edhe shumë më i lartë.

Nëse krahasohen numri i lëndëve që kanë pranuar në punë Departamentet e Përgjithshme të shtatë (7) Prokurorive Themelore gjatë vitit 2018, dhe numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë këtij viti, del se efikasitetin më të lartë në zgjidhjen e lëndëve e ka pasur PTh në Mitrovicë, e

cila nga gjithsej 6.449 lëndë sa kishte pranuar në punë gjatë këtij viti, ka arritur të zgjidhë 12.465 prej tyre, apo shprehur në përqindje 193 %. Ndërsa, efikasitetin më të ulët në zgjidhjen e lëndëve gjatë kësaj periudhe raportuese e ka pasur PTh në Prishtinë, e cila nga gjithsej 15.008 lëndë sa ka pranuar në punë gjatë vitit 2018, ka arritur që deri në fund të zgjidhë vetëm 11,647 sosh, apo shprehur në përqindje 78 %. Ndërsa, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 performancën më të mirë e ka pasur Departamenti i Përgjithshëm i PTh në Pejë, derisa efikasitetin më të ulët e ka pasur Departamenti i Përgjithshëm i PTh në Mitrovicë.

Ndërsa sa i përket trendit të efikasitetit të sistemit prokurorial ndër vite, IKD vlerëson se është e pamundur që të arrihet deri tek vlerësimet e tilla lidhur me trendin e efikasitetit të Prokurorit të Shtetit dhe kjo për shkak të paqartësive numerike që janë evidentuar në këto raporte.

IKD vlerëson se është e papranueshme kjo qasje e Prokurorit të Shtetit në raportet vjetore të saj. Prokurori i Shtetit duhet të jetë i vetëdijshëm se Raporti Vjetor i këtij institucioni është dokumenti më i rëndësishëm lidhur me punën e realizuar gjatë një viti. Për këtë arsye, nuk lejohet që ky raport të ndërtohet mbi shabllone të caktuara, nga të cilat më së paku kupton publiku, mediat dhe shoqëria civile. Për këtë arsye, sikurse në raportet periodike të IKD-së mbi punën e sistemit prokurorial, IKD vlerëson se këto raporte duhet të jenë raporte analitike dhe të qarta, e mbi të gjitha, të sakta.

Në anën tjetër, KGJK ka bërë një hap progresiv në kuptim të transparencës, ku ka publikuar raportin vjetor për punën individuale të gjyqtarëve, në të cilin raport pasqyrohet numri i lëndëve të kryera nga secili gjyqtar. Në këtë rast, IKD ka analizuar këtë raport, ku ka gjetur se ka një disbalance jashtëzakonisht të madh në numrin e lëndëve të kryera në mesin e gjyqtarëve.

Njëra ndër sfidat më të mëdha të sistemit të drejtësisë në Kosovë vazhdon të mbetet mungesa e efikasitetit në trajtimin e rasteve. Sipas të dhënave të IKD-së të nxjerra nga monitorimi i secilit rast, Divizioneve Penale të Gjykatave Themelore vetëm për caktimin e shqyrtimit fillestar pas ngritjes së aktakuzës i janë nevojitur mesatarisht 619 ditë, ndonëse sipas KPPK-së, *“Gjykata është e obliguar që seancën fillestare ta mbaj brenda 30 ditësh pas ngritjes së aktakuzës”*.

Në këtë raport IKD ka gjetur edhe mungesë të koordinimit me rastin e zhvillimit të hetimeve nga ana e prokurorisë, e cila ka bërë që të ngriten aktakuza gabimisht, ndaj personave të vdekur, e ndaj personave të gjykuar më parë për veprën e njëjtë penale. Po ashtu, IKD ka gjetur edhe një tendencë të Prokurorit të Shtetit që t'i mbajë të fshehura për publikun aktakuzat e ngritura për të cilat opinioni publik ka një interes të theksuar.

Për më tepër, IKD në këtë raport ka evidentuar edhe ngritje të aktakuzave dhe dënime nga Gjykatat për veprat penale të rëndësisë së vogël. Ndërsa në anën tjetër, IKD ka gjetur se përkundër rritjes së disa dukurive kriminale, dënimet e gjykatave nuk janë rritur, në mënyrë që këtyre dukurive tu ipet përgjigje me anë të aktgjykimeve përfundimtare.

## II. METODOLOGJIA

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve në Departamentet e Përgjithshme – Divizionet Penale në sistemin prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare (*legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të ndryshme zyrtare të KGJK-së, raporte të ndryshme zyrtare të KPK-së si dhe të dhëna të tjera të siguruara nga këto institucione përmes kërkesave për qasje në dokumente publike*). Sa i përket të dhënave statistikore të sistemit prokurorial, të njëjtat janë të paqarta dhe nuk përputhen me periudha të ndryshme raportuese, çfarë ndikon në paqartësinë e trendit të efikasitetit në sistemin prokurorial.

Përpos këtyre dokumenteve, draftimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve në Departamentet e Përgjithshme – Divizionet Penale. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD tanimë ka lansuar për publikun edhe Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor.

Ky raport përfshin monitorimin e këtyre rasteve në Departamentet e Përgjithshme të shtatë (7) Prokurorive Themelore dhe Departamentet e Përgjithshme – Divizionet Penale të shtatë (7) Gjykatave Themelore, përfshirë edhe degët e tyre, për periudhën kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019<sup>1</sup>. Për të njëjtën periudhë kohore, raporti i bënë një trajtim të veçantë disa prej rasteve karakteristike, të cilat janë monitoruar nga IKD.

IKD në këtë raport ka analizuar ngarkesën me lëndë të këtyre departamenteve, trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, performancës individuale të Prokurorëve dhe Gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport jep edhe vlerësimet dhe rekomandimet.

---

<sup>1</sup> *Sqarim:* Për qëllime praktike, në këtë raport në rastin e Prokurorisë do ti referohemi si Departamenti i Përgjithshëm, ndërsa në rastin e Gjykatave, Divizionet Penale. Ndërsa, rasteve të cilat trajtohen në këto departamente, do ti referohemi si rastet e përgjithshme apo krimet e përgjithshme.

### III. KORNIZA LIGJORE DHE GARANCAT KUSHTETUESE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka materializuar standardet më të larta në lidhje me garancinë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta si akti më i lartë juridik i vendit, me të cilin duhet të jenë në harmoni të gjitha aktet e tjera ligjore e nënligjore.

Në kuptim të betonizimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Kushtetuta e Republikës së Kosovës këto të drejta dhe liri i ka përcaktuar në kapitullin e II-të të saj. Për nga numri i neneve, ky kapitull ka numrin më të madh të tyre, krahasuar me kapitujt e tjerë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Përpos të drejtave kushtetuese të përcaktuara në kapitullin e II-të të Kushtetutës, ky akt në nenin 22 të tij ka përcaktuar edhe tetë (8) Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, të cilat zbatohen drejt për së drejti në sistemin juridik të Republikës së Kosovës si dhe në rast konflikti, kanë epërsi ndaj akteve të tjera të brendshme.<sup>2</sup>

Sa i përket interpretimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Kushtetuta ka përcaktuar si pikë relevante jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi në nenin 53 të saj ka përcaktuar se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Për më tepër, vet Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka mbrojtur kapitullin e II-të edhe nga amandamentimi, përkatësisht mos lejimit të zvogëlimit të të drejtave të njeriut përmes amandamentimit kushtetues.<sup>3</sup>

Në këtë mënyrë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndërtohet fund e krye mbi bazën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, duke afirmuar kështu standardet më të larta ndërkombëtare në këtë fushë. Në këtë drejtim, edhe sa i përket personave të pandehur, Kushtetuta ka paraparë të drejta të shumta, në mënyrë që të sigurohet një proces i rregullt gjyqësor.

Kushtetuta ndërtohet mbi parimin e ndarjes së pushteteve. Në lidhje me pushtetin gjyqësor, Kushtetuta përcakton se *“Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga*

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 22. *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”*

<sup>3</sup> Po aty, neni 144.3. *“Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”*.



*gjykatat*”<sup>4</sup> dhe se “*Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata*”<sup>5</sup>.

Në lidhje me Gjykatat, Kushtetuta e Republikës së Kosovës organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e lë në rregullim të ligjit. Në këtë kuptim, Kushtetuta përcakton se “*Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohet me ligj*”<sup>6</sup>.

#### IV. MANDATI LIGJOR I PROKURORIVE DHE GJYKATAVE NË TRAJTIMIN E KRIMEVE TË PËRGJITHSHME

Në kuptim të zbatimit të këtij obligimi kushtetues, Kosova ka miratuar Ligjin për Gjykatat. Më 1 janar 2013 kishte hyrë në fuqi Ligji i ri për Gjykatat, i cili kishte ndryshuar edhe strukturën e sistemit gjyqësor që ishte në të kaluarën. Ky ligj ka pësuar ndryshime jothelbësore me miratimin e Ligjit të ri për Gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019.

Sipas Ligjit për Gjykatat, sistemi i gjykatave të Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Secila prej shtatë (7) Gjykatave Themelore kanë edhe degët e tyre. Po ashtu, ky ligj përcakton edhe strukturën e brendshme për secilën gjykatë. Sipas këtij ligji, secila Gjykatë Themelore, përfshi edhe degën e saj, ka Departamentin e Përgjithshëm, derisa në secilën seli të Gjykatës Themelore veprojnë Departamenti i Krimeve të Rënda, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti i Përgjithshëm. Për dallim nga gjashtë (6) gjykatat e tjera Themelore, në Gjykatën Themelore të Prishtinës funksionon edhe Departamenti Special për Lëndët e PSRK-së, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike.

Sa i përket Departamentit të Përgjithshëm, ky departament organizohet në tri divizione: Penal, Civil dhe për Kundërvajtje.

Departamenti i Përgjithshëm i GjTh-ve, sipas nenit 20.1 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, të cilat nuk hyjnë në kompetencë të departamenteve të tjera. Në rastin e Divizionit Penal, i cili është objekt i trajtimit në këtë raport, kompetenca e këtij divizioni absorbohet vetëm nga DKR-të, të cilat parimisht gjykojnë lëndët e dënueshme me mbi 10 vite dënim. Pra, lëndët për veprat penale të dënueshme nën 10 vite, parimisht gjykohen nga divizionet penale të departamenteve të përgjithshme. Rregullim i njëjtë për sa i përket Divizionit Penal të Departamentit të Përgjithshëm është edhe në GjA<sup>7</sup>.

Aktualisht, në të gjitha divizionet penale janë të angazhuar 97 gjyqtarë<sup>8</sup>.

<sup>4</sup> Po aty. Neni 102.1

<sup>5</sup> Po aty. Neni 102.2

<sup>6</sup> Po aty. Neni 103.1

<sup>7</sup> Nr. 06/L – 054 për Gjykatat. Neni 24

<sup>8</sup> Përgjigje zyrtare nga KGJK. 23 shtator 2019

Në anën tjetër, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj<sup>9</sup>. Sikurse në rastin e sistemit gjyqësor, edhe për Prokurorin e Shtetit, Kushtetuta ka përcaktuar se organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit përcaktohen me ligj.

Për të zbatuar këtë obligim kushtetues, Republika e Kosovës ka miratuar Ligjin për Prokurorin e Shtetit<sup>10</sup>. Sipas këtij ligji, sikurse në rastin e Gjykatave, në sistemin prokurorial funksionojnë shtatë (7) Prokurori Themelore, Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKSH). Përpos këtyre prokurorive, me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës është themeluar edhe PSRK-ja, si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit<sup>11</sup>.

Po ashtu, Kushtetuta ka përcaktuar edhe institucionet që për detyrë kanë administrimin e drejtësisë. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka themeluar si institucione Kushtetuese KGJK-në dhe KPK-në. Për të dy këto institucione, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligje të veçanta.

---

<sup>9</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 109.1

<sup>10</sup> Ligji Nr. 03/L-225 Për Prokurorin e Shtetit, ndryshuar me ligjet nr.05/L-034 dhe nr. 06/L-025

<sup>11</sup> Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Neni 1.1

## V. NGARKESA TOTALE ME LËNDË E SISTEMIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Me qëllim të pasqyrimin sa më të saktë të punës ndër vite të gjykatave të Republikës së Kosovës, me theks të veçantë Departamentit të Përgjithshëm, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë që nga viti 2016 deri më 30 qershor 2019.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK-ja publikon çdo vit kalendarik, Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë gjithsej 831,376 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 465,800 apo 56% të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 365,505 lëndë apo 44% të lëndëve.

Gjatë vitit 2017, Gjykatat Themelore kanë pasur në punë gjithsej 569,373 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 295,358 apo 52 % të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 273,888 apo 48% të lëndëve.

Gjatë vitit 2018, Gjykatat Themelore kanë pasur në punë 375,136 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 163,978 ose 44%, ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 211,049 ose 56%.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, Gjykatat Themelore kanë pasur në punë 255,118 lëndë, prej të cilave gjatë kësaj periudhe i kanë zgjidhur 66,753 apo 26%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 188,260 apo 74% e lëndëve.

Sipas këtyre statistikave, vërehet se Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës në vitin 2016 kanë zgjidhur 56% të lëndëve, në vitin 2017, 52% ndërsa në vitin 2018, 44% të lëndëve, që sipas këtyre përqindjeve vërehet se gjykatat themelore çdo vit ulin numrin e lëndëve të zgjidhura.

### **Ngarkesa e DP-ve të GjTh-ve gjatë vitit 2018**


DP-të e GjTh-ve, gjatë vitit 2016, kanë trashëguar 38,549 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 22,715 lëndë, derisa kanë pasur në punë gjithsej 61,264 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 20925, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 40,329. Pra, gjatë vitit 2016, DP-të e Gjykatave Themelore kanë zgjidhur 34% të lëndëve në punë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 66% të lëndëve.

Gjatë vitit 2017, DP-të e GjTh-ve kanë trashëguar 40,329 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 25,392 lëndë, derisa kanë pasur në punë gjithsej 65,721 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 23,641, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 42,063. Pra, gjatë vitit 2017, DP-të e Gjykatave Themelore kanë zgjidhur 36% të lëndëve në punë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 64% të lëndëve.

Gjatë vitit 2018, DP-të e GjTh-ve kanë trashëguar 42,116 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 22,300 lëndë, derisa kanë pasur në punë gjithsej 64,416 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 24,278 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 40,118 lëndë. Pra, gjatë vitit 2018,

DP-të e Gjykatave Themelore kanë zgjidhur 37.5% të lëndëve në punë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 62.5% të lëndëve.

Gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, DP-të e GjTh-ve kanë trashëguar 40,118 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 9,642 lëndë, derisa kanë pasur në punë gjithsej 49,760 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 15,132 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 34,619 lëndë. Pra, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, DP-të e Gjykatave Themelore kanë zgjidhur 30.5% të lëndëve në punë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 69.5% të lëndëve.



**Grafika 1: Përqindja e lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura në Divizionet Penale gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe gjashtë mujorit të parë 2019.**

Në gusht të vitit 2013, KGJK-ja kishte miratuar Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra. Në parathënie të kësaj strategjie thuhej decidivisht se “reduktimi i lëndëve të vjetra është një nga çështjet më kritike me të cilat përballet gjyqësori i Kosovës.”<sup>12</sup>

Ndërsa, Në vitin 2014, KGJK ka miratuar Planit Strategjik të Gjyqësorit të Kosovës për vitet 2014-2019. Në këtë Plan Strategjik është inkorporuar edhe Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, për zbatimin e së cilës strategji, ishin parë veprime shtesë.

Ndër të tjera, në këtë drejtim, kjo strategji ka paraparë “Krijimi i procedurave dhe mjeteve, përfshirë analizën e rëndësisë së lëndëve, për t’i analizuar nevojat e gjyqtarëve dhe gjykatave dhe për t’i miratuar aktet nënligjore përkatëse” dhe “Shpërndarja periodike e gjyqtarëve duke u bazuar në numrin e lëndëve”. Sa i përket Departamenteve të Përgjithshme, KGJK nuk ka

<sup>12</sup> “Strategjia Kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra”. KGJK. Gusht 2013. (<http://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/2019/03/Strategjia-kombetare-per-reduktimin-e-lendeve-te-vjetra.pdf>). (Qasur së fundi më 15 gusht 2019).

ndërmarrë asnjërën prej këtyre veprimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit të kësaj strategjie.

Po ashtu, për reduktimin e numrit të lëndëve, KGJK në këtë strategji kishte përcaktuar *“Zhvillimin e një hulumtimi për të përcaktuar nëse ankesat e shumta që i parashtrohen Gjykatës së Apelit po e shtojnë pa arsye zgjidhjen përfundimtare të lëndëve”* dhe *“Caktimin e standardeve për afatet kohore për kryerjen e lëndëve dhe caktimi i procedurës standarde të shpërndarjes së lëndëve”*.

Të gjitha këto planifikime të KGJK-së të përcaktuara në planin e veprimit të kësaj strategjia kanë mbetur politika në letër, të cilat KGJK nuk i ka përmbyshur.

Për këtë arsye, përkundër përcaktimit të këtyre objektivave dhe veprimeve nga KGJK, synimi që numri i lëndëve të vjetra brenda sistemit gjyqësor të reduktohej si dhe të vendoset stabilitet brenda sistemit gjyqësor, nuk është arritur në DP-të e GjTh-ve. Për këtë arsye, ende nuk mund të themi se në sistemin gjyqësor, në rastin konkret në DP-të e GjTh-ve, është arritur një stabilitet sa i përket numrit të madh të lëndëve të cilat barten vit pas viti. Por, në rreshtat pasues vërtetohet se ndonëse DP-të nuk kanë arritur ende stabilitetin e kërkuar, jo stabiliteti tanimë është lokalizuar, në atë mënyrë që DP-të kanë hyrë në binarë drejt gjetjet së stabilitetit të kërkuar.

Ulja relative e numrit të madh të lëndëve të vjetra të pazgjidhura në fund të një periudhe raportuese është rrjedhë e natyrshme e rritjes së numrit të gjyqtarëve. Sidoqoftë, për dallim nga DP-të, rritja e numrit të gjyqtarëve nuk kishte reflektuar me rritjen e numrit të lëndëve të zgjidhura në DKR-të e GjTh-ve<sup>13</sup>.

Numri i lëndëve të zgjidhura është rritur relativisht shumë gjatë vitit 2019, kur DP-ve të GjTh-ve i janë shtuar edhe 17 Gjyqtarë të rinjë në nivel vendi.

Në këtë drejtim, numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 ka rënë për 5,490, pasi DP-të e GjTh-ve kanë zgjidhur 5,490 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar. Në total, më 30 qershor 2019 kanë mbetur të pazgjidhura edhe 34,619 lëndë, që i bie se DP-ve të GjTh-ve, për t'i përfunduar lëndët e pazgjidhura të cilat barten vit pas viti i duhen më shumë se 3 vite për t'i zgjidhur këto lëndë, që i bie deri në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2022.

Pra, ndonëse aktualisht nuk bëhet fjalë për stabilitet të DP-ve të GjTh-ve me lëndë, nëse vazhdohet sipas këtij trendi, ky stabilitet pritet të arrihet në një periudhe kohore optimale.

Përpos numrit të lëndëve të DP-ve në të gjitha Gjykatat, IKD në tabelën më poshtë ka analizuar edhe ngarkesën e secilit DP të 7 GjTh-ve:

---

<sup>13</sup> Pergega S., Shahini Grajçevci V., *“Krimet e Rënda në Kosovë - Ligji Vs. Praktika”*. IKD. Shtator 2019. f.11 (shih linkun [https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Raporti-p%C3%ABr-Krimet-e-R%C3%ABnda\\_21.09.201-FINAL-1-1.pdf](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Raporti-p%C3%ABr-Krimet-e-R%C3%ABnda_21.09.201-FINAL-1-1.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019).

	2018	Në punë	Të zgjidhura	Përqindja %	Të pazgjidhura	Përqindja %	Gjashtëmujori 2019	Në punë	Të zgjidhura	Përqindja %	Të pazgjidhura	Përqindja %
<b>Prishtinë</b>		26246	8667	34%	35110	66%		20631	6032	29%	14600	71%
<b>Mitrovicë</b>		5213	1734	34%	3479	66%		5142	1696	33%	3443	67%
<b>Gjilan</b>		6651	2638	40%	4013	60%		5004	1392	27%	3633	73%
<b>Ferizaj</b>		8136	2919	36%	5216	64%		6279	1740	28%	4538	72%
<b>Pejë</b>		4976	2540	51%	2483	49%		3542	1235	35%	2304	65%
<b>Prizren</b>		8311	3848	46%	4463	54%		5565	2051	37%	3514	63%
<b>Gjakovë</b>		4829	1932	40%	2892	60%		3597	1007	29%	2588	71%

**Tabela 1: Ngarkesa me lëndë dhe efikasiteti i DP-ve të GjTh-ve gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2019.**

Në bazë të kësaj tabele shihet se si në vitin 2018 ashtu edhe në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, DP më i ngarkuar me lëndë ka qenë ai i GjTh në Prishtinë, derisa në të dy periudhat raportuese më së paku ka qenë i ngarkuar DP i GjTh në Pejë.

Sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve në punë, në vitin 2018 prinë DP i GjTh në Pejë me 51% të lëndëve të zgjidhura ndërsa përqindjen më të vogël në këtë rast e ka DP i GjTh në Prishtinë dhe DP i GjTh në Mitrovicë.

Ndërsa, sa i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2019, në raport me numrin e lëndëve në punë, përqindjen më të lartë të lëndëve të kryera e ka DP i GjTh në Prizren, ndërsa përqindjen më të ulët e ka DP i GjTh në Gjilan.

## **Ngarkesa më lëndë dhe mënyra e kryerjes së lëndëve në DP të GjTh-ve sipas kategorive të veprave penale**

Gjatë vitit 2018, DP-të e GjTh-ve më së shumti kanë qenë të ngarkuara me lëndë nga kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe trupit (12,366 lëndë në punë), pasuar me veprat penale kundër shërbimeve komunale (11,923 lëndë në punë) dhe veprave penale kundër pasurisë (11,637 lëndë në punë).

Ndërsa, sa i përket zgjidhjes së lëndëve, gjatë vitit 2018 gjyqtarët e DP-ve të GjTh-ve më së shumti kanë zgjidhur lëndë nga kapitulli i veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik (gjithsej 5,700 lëndë të zgjidhura), pasuar me veprat penale kundër jetës dhe trupit (5,134 lëndë të zgjidhura) dhe veprave penale kundër shërbimeve komunale (4,138 lëndë të zgjidhura).

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuarra	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Lendet në kompetencë brenda gjykatë
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	7386	4980	12366	5134	7229	3
Veprat penale kundër shërbimeve komunale	8702	3221	11923	4138	7781	4
Veprat penale kundër pasurisë	8292	3345	11637	3941	7694	2
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	6488	5070	11558	5700	5856	2
Veprat penale kundër mjedisit	2848	1117	3965	1546	2418	1
Veprat penale kundër rendit publik	2234	560	2794	796	1998	0
Veprat penale të narkotikëve	925	1317	2242	703	1539	0
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë	1625	537	2162	715	1445	2
Veprat penale të armëve	644	998	1642	522	1118	2
Veprat penale kundër ekonomisë	722	290	1012	209	802	1
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	488	214	702	230	471	1
Veprat penale kundër sigurisë së Republikës së Kosovës	165	199	364	223	141	0
Veprat penale të korrupsionit	236	68	304	49	255	0
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	240	63	303	64	239	0
Veprat penale kundër integritetit seksual	205	67	272	68	203	1
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	124	71	195	65	129	1
Veprat penale kundër shëndetit publik	105	45	150	40	110	0
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	87	1	88	1	87	0
Veprat penale kundër njerëzimit	40	10	50	1	49	0
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	30	7	37	5	32	0
<b>Totali</b>	<b>41586</b>	<b>22180</b>	<b>63766</b>	<b>24150</b>	<b>39596</b>	<b>20</b>

Tabela 2: Ngarkesa me lëndë e DP-ve të GjTh-ve sipas kategorive të veprave penale gjatë vitit 2018.

Sa i përket dënimeve të shqiptuara, gjatë vitit 2018, dënimi më i shpeshtë që kanë shqiptuar gjyqtarët e DP-ve të GjTh-ve ka qenë dënimi me gjobë, në gjithsej 7,929 raste, pasuar nga dënimi me kusht në 7,478 raste, derisa në vetëm 848 raste gjykatat kanë shqiptuar dënim me burgim efektiv. Po ashtu, DP-të e GjTh-ve kanë shqiptuar edhe 805 dënime të tjera, derisa në



289 raste kanë nxjerrë aktgjykime liruese, ndërsa në 943 raste aktgjykime refuzuese. Ndërsa 3,019 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Por, statistika më shqetësuese sa i përket vitit 2018 është parashkrimi i lëndëve. Gjatë vitit 2018, sipas statistikave zyrtare të KGJK-së janë parashkruar gjithsej 2,843 raste. Prej tyre, 2,663 kanë arritur parashkrimin absolut, derisa 180 raste të tjera kanë arritur parashkrimin relativ.

Nëse e kalkulojmë numrin e lëndëve të parashkuara me numrin e ditëve gjatë një viti, atëherë i bie se mesatarisht, në sistemin gjyqësor çdo ditë parashkruhen nga 7.7 lëndë, ndërsa çdo muaj nga afërsisht 237 lëndë.

Ndonëse akterët e sistemit gjyqësor nuk e kanë adresuar asnjëherë si duhet dukurinë e parashkrimit të rasteve brenda sistemit gjyqësor, duke thënë se kjo është dukuri në rënie për shkak të ngritjes së numrit të gjyqtarëve, statistikat thonë ndryshe.

Lidhur me këto të dhëna, KGJK-ja duhet t'a ketë të qartë se çfarë realisht nënkupton parashkrimi i një lëndë, veçanërisht i një numri alarmues siç ishte numri i lëndëve të parashkuara gjatë vitit 2018. Thënë me fjalë të tjera, gjatë vitit 2018, sistemi gjyqësor nuk ka arritur që të jap përgjigje në 2,843 raste. Pra, 2,843 persona të dyshuar për kryerje të veprave penale kanë "shpëtuar" nga duart e drejtësisë. Po ashtu, në këto raste, është numër jashtëzakonisht i madh i palëve të dëmtuara të cilët për dëmet që atyre u janë shkaktuar nga kryerja e veprave penale nuk kanë marrë përgjigje nga sistemi gjyqësor.

Si rrjedhojë, IKD vlerëson se janë pikërisht statistika të tilla në njërin anë, dhe heshtja e akterëve të sistemit gjyqësor nga ana tjetër, faktorë të cilët ndikojnë që qytetarët të humbin besimin në sistemin e drejtësisë. Përderisa sistemi i drejtësisë funksionon në margjinat minimale sa i përket besueshmërisë së publikut, paraqitja e këtyre dukurive dhe mos adresimi i tyre nga mekanizmat e brendshëm të sistemit gjyqësor, vetëm sa ndikon që besimi i publikut në sistemin gjyqësor të bie edhe më tutje në mënyrë rapide.

Andaj, IKD vlerëson se KGJK-ja duhet të ndërmarrë masa urgjente për të adresuar këtë dukuri. Në këtë drejtim, rol të veçantë duhet të luaj edhe Komisioni për Administrimin e Gjykatave në kuadër të KGJK-së.

Në të kaluarën, nga vetë KGJK-ja ka pasur akuza se sistemi prokurorial duke i dërguar lëndët në prag të parashkrimit, po i'a le gjyqësorit "pataten e nxehtë" në duar, derisa është kërkuar analizë në këtë çështje, e cila analizë ka mbetur në stadin dhe kërkesën, të paproceduar asnjëherë në praktikë<sup>14</sup>.

---

<sup>14</sup> "Kryesuesi i KGJK-së: Prokurorët po na e lënë në dorë "pataten e nxehtë"". Betimi për Drejtësi. 1 Mars 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/kryesuesi-i-kgjk-se-prokuroret-po-na-e-lene-ne-dore-pataten-e-nxehte/>). (Qasur për herë të fundit më 3 tetor 2019).

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Denim me burgim	Denim me gjobë	Denim me kusht	Lirues	Refuzues	Denime tjera	Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Parashkrim absolut	Parashkrim relativ
Veprat penale kundër sigurisë së Republikës së Kosovës	10	117	34	2	3	14	19	22	2
Veprat penale të korrupsionit	1	9	20	1	2	2	12	2	0
Veprat penale kundër njerëzimit	0	0	1	0	0	0	0	4	0
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	183	1600	1832	40	247	221	516	466	29
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	3	10	18	7	8	1	6	9	2
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	0	0	0	0	2	0	2	1	0
Veprat penale kundër integritetit seksual	7	29	8	3	1	1	8	11	0
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	2	10	27	0	5	1	8	11	1
Veprat penale kundër shendetit publik	1	9	9	1	0	1	6	13	0
Veprat penale të narkotikëve	16	390	181	0	3	11	40	58	4
Veprat penale kundër ekonomisë	11	67	39	2	9	3	36	41	1
Veprat penale kundër shërbimeve komunale	10	464	1882	43	268	105	1045	299	22
Veprat penale kundër pasurisë	298	752	1021	83	190	144	495	901	57
Veprat penale kundër mjedisit	90	509	428	36	72	31	196	180	4
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithëshme të njerëzve dhe pasurisë	12	63	56	6	8	16	27	42	0
Veprat penale të armëve	15	286	144	2	19	15	24	9	8
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	134	3192	1309	50	47	182	372	375	39
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë	20	240	215	8	36	32	86	74	4
Veprat penale kundër rendit publik	35	182	254	4	23	25	121	145	7
<b>Totali</b>	<b>848</b>	<b>7929</b>	<b>7478</b>	<b>289</b>	<b>943</b>	<b>805</b>	<b>3019</b>	<b>2663</b>	<b>180</b>

Tabela 3: Mënyra e kryerjes së lëndëve në DP-të e GjTh-ve gjatë vitit 2018.

Sa i përket periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, DP-të e GjTh-ve më së shumti kanë qenë të ngarkuara me lëndë nga kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe trupit (9,645 lëndë në punë), pasuar me lëndët nga kategoria e veprave penale kundër shërbimeve komunale (9,391 lëndë në punë) dhe veprave penale kundër pasurisë (9,073 lëndë në punë).

Sa i përket lëndëve të zgjidhura, gjyqtarët e DP-ve të GjTh-ve në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, më së shumti lëndë kanë zgjidhur nga kategoria e veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik (4,595 lëndë të zgjidhura), pasuar me rastet e veprave penale kundër jetës dhe trupit (3,057 lëndë të zgjidhura) dhe veprave penale kundër shërbimeve komunale (2,416 lëndë të zgjidhura).

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuara	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Lendet në kompetenc brenda gjykatë
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	7255	2390	9645	3057	6585	3
Veprat penale kundër shërbimeve komunale	7847	1544	9391	2416	6973	2
Veprat penale kundër pasurisë	7710	1363	9073	2047	7025	1
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	5829	1714	7543	4595	2948	0
Veprat penale kundër mjedisit	2392	408	2800	739	2061	0
Veprat penale kundër rendit publik	2001	207	2208	373	1835	0
Veprat penale të narkotikëve	1539	578	2117	626	1490	1
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë	1451	326	1777	321	1455	1
Veprat penale të armëve	1109	518	1627	406	1221	0
Veprat penale kundër ekonomisë	806	198	1004	131	873	0
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithëshme të njerëzve dhe pasurisë	474	121	595	146	448	1
Veprat penale të korrupsionit	249	19	268	25	243	0
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	203	28	231	36	195	0
Veprat penale kundër integritetit seksual	196	30	226	19	207	0
Veprat penale kundër sigurisë së Republikës së Kosovës	138	65	203	65	138	0
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	130	40	170	40	130	0
Veprat penale kundër shëndetit publik	112	31	143	23	120	0
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	78	1	79	1	78	0
Veprat penale kundër njerëzimit	42	2	44	2	42	0
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	33	2	35	7	28	0
<b>Totali</b>	<b>39594</b>	<b>9585</b>	<b>49179</b>	<b>15075</b>	<b>34095</b>	<b>9</b>

Tabela 4: Ngarkesa me lëndë e DP-ve të GjTh-ve sipas kategorive të veprave penale në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019.

Sa i përket dënimeve të shqiptuara në këto raste, edhe gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019 prijnë dënimi me gjobë në gjithsej 4,245 raste, pasuar nga dënimi me kusht në gjithsej 3,485 raste, derisa në vetëm 517 raste është shqiptuar dënimi me burgim efektiv.

Në 136 raste DP-të e GjTh-ve kanë nxjerrë aktgjykim lirues, derisa në 725 raste të tjera kanë nxjerrë aktgjykim refuzues. Po ashtu, 4,419 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Sa i përket parashkrimit, sikurse gjatë vitit 2018, kjo dukuri ka qenë jashtëzakonisht e shprehur edhe në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019. Gjatë kësaj periudhe kohore, në DP-të e GjTh-ve janë parashkruar gjithsej 1,269 raste, prej të cilave 1,187 raste kanë arritur parashkrimin absolut ndërsa 82 raste të tjera kanë arritur parashkrimin relativ.

Në mesatare, i bie se në DP-të e GjTh-ve, gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, çdo ditë janë parashkruar mesatarisht nga 7 raste, apo çdo muaj nga 211 lëndë.

Edhe në këtë rast, vlerësimet e IKD-së janë të ngjashme me ato të cilat u prezantuan në rreshtat paraprak të këtij raporti, kur u trajtuan lëndët e parashkruara në DP-të e GjTh-ve gjatë vitit 2018.

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Denim me burgim	Denim me gjobë	Denim me kusht	Lirues	Refuzues	Denime tjera	Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Parashkrim absolut	Parashkrim relativ
Veprat penale kundër sigurisë së Republikës së Kosovës	0	39	13	0	3	0	9	1	0
Veprat penale të korrupsionit	2	7	10	0	0	2	2	2	0
Veprat penale kundër njerëzimit	2	0	0	0	0	0	0	4	0
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	131	977	922	28	145	74	490	267	23
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	2	5	12	1	3	0	8	4	1
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	0	2	3	0	0	0	2	0	0
Veprat penale kundër integritetit seksual	6	3	6	1	1	0	1	1	0
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	3	4	11	1	2	0	10	8	1
Veprat penale kundër shëndetit publik	2	7	1	0	1	1	2	3	0
Veprat penale të narkotikëve	19	427	132	0	3	6	17	17	5
Veprat penale kundër ekonomisë	6	52	24	4	5	1	18	21	0
Veprat penale kundër shërbimeve komunale	12	241	860	26	183	28	888	166	12
Veprat penale kundër pasurisë	199	495	488	28	95	53	339	331	19
Veprat penale kundër mjedisit	16	280	178	11	29	23	121	81	0
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithëshme të njerëzve dhe pasurisë	8	39	48	5	6	5	20	13	2
Veprat penale të armëve	5	219	98	5	8	3	58	7	3
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	69	1246	475	14	223	69	2318	171	10
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë	15	110	89	6	10	6	52	31	2
Veprat penale kundër rendit publik	20	91	115	6	8	6	64	59	4
Totali	517	4245	3485	136	725	277	4419	1187	82

Tabela 5: Mënyra e kryerjes së lëndëve në DP-të e GjTh-ve në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019

## VI. NGARKESA TOTALE ME LËNDË E SISTEMIT PROKURORIAL TË REPUBLIKËS SË SË KOSOVËS

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë 191,755 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 136.414 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 55.641 ose 33.35 % lëndë janë pranuar në punë gjatë vitit 2016. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 63.055 lëndë apo 33 %, ndërsa 128.700 ose 67 % e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur.

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2017 kanë pasur në punë gjithsej 185.772 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 129.531 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 56.241 ose 33.35 % janë pranuar në punë gjatë vitit 2017. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 71.230 lëndë apo 38 %, ndërsa 114.542 ose 62 % e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur.

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2018 kanë pasur në punë 179,242 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 119.454 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 59.788 lëndë ose 33.35 % janë pranuar në punë gjatë vitit 2018. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 74.031 lëndë apo 41.31 %, ndërsa 105.211 ose 58.69 % e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur.

Ndërkaq, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, nga gjithsej 133.657 lëndë në punë, janë trashëguar 106.229 lëndë, janë pranuar 27.428 lëndë, janë zgjidhur 30.329 apo 23% e lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 103.328 lëndë apo 77% e tyre.

Nga raportet vjetore zyrtare të Prokurorit të Shtetit, vërehet se në raport me numrin e lëndëve të kryera, përqindja e numrit të lëndëve të zgjidhura në Prokurorin e Shtetit ka rënë vazhdimisht në mënyrë rapide, derisa numri i lëndëve të pranuar ka qenë jo edhe shumë i lartë, përkatësisht Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2016 ka pranuar 55.641, gjatë vitit 2017 ka pranuar 56.241 lëndë dhe gjatë vitit 2018 ka pranuar 59.788 lëndë.

### **Ngarkesa me lëndë në DP të PTh-ve gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019**

DP-të e PTh-ve, gjatë vitit 2016, kanë trashëguar nga viti paraprak 29,147 ose 54,46% lëndë, i kanë pranuar 24,379 ose 45,54% lëndë, ndërsa gjithsej kanë pasur në punë 53,526 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 26,678 ose 49,84% të rasteve, ndërsa në fund të kësaj periudhe raportuese kanë mbetur të pazgjidhura edhe 26,846 ose 50,16% lëndë.<sup>15</sup>

DP-të e PTh-ve, gjatë vitit 2017, kanë trashëguar nga viti paraprak 27,021 ose 52.03% lëndë, i kanë pranuar 24,913 ose 47.97% lëndë të reja, ndërsa gjithsej kanë pasur në punë 51,934

<sup>15</sup> Raporti i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2016. Mars 2017. fq.40. (Shih linkun [https://www.psh-ks.net/repository/docs/2017\\_04\\_20\\_105803\\_Raporti\\_Prokurori\\_i\\_shtetit\\_2016\\_Finale1.pdf](https://www.psh-ks.net/repository/docs/2017_04_20_105803_Raporti_Prokurori_i_shtetit_2016_Finale1.pdf))

lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 32,995 ose 63.53% lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 18,939 ose 36.47% prej tyre në fund të vitit 2017.<sup>16</sup>

Ndërsa, sipas raporteve zyrtare të Prokurorit të Shtetit, DP-të e PTH-ve, gjatë vitit 2018, kanë trashëguar nga viti paraprak 105.590 lëndë, i kanë pranuar 45.212 lëndë të reja, ndërsa gjithsej kanë pasur në punë 150.802 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 58.623 lëndë, ndërsa të pazgjidhura kanë mbetur edhe 92.179 lëndë.

Gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, DP-të e PTh-ve kanë pasur në punë gjithsej 113.007 lëndë, prej të cilave 92.179 i kanë trashëguar nga viti paraprak, derisa gjatë kësaj periudhe kohore kanë pranuar 19,821 lëndë të reja. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, DP-të e PTh-ve kanë zgjidhur gjithsej 22,465 lëndë, derisa janë trashëguar për periudhën pasuese edhe 90,542 lëndë.

Numri i lëndëve 2018 – 6 mujori 2019	Të trashëguara		Të pranuar		Gjithsej në punë		Të zgjidhura		Të pazgjidhura	
	2018	6 mujori 2019	2018	6 mujori 2019	2018	6 mujori 2019	2018	6 mujori 2019	2018	6 mujori 2019
<b>Prishtinë</b>	41.198	44.559	15.008	6.579	56.206	51.138	11.647	8.465	44.559	42.673
<b>Gjilan</b>	2.790	2.169	3.461	1.683	6.251	3.852	4.082	1.971	2.169	1.881
<b>Prizren</b>	10.593	6.889	6.972	2.369	17.565	9.258	10.676	2.299	6.889	6.959
<b>Pejë</b>	18.413	16.525	5.697	2.554	24.110	19.079	7.585	3.572	16.525	15.507
<b>Ferizaj</b>	14.477	11.567	4.756	2.070	19.233	14.644	7.666	2.197	11.567	12.447
<b>Gjakovë</b>	4.906	3.273	2.869	1.432	7.775	4.705	4.502	1.712	3.273	2.993
<b>Mitrovicë</b>	13.213	7.197	6.449	3.134	19.662	10.331	12.465	2.249	7.197	8.082
<b>Gjithsej</b>	<b>105.590</b>	<b>92.179</b>	<b>45.212</b>	<b>19.821</b>	<b>150.802</b>	<b>113.007</b>	<b>58.623</b>	<b>22.465</b>	<b>92.179</b>	<b>90.542</b>

**Tabela 6: Ngarkesa e DP-ve të PTh-ve me lëndë gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2019.**

Nga këto të dhëna shihet se ndonëse prokurorët kanë arritur që gjatë vitit 2018 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2019 të zgjidhin më shumë lëndë se sa që kanë pranuar.


Gjatë vitit 2018, numri i lëndëve të trashëguara në këtë departament ka rënë për 13,411 lëndë. Në fund të këtij viti, në DKR-të e Prokurorive Themelore kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 90.542 lëndë. Nëse vazhdohet me këtë trend, kjo nënkupton se DP-ve të PTh-ve për të përfunduar të gjitha lëndët të cilat barten vit pas viti u nevojiten afërsisht edhe 7 vite.

Nëse krahasojmë numrin e lëndëve që kanë pranuar në punë departamentet e përgjithshme të shtatë prokurorive themelore gjatë vitit 2018, dhe numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë këtij viti, del se efikasitetin më të lartë në zgjidhjen e lëndëve e ka pasur PTh në Mitrovicë, e cila

<sup>16</sup> Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2017. Mars 2018. fq.46. (Shih linkun [https://www.psh-ks.net/repository/docs/2018\\_04\\_23\\_103007\\_Raporti\\_i\\_Punes\\_2017.pdf](https://www.psh-ks.net/repository/docs/2018_04_23_103007_Raporti_i_Punes_2017.pdf))

nga gjithsej 6.449 lëndë sa kishte pranuar në punë gjatë këtij viti, ka arritur të zgjidhë 12.465 prej tyre, apo shprehur në përqindje 193 %.

Ndërsa, efikasitetin më të ulët në zgjidhjen e lëndëve gjatë kësaj periudhe raportuese e ka pasur PTh në Prishtinë, e cila nga gjithsej 15.008 lëndë sa ka pranuar në punë gjatë vitit 2018, ka arritur që deri në fund të zgjidhë vetëm 11,647 sosh, apo shprehur në përqindje 78 %.




**Grafika 2. Efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve në bazë të lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura për shtatë Prokuroritë Themelore në vitin 2018.**

Ndërsa, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, nëse marrim parasysh numrin e lëndëve të pranuar në punë nga DP-të e Prokurorive Themelore dhe atyre të zgjidhura në fund të kësaj periudhe, del se efikasitetin më të lartë në zgjidhjen e këtyre lëndëve e ka pasur DP i PTh-së në Pejë, ku nga 2.554 lëndë sa ka pranuar në punë gjatë kësaj periudhe, ka arritur t'i zgjidhë 3.572 lëndë, apo shprehur në përqindje 140 %.

Në anën tjetër, gjatë këtij gjashtë mujori, performancë më të dobët në zgjidhjen e lëndëve të pranuar në punë gjatë kësaj periudhe ka treguar DP i PTh-së në Mitrovicë, e cila nga gjithsej 3.134 lëndë sa kishte në punë gjatë kësaj periudhe ka arritur që deri në fund të qershorit të zgjidhë 2.249 lëndë, apo shprehur në përqindje 72 %, gjë që dëshmon për rënie të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve nga kjo prokurori, për dallim nga viti 2018 ku ajo kishte shkallën më të lartë të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve me 193 %.





**Grafika 3. Efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve në bazë të lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura për shtatë Prokuroritë Themelore janar-qershor 2019.**

Sa i përket të dhënave të paraqitura në këtë pjesë të këtij raporti, IKD-ja këto të dhëna i ka siguruar nga raportet zyrtare të Prokurorit të Shtetit, të prezantuara dhe të miratuara nga KPK-ja.

Në bazë të këtyre të dhënave, IKD vlerëson se është e pamundur që të arrihet deri tek vlerësimet e tilla lidhur me trendin e efikasitetit të Prokurorit të Shtetit dhe kjo për shkak të paqartësive numerike që janë evidentuar në këto raporte.

Raportet statistikore duhet të përpilohen duke ndjekur një logjikë të atillë që fundi i një periudhe raportuese duhet të korrespondojë me fillimin e periudhës raportuese vijuese, gjë që nuk ndodhë në raportet statistikore të Prokurorit të Shtetit. Shembull për këtë mund të marrim lëndët që kanë mbetur të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese dhe lëndët e pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese vijuese. Sipas raportit të vitit 2016, të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 26,846 lëndë, derisa raporti i vitit 2017 thotë se nga viti 2016 janë trashëguar 27,021 lëndë. Diferenca në këtë rast është hiç më pak se 175 lëndë. Ndërsa, raporti i Prokurorit të Shtetit për vitin 2017 thotë se në fund të periudhës raportuese (31 dhjetor 2017) kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 18,939 lëndë, derisa raporti i Prokurorit të Shtetit për vitin 2018 thotë se të trashëguara nga viti 2017 janë gjithsej 105.590 lëndë. Në këtë rast, diferenca është 86.651 lëndë.

Lidhur me këtë mospërputhje, Raportet e Prokurorit të Shtetit nuk japin asnjë sqarim. Në anën tjetër, Prokurori i Shtetit nuk ka publikuar raport mbi punën e Prokurorit të Shtetit në gjastë mujorin e parë të vitit 2019. Këto të dhëna, IKD i ka siguruar nga KPK-ja. Vlen të përmendet se këto të dhëna janë të vetmet të cilat gjejnë përputhje me të dhënat që figurojnë

në raportet zyrtare të Prokurorit të Shtetit. Në këtë drejtim, në fund të vitit 2018 raporti i Prokurorit të Shtetit thotë se kanë mbetur të pazgjidhura edhe 92.179 lëndë, dhe kjo gjen përputhje edhe në të dhënat e KPK-së, të cilat thonë se në fillim të vitit 2019 kanë qenë të trashëguara nga viti 2018 plot 92.179 lëndë.

IKD vlerëson se është e papranueshme kjo qasje e Prokurorit të Shtetit në raportet vjetore të saj. Prokurori i Shtetit duhet të jetë i vetëdijshëm se Raporti Vjetor i këtij institucioni është dokumenti më i rëndësishëm lidhur me punën e realizuar gjatë një viti. Për këtë arsye, nuk është e thënë që ky raport të ndërtohet mbi shabllone të caktuara, nga të cilat më së paku kupton publiku, mediat dhe shoqëria civile. Për këtë arsye, sikurse në raportet periodike të IKD-së mbi punën e sistemit prokurorial, IKD vlerëson se këto raporte duhet të jenë raporte analitike dhe të qarta, e mbi të gjitha, të sakta.

Prokurori i Shtetit gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 e deri më 30 qershor 2019, sipas të dhënave zyrtare të regjistrave: PP, PPM, PPN, NJN, PPP, lëndët e PA-së dhe ZKPSH-së, të dhëna këto nga raporti vjetor i PSH-së të vitit 2018 dhe raportit gashtë mujor (janar-qershor), të vitit 2019, rezulton se PSH-ja, në këtë periudhë raportuese ka pasur në punë gjithsej 171,630 lëndë penale.<sup>17</sup>

PSH-ja, fillimin e vitit 2018 e kishte nisur me 105.590 lëndë, ndërsa gjatë këtij viti kishte pranuar edhe 45.212, ndërsa nga ky numër kishte zgjidhur vetëm 58.623 lëndë, duke bërë kështu që viti 2019 të nisë me 92.179 lëndë të pazgjidhura.

### **Ngarkesa me lëndë në DP të PTh sipas kategorive të veprave penale dhe mënyra e kryerjes së lëndëve**

Sa i përket ngarkesës me lëndë të sistemit prokurorial sipas kategorive të veprave penale, PSH dhe KPK-ja nuk disponojnë me statistika të tilla, përjashtimisht të një numri të vogël të kategorive veprave penale.

Sa i përket mënyrës së kryerjes së lëndëve në DP të PTh-ve, gjatë vitit 2018 Prokurori i Shtetit ka hedhur gjithsej 9,126 kallëzime penale, ka ngritur 12,774 aktakuza të drejtpërdrejta, 5,333 aktakuza me kërkesë për urdhër ndëshkimor, 5,968 aktakuza pas zhvillimit të hetimeve si dhe në 81 raste kanë propozuar shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm.

Po ashtu, gjatë vitit 2018, DP-të e PTh-ve kanë pasur 10,164 raste nën hetime, ku në 55 raste kanë pezulluar hetimet, në 11 raste kanë rifilluar hetimet e pezulluara dhe në 1,106 raste kanë pushuar hetimet.

Lidhur me vendimet e Gjykatave përkitazi me aktakuzat e DP të PTh-ve, rezulton se Gjykatat në 806 raste kanë hedhur aktakuzën, në 433 të rasteve kanë nxjerrë aktgjykim refuzues, në 115 raste kanë nxjerrë aktgjykim lirues, ndërsa në gjithsej 6,735 raste ato kanë nxjerrë aktgjykim dënues. Në 58 raste, Gjykatat kanë shqiptuar masat e trajtimit të detyrueshëm.

---

<sup>17</sup> Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2018. Shkurt 2019 (Shih linkun: <http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202018%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit.pdf>)

Ndaj aktgjykimeve të gjykatave, Prokurorët e DP të GjTh-ve kanë parashtruar gjithsej 426 ankesa, 82 prej të cilave janë aprovuar nga GjA derisa 169 ankesa të tjera janë refuzuar nga GjA.

Ndërsa, sa i përket mënyrës së kryerjes së lëndëve në DP të PTh-ve, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, Prokurori i Shtetit ka hedhur kallëzimet penale në 3,587 raste, ka ngritur 5,468 aktakuza të drejtpërdrejta, 1,963 aktakuza me kërkesë për urdhër ndëshkimor, 2,579 aktakuza pas zhvillimit të hetimeve si dhe në 49 raste kanë propozuar shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm.

Po ashtu, gjatë vitit 2018, DP-të e PTh-ve kanë pasur 5,095 raste nën hetime, ku në 23 raste kanë pezulluar hetimet, në 3 raste kanë rifilluar hetimet e pezulluara dhe në 463 raste kanë pushuar hetimet.

Lidhur me vendimet e Gjykatave përkitazi me aktakuzat e DP të PTh-ve, Gjykatat në 1282?? raste kanë hudhur aktakuzën, në 1,140 të rasteve kanë nxjerrë aktgjykim refuzues, në 243 raste kanë nxjerrë aktgjykim lirues ndërsa në gjithsej 14,453 raste kanë nxjerrë aktgjykim dënues. Në 115 raste, Gjykatat kanë shqiptuar masat e trajtimit të detyrueshëm.

Ndaj aktgjykimeve të gjykatave, Prokurorët e DP të GjTh-ve kanë parashtruar gjithsej 673 ankesa, 188 prej të cilave janë aprovuar nga GjA derisa 354 ankesa të tjera janë refuzuar nga GjA.

Sa i përket parashkrimit të veprave penale, ndonëse në raportet e PSh figuron si kategori, në këtë kategori nuk është i vendosur asnjë numër. Realisht, nga raportet e PSh-së nuk kuptohet fare nëse gjatë këtyre 18 muajve nuk është parashkruar asnjë rast, apo thjesht këtë të dhënë PSh nuk e ka ofruar për publikun.

Në anën tjetër, sa i përket ankesave të DP të PTh-ve të ushtruara në GjA, në këtë rast shohim se kemi të bëjmë me një dështim të sistemit prokurorial në parashtrimin e ankesave. Nga të dhënat e cekura më lartë, shihet se gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, për rastet e DP-ve të PTh-ve janë parashtruar gjithsej 1,099 ankesa, prej të cilave vetëm 270 janë aprovuar, që në përqindje i bie se vetëm 24.5% të ankesave janë aprovuar, derisa janë refuzuar gjithsej 523 ankesa, apo 47.5% e tyre.

Lidhur me ankesat e sistemit prokurorial në GjA, Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, në takimin e KPK-së të mbajtur me 21 shkurt 2019 kishte bërë akuzë publike ndaj kësaj gjykate, ku kishte thënë se me gjasë është bërë praktikë hudhja e ankesave të Prokurorit të Shtetit.

“Duhet të shikojmë se për këto ankesa a është krijuar një praktikë për hudhjen e tyre, apo ne ende nuk kemi arritur ta përmirësojmë cilësinë e ankesave. Me gjasë është krijuar praktikë hudhja e këtyre ankesave” ka thënë Hyseni gjatë takimin të KPK-së, të mbajtur me 21 shkurt 2019.

Lidhur me këtë deklaram, IKD vlerëson se Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, në këtë rast ka bërë shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë, i cili në nenin 2, pika

i, përcakton se “Prokurori nuk komenton publikisht dhe privatisht lëndët në procedurën penale, të cilat nxisin dyshimin e paanshmërisë, përfshirë edhe procedurën gjyqësore”.

Në këtë mënyrë, IKD vlerëson se akterët e sistemit prokurorial duhet të ndalen nga hedhja e dyshimeve të tilla në drejtim të sistemit gjyqësor. Fillimisht, akterët e sistemit prokurorial duhet të angazhohen maksimalisht në ngritjen e cilësisë së ankesave të parashtruara në GjA. Këtë çështje duhet t’u trajtojë seriozisht KPK-ja, ku rol veçanërisht të veçantë duhet të luaj Komisioni për Vlerësimin e Performancës në KPK.

Po ashtu, prokurorët duhet të përmbahen nga parashtrimi i ankesave “blanko”, edhe në rastet kur janë të bindur se Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë vendim të drejtë. Prokurorët duhet ta kenë parasysh se nuk është obligim i tyre që pavarësisht rezultatit, në secilin rast të parashtrorin ankesë. Për më tepër, neni 381.2 i KPPRK-së përcakton se “Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë në dëm dhe në dobi të të akuzuarit”. Sa i përket paraqitjes së ankesës në dobi të të akuzuarit, IKD ende nuk ka hasur në një rast të tillë.

Në anën tjetër, nëse prokurorët dyshojnë se në GjA është bërë praktikë e ankesave të sistemit prokurorial, i njëjti sistem këtë çështje nuk duhet t’u trajtojë përmes ankimit publik në takimet e KPK-së, por duhet të veprojë sipas mandatit të saj ligjor. Në rastin konkret, nëse prokurorët hasin në anshmëri të Gjyqtarëve në GjA, atëherë të njëjtit duhet t’u trajtojnë këtë rast nëse paraqet vepër penale, apo shkelje disiplinore. Në rastin e parë, vet prokurorët duhet që të kryejnë hetimet dhe të ngrisin aktakuzat, në mënyrë që kjo dukuri potenciale të adresohet në mënyrën ligjore. Nëse konstatohet se ka shkelje disiplinore, sistemi prokurorial duhet të adresojë këtë çështje tek autoritetet kompetente sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Por, nëse këto hapa nuk ndiqen dhe publiku sheh vetëm kryesuesin e KPK-së duke u ankuar për këtë dukuri në mbledhjet e KPK-së, në thelb, ky është hiç më pak se një dështim i vetë sistemit prokurorial në përmbushjen e mandatit dhe kompetencave ligjore që ka.

## VII. PERFORMANCA E GJYKATËSVE TË DP-VE NË GJASHTË VITIT 2018 DHE GJASHTË MUJORIT TË PARË TË VITIT 2019

Gjatë vitit 2018, DP-të e GjTh-ve kanë trashëguar 42,116 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 22,300 lëndë, derisa kanë pasur në punë gjithsej 64,416 lëndë. Gjatë vitit 2018, DP-të e GjTh-ve kanë zgjidhur gjithsej 24,278 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 40,118.

Gjatë vitit 2018, në DP-të e GjTh-ve kanë qenë të angazhuar gjithsej 80 gjyqtarë.

Në mesatare, i bie se secili gjyqtar gjatë vitit 2018 ka pranuar nga 278.75 lëndë të reja, derisa mesatarisht secili gjyqtar ka pasur në punë nga 805.2 lëndë.

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, e miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në Departamentin e Krimeve të Rënda është 24, ndërsa norma vjetore 292.

Gjatë vitit 2018, mesatarisht secili gjyqtar ka zgjidhur nga 303.4, që i bie se gjyqtarët e DP-ve të GjTh-ve gjatë vitit 2018 kanë tejkaluar normën orientuese të përcaktuar nga KGJK-ja, duke kryer nga 11.4 lëndë më shumë gjatë vitit 2018.

Në anën tjetër, KGJK-ja gjatë vitit 2018 ka bërë një hap para në kuptim të transparencës së sistemit gjyqësor, në atë mënyrë që ka publikuar raportin statistikor për punën e gjyqtarëve për vitin 2018, ku sipas këtyre statistikave, ka diferencë të madhe sa i përket numrit të lëndëve të kryera mes gjyqtarëve në DP-të e GjTh-ve.

Sipas këtij raporti, Gjyqtari i cili ka kryer më së shumti lëndë gjatë vitit 2018 ka qenë Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gillogoc, Shefqet Baleci, me gjithsej 806 lëndë, pasuar nga gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Violeta Namani, me gjithsej 697 lëndë të kryera dhe Fatime Dermaku me gjithsej 654 lëndë të kryera.

Në anën tjetër, Gjyqtari i cili gjatë vitit 2018 ka kryer më së paku lëndë është Gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani-Rama me 88 lëndë të kryera, pasuar nga Gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dragica Jakovliq me 110 lëndë të kryera dhe Gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, Zajrete Muhaxheri me 131 lëndë të kryera<sup>18</sup>.

Gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, DP-të e GjTh-ve kanë trashëguar 40,118 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 9,642 lëndë, derisa kanë pasur në punë gjithsej 49,760 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 15,132 lëndë.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, në të gjithë DP-të e GjTh-ve kanë qenë të angazhuar gjithsej 97 Gjyqtarë.

Në këtë mënyrë, i bie se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, secili gjyqtar mesatarisht ka pranuar në punë nga 99.4 lëndë të reja, derisa ka pasur në punë mesatarisht nga 512 lëndë.

<sup>18</sup> *Sqarim:* IKD ka marrë për referencë vetëm gjyqtarët që kanë qenë të angazhuar gjatë gjithë periudhës në DP-të të GjTh-ve.

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, e miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në Departamentin e Përgjithshëm është 24. Andaj, sipas këtij përcaktimi, për gjashtë muaj, norma orientuese e një gjyqtari është 144 lëndë të zgjidhura.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, mesatarisht secili gjyqtar ka kryer nga 156 lëndë, përkatësisht ka tejkaluar normën orientuese për gjithsej 12 lëndë.

Sa i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2019, IKD përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike ka siguruar nga KGJK-ja raportin individual mbi punën e gjyqtarëve, në të cilin raport figuron numri i lëndëve të kryera nga secili gjyqtar në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019.

Sipas këtij raporti, Gjyqtari i cili ka kryer më së shumti lëndë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 është sërish Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, Shefqet Baleci, me gjithsej 430 lëndë të zgjidhura, pasuar nga Gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Fatime Dermaku me 399 lëndë të zgjidhura dhe Agim Kuçi me 375 lëndë të zgjidhura.

Në anën tjetër, Gjyqtari që ka kryer më së paku lëndë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 është gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, Sabaheta Kurteshi<sup>19</sup> me vetëm 25 lëndë të përfunduara, pasuar nga Gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Besarta Doli, me 28 lëndë të përfunduara dhe Gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Pejë, Violeta Husaj me 38 lëndë të përfunduara.

Nga të dhënat e sipër përmendura shohim se në DP-të e GjTh-ve ka pasur një efekt pozitiv ngritja e numrit të gjyqtarëve, në atë mënyrë që rrjedha ka qenë logjike dhe e natyrshme, për shkak se me rritjen e numrit të gjyqtarëve është rritur edhe numri i lëndëve të përfunduara. Një efekt i tillë pozitiv nuk ishte manifestuar tek DKR-të e GjTh-ve, ku përkundër ngritjes së numrit të gjyqtarëve, numri i lëndëve të zgjidhura kishte rënë.

Në anën tjetër, sa i përket performancës individuale, siç e pamë edhe më lartë, ka një disbalancë jashtëzakonisht të madhe sa i përket numrit të lëndëve të kryera në mes gjyqtarëve. Nëse e kalkulojmë numrin e lëndëve të kryera nga 3 gjyqtarët me performancës më të dobët në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, i bie se të tre gjyqtarët në total kanë kryer 91 lëndë, apo 21.1 % të numrit të lëndëve që Gjyqtari Shefqet Baleci ka kryer si i vetëm.

---

<sup>19</sup> *Sqarim:* Gjyqtarja Sabaheta Kurteshi është edhe Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën themelore në Prizren – Dega në Dragash.

VIII. PERFORMANCA E PROKURORËVE TË DP-VE NË PTH GJATË VITIT 2018 DHE GJASHTË MUJORIT TË PARË TË VITIT 2019

Gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2019, në DP-të e PTh-ve kanë qenë të angazhuar gjithsej 105 prokurorë.

Nëse e shikojmë në mesatare, atëherë i bie se secili prokuror i DP të PTh-ve ka pranuar mesatarisht nga 430 lëndë. Nga shtatë DP-të e PTh-ve, gjatë vitit 2018 më së shumti lëndë ka pranuar Prokuroria Themelore në Prishtinë, ndërsa më së paku lëndë ka pranuar Prokuroria Themelore në Gjakovë:

Prokuroria	Numri i prokurorëve	Lëndët e pranuar në punë	Mesatarja e lëndëve të pranuar për një prokuror
<b>Prishtinë</b>	30	15,008	500
<b>Gjilan</b>	10	3,461	346
<b>Prizren</b>	16	6,972	435
<b>Pejë</b>	12	5,697	474
<b>Ferizaj</b>	14	4,756	339
<b>Gjakovë</b>	9	2,869	318
<b>Mitrovicë</b>	14	6,449	460
<b>Gjithsej</b>	<b>105</b>	<b>45,212</b>	<b>430</b>

Tabela 7: Mesatarja e pranimit të lëndëve për një prokuror gjatë vitit 2018

Ndërsa, gjatë vitit 2018, secili prokuror ka pasur në punë mesatarisht nga 1,436 lëndë. DP i PTh-ve i cili gjatë vitit 2018 ka pasur në punë më së shumti lëndë ka qenë DP i PTh-së në Prishtinë me mesatarisht 1,873 lëndë në punë për prokuror, ndërsa më së paku lëndë në punë ka pasur DP i PTh-së në Gjilan, ku secili prokuror ka pasur në punë mesatarisht nga 625 lëndë:

Prokuroria	Numri i prokurorëve	Lëndët në punë	Mesatarja e lëndëve në punë për një prokuror
<b>Prishtinë</b>	30	56,206	1,873
<b>Gjilan</b>	10	6,251	625
<b>Prizren</b>	16	17,565	1,097
<b>Pejë</b>	12	24,110	2,009
<b>Ferizaj</b>	14	19,233	1,373
<b>Gjakovë</b>	9	7,775	863
<b>Mitrovicë</b>	14	19,662	1,404
<b>Gjithsej</b>	<b>105</b>	<b>150,802</b>	<b>1,436</b>

Tabela 8. Mesatarja e lëndëve në punë për prokurorët gjatë vitit 2018.

Ndërsa, sa i përket mesatares së numrit të lëndëve të zgjidhura, gjatë vitit 2018 i bie se secili prokuror ka zgjidhur mesatarisht nga 558 lëndë.

Norma orientuese e përcaktuar nga KPK-ja për prokurorët e DP të PTh-ve është 253 lëndë në vit. Pra, mesatarisht, prokurorët kanë tejkaluar dyfishin e normës vjetore, duke kryer nga 305 lëndë më shumë se sa norma orientuese.

Në mesataren e numrit të lëndëve të zgjidhura në DP, Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka qenë prokuroria më efikase, ky secili prokuror mesatarisht ka zgjidhur nga 890 lëndë. Ndërsa, prokuroria më jo efikase ka qenë Prokuroria Themelore e Prishtinës, ku secili prokuror mesatarisht ka kryer 388 lëndë gjatë vitit 2018:

Prokuroria	Numri i prokurorëve	Lëndët e zgjidhura	Mesatarja e zgjidhjes së lendeve
<b>Prishtinë</b>	30	11.647	388,2
<b>Gjilan</b>	10	4.082	408,2
<b>Prizren</b>	16	10.676	667,25
<b>Pejë</b>	12	7.585	632
<b>Ferizaj</b>	14	7.666	547,5
<b>Gjakovë</b>	9	4.502	500,2
<b>Mitrovicë</b>	14	12.465	890.3
Gjithsej	<b>105</b>	<b>58.623</b>	<b>558,3</b>

**Tabela 9 Mesatarja për zgjidhjen e lëndëve të prokurorëve gjatë vitit 2018.**

Ndërsa, sa i përket numrit të lëndëve të pranuar, në total, secili prokuror në DP të PTh-ve në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 ka pranuar në punë mesatarisht nga 188 lëndë. Në këtë rast, numrin më të lartë të lëndëve të pranuar për prokurorë e ka PTh në Mitrovicë, ku secili prokuror ka pranuar mesatarisht nga 223 lëndë, derisa më së paku lëndë për prokuror ka pranuar PTh në Ferizaj, ku gjatë kësaj periudhe kohore, secili prokuror mesatarisht ka pranuar nga 147 lëndë të reja në punë:

Prokuroria	Numri i prokurorëve	Lëndët e pranuar në punë	Mesatarja e lëndëve të pranuar për një prokuror
<b>Prishtinë</b>	30	6,579	219
<b>Gjilan</b>	10	1,683	168
<b>Prizren</b>	16	2,369	148
<b>Pejë</b>	12	2,554	212
<b>Ferizaj</b>	14	2,070	147
<b>Gjakovë</b>	9	1,432	159
<b>Mitrovicë</b>	14	3,134	223
Gjithsej	<b>105</b>	<b>19,821</b>	<b>188</b>

**Tabela 10: Mesatarja e numrit të lëndëve të pranuar në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019.**



Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, në DP-të e PTh-ve, secili prokuroror ka qenë i ngarkuar mesatarisht me nga 1,076 lëndë. Më e ngarkuara ka qenë PTh në Prishtinë ku secili prokuror ka qenë i ngarkuar mesatarisht me 1,704 lëndë, ndërsa prokuroria që më së paku ka pasur lëndë në punë ka qenë PTh në Gjakovë, ku secili prokurorë ka qenë i ngarkuar mesatarisht me nga 522 lëndë:

Prokuroria	Numri i prokuroreve	Lëndët në punë	Mesatarja e lëndëve në punë për një prokuror
<b>Prishtinë</b>	30	51,138	1,704
<b>Gjilan</b>	10	3,852	385
<b>Prizren</b>	16	9,258	578
<b>Pejë</b>	12	19,079	1,589
<b>Ferizaj</b>	14	14,644	1,046
<b>Gjakovë</b>	9	4,705	522
<b>Mitrovicë</b>	14	10,331	737
Gjithsej	<b>105</b>	<b>113,007</b>	<b>1,076</b>

**Tabela 11: Mesatarja e lëndëve në punë për prokurorët gjatë periudhës janar-qershor 2019.**

Sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, mesatarisht secili prokuror në DP-të e PTh-ve ka zgjidhur nga afërsisht 214 lëndë. Sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura për një prokuror, Prokuroria më efikase ka qenë PTh në Pejë, ku mesatarisht secili prokuror ka zgjidhur nga 397.6 lëndë, derisa prokuroria më jo efikase ka qenë PTh në Prizren, ku secili prokuror ka zgjidhur mesatarisht nga 143 lëndë.


Prokuroria	Numri i prokuroreve	Lëndët e zgjidhura	Mesatarja e zgjidhjes së lëndëve
<b>Prishtinë</b>	30	8,465	282.1
<b>Gjilan</b>	10	1,971	197.1
<b>Prizren</b>	16	2,299	143.6
<b>Pejë</b>	12	3,572	297.6
<b>Ferizaj</b>	14	2,197	156.9
<b>Gjakovë</b>	9	1,712	190.2
<b>Mitrovicë</b>	14	2,249	160.6
Gjithsej	<b>105</b>	<b>22,465</b>	<b>213.9</b>

**Tabela 12: Mesatarja për zgjidhjen e lëndëve të prokurorëve gjatë periudhës janar-qershor 2019.**

## IX. Gjetjet e IKD-së në trajtimin e rasteve të përgjithshme


Gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2019, IKD në mënyrë sistematike ka monitoruar procedurat gjyqësore në DP të të gjitha gjykatave themelore, përfshirë edhe degët e tyre.

Gjatë kësaj periudhe IKD ka monitoruar gjithëj 2,694 seanca nga 2,015 raste, nga të cilat 1823 seanca janë mbajtur e 871 janë shtyera.



Grafika 4– Seancat e monitoruara nga IKD.<sup>20</sup>

Sa i përket inicimit të rastit nëpër Prokurori, shumica dërrmuese e rasteve janë iniciuar nga Policia e Kosovës, derisa ka raste të iniciuara edhe nga Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsion etj.



Grafika 5. Tabela me numrin e parashtruesve nga rastet e monitoruara në Departamentin e Përgjithshëm - Divizionin Penal.

<sup>20</sup> “Platforma e Monitorimit të Gjyqësorit” Instituti i Kosovës për Drejtësi (Shih linkun <https://kli-ks.org/> ). (Qasur së fundmi 14 gusht 2019)

Nga rastet e monitoruara rezulton se Prokuroria ka kërkuar sekuestrimin e pasurive vetëm në 53 raste, ndërsa në mënyrë të njëjtë nuk ka vepruar në 1,962 raste të tjera.<sup>21</sup>

Njëra ndër sfidat më të mëdha të sistemit të drejtësisë në Kosovë vazhdon të mbetet mungesa e efikasitetit në trajtimin e rasteve. Gjatë monitorimit sistematik të të gjitha DP-ve të GjTh-ve, përfshirë edhe degët e tyre, IKD ka gjetur se procedurat ndaj personave zgjasin me vite të tëra, shkelje kjo e gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, parim ky i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas të dhënave të IKD-së të nxjerra nga monitorimi sistematik, kohëzgjatja e një rasti në Prokurori nga data e parashtrimit të kallëzimit penal e deri në ngritjen e aktakuzës është 285 ditë.

Ndërsa, sa i përket kohëzgjatjes së një rasti në gjykatë, sipas KGJK-së, kohëzgjatja e një rasti në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatave Themelore është 602 ditë, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës së Apelit është 73.86 ditë<sup>22</sup>. Këtë statistikë, KGJK nuk e nxjerrë duke trajtuar kohëzgjatjen e secilit rast një për një, por me anë të një formule matematikore.

Por, nga rastet e monitoruara nga IKD, del se kjo statistikë nuk është as për së afërmi e sakt. Sipas të dhënave të IKD-së të nxjerra nga monitorimi i secilit rast, Divizioneve Penale të Gjykatave Themelore, vetëm për caktimin e shqyrtimit fillestar pas ngritjes së aktakuzës i jan nevojitur mesatarisht 619, ndonëse sipas KPPK-së, “Gjykata është e obliguar që seancën fillestare ta mbaj brenda 30 ditësh pas ngritjes së aktakuzës”.

Ndërsa si rezultat i faktorëve objektiv (numri i madh i lëndëve, numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve etj) dhe faktorëve subjektiv (neglizhenca e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve, mos veprimi i tyre konform kërkesave ligjore etj) shumë persona mbesin pa marr dënimin e merituar, si pasoj e vjetërsimit të lëndëve.

Mirëpo këto nuk janë shkeljet e vetme, pasi sipas të dhënave të këtij hulumtimi është prezente edhe mungesa e koordinimit me rastin e zhvillimit të hetimeve nga ana e prokurorisë, e cila ka bërë që të ngritën aktakuza gabimisht, ndaj personave të vdekur, e ndaj personave të gjykuar më parë për veprën e njëjtë penale.

Kjo si pasojë e ngritjes së aktakuzave të drejtpërdrejta pa zhvilluar hetimet, ndonëse një gjë e tillë është e paraparë me dispozita ligjore, duket se për sistemin tonë të drejtësisë nuk ka qenë mjaftë e favorshme, dhe mbi të gjitha nuk ka qenë në dobi të efikasitetit procedural. Në anën tjetër, praktika e ngritjes së aktakuzave të drejt për drejta në raste të caktuara është bërë tanimë praktikë standarde e sistemit prokurorial.

Gjetjet e këtij raporti dëshmojnë se aktakuzat e drejtpërdrejta, nuk janë gjithmonë në dobi të efikasitetit procedural, por ndonjëherë mund edhe ta vështirësojnë vërtetimin e plotë të

---

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> *Shënim:* KGJK këtë kalkulim e bënë për Departamentin e Përgjithshëm si tërësi, dhe jo të ndarë në Divizionin Penal, Civil dhe atë për Kundërvajtje.

gjendjes faktike për shkak të mungesës së provave dhe më pas gjykata duhet ta luaj rolin e hetuesit.

IKD vlerëson se përkundër faktit që KPPRK-ja ka dhënë mundësinë e ushtrimit të aktakuzave të drejtpërdrejta, prokuroria duhet të zbatojë veprime hetimore, për të cilat e autorizon KPPRK. Kjo me qëllim që shmangen dhe parandalohen rastet që në cilësinë e personave të akuzuar të paraqiten persona të vdekur, apo të atillë që më parë kanë qenë të gjykuar apo dënuar për të njëjtën vepër penale për të cilën për herë të dytë janë akuzuar.

Po ashtu, gjatë realizimit të këtij raporti është hasur një tendencë e gjykatës për të fshehur nga opinioni publik lëndët ku në cilësinë e të akuzuarve paraqiten persona me ndikim në jetën politike dhe publike. Në një numër të madh të rasteve, për disa prej të cilave ka raportuar ekskluzivisht “Betimi për Drejtësi”, ka rezultuar se aktakuza ka qëndruar në sirtarët e gjykatës për disa vjet dhe vetëm presioni publik ka ndikuar që gjykata të fillojë me trajtimin e këtyre rasteve. Kjo është një mungesë e transparencës nga organet e drejtësisë në raport me publikun dhe rrjedhimisht veprime të tilla minojnë besimin e qytetarëve në punën e këtyre institucioneve.

Gjatë trajtimit të rasteve që gjykohen në DP është vërejtur një dukuri pozitive sa i përket lartësisë së dënimeve të shqiptuara dhe në shumë raste këto dënime kanë qenë shumë herë më të larta se ato të shqiptuara në Departamentet për Krime të Rënda, ku gjykohen veprat penale që kanë një rrezikshmëri më të lartë shoqërore sesa ato që trajtohen nga departamenti i përgjithshëm. Veçmas një analogji e tillë mund të përdoret për të krahasuar dënimet e shqiptuara nga gjykatësit e departamenteve për krime të rënda për vepra penale korruptive, ku akoma nuk ka një dënim të formës së prerë që konsiston në burgim efektiv, por dënimet më të shpeshta të shqiptuara janë ato me kusht.

Gjetje tjetër ka qenë mënyra e trajtimit të rasteve, të cilat sipas KPRK-së janë të kualifikuara si vepra të rëndësisë së vogël, kjo për shkak të shkallës së rrezikshmërisë dhe pasojave të cilat shkaktohen me këto lloj veprash penale të cilat sipas KPRK-së përkufizohen si vepra penale të rëndësisë së vogël. Përkritazi me këtë, KPPRK përcaton shprehimisht se “Nuk përbën vepër penale ajo vepër e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj, paraqet vepër të rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit”<sup>23</sup>

Përkundër kësaj prokuroria ka ngritur aktakuza e gjykata ka zhvilluar procedura ndaj personave të akuzuar për vepra penale të kualifikuara si vepra të rëndësisë së vogël, në të cilat dëmi i shkaktuar ka qenë 60-100 euro, apo në një rast tjetër 5 euro.

DP i GjTh-ve gjatë vitit 2018 ka trajtuar edhe shumë raste që lidhen me vepra penale kundër shërbimeve komunale, dhe veprave penale të rrezikimit të trafikut publik, ku gjatë

---

<sup>23</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës

monitorimit dhe raportimit sistematik, është gjetur se ndaj këtyre kryerësve, janë shqiptuar dënime shumë të ulta, ndonëse këto lloje të veprave penale gjatë vitit 2018 kishin shënuar rritje.<sup>24</sup>

Veçanërisht veprat penale kundër trafikut karakterizohen me rrezikshmëri të lartë shoqërore, ku vetëm gjatë periudhës janar - nëntor kanë ndodhur 14 mijë e 393 aksidente, prej të cilave 85 kanë qenë me fatalitet, 5 mijë e 706 aksidente kanë qenë me të lënduar, nga ku 11 mijë e 336 persona kanë pësuar lëndime trupore, ndërsa aksidente me dëme materiale janë shënuar 8 mijë e 602 sosh

Gjatë vitit 2018, hulumtuesit e IKD-së me shtrirje në të gjitha GjTh-të dhe degët e tyre, kanë monitoruar rreth 95 raste të kategorizuara si veprime kundër sigurisë së trafikut publik, për vepra penale që janë kryer vite më parë. Në këto raste, numri i dënimeve me burgim efektiv është jashtëzakonisht i ulët.

Ndërsa pasoja të mëdha materiale shkaktojnë veprat penale kundër shërbimeve komunale, të cilat dita e ditës shënojnë rritje, ndonëse dënimet ndaj kryerësve të tyre janë zakonisht me kusht, ose përfundojnë në procedurë të ndërmjetësimit.

Në rreshtat vijues të këtij raporti, IKD do të trajtojë disa prej rasteve të përzgjedhura karakteristike, ku përpos sqarimit të rastit, do të paraqes edhe analizë mbi gjetjet konkrete në një rast të caktuar.

---

<sup>24</sup> “Numri i aksidenteve në trafik në rritje, dënimet ndaj të akuzuarve me “rënie”. Betimi për Drejtësi. 3 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/numri-i-aksidenteve-ne-trafik-ne-rritje-denimet-ndaj-te-akuzuarve-me-renie>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

## 1. Parashkruhet rasi i ish-Deputetit të LDK-së për vjedhje rryme

### GjTh në Prishtinë

**Numri i lëndës:** P.nr.980/11

**Vepra penale:** “Vjedhje e rëndë”

**Gjykatësi:** Rustem Begolli

**Prokuror:** Blerim Igrishta

**I pandehur:** Ramiz Kelmendi

Rasti në të cilin ish-Deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe biznesmeni Ramiz Kelmendi akuzohej se i kishte shkaktuar dëm material KEK-ut në vlerë prej 22.801.19 euro, mori epilogun më 12 nëntor 2018, kur edhe u parashkrua, me ç’rast gjykatësi i çështjes, Rustem Begolli ndaj tij shpalli aktgjykim refuzues.<sup>25</sup>

Kjo pasi paraprakisht, prokurori Blerim Igrishta, rikualifikoi veprën penale ndaj Kelmendit, nga “vjedhje e rëndë”, në “vjedhje të shërbimeve komunale”.

Ndryshe Prokuroria e Apelit edhe para konfirmimit të aktakuzës kishte kërkuar nga GjA pushimin e procedurës, me arsyetimin se kishte arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Ndërsa, GjA, me vendimin e nxjerrë më 26 shkurt 2018, kishte aprovuar ankesën e ushtruar nga i akuzuari Kelmendi, dhe këtë çështje penale e kishte kthyer në rivendosje.<sup>26</sup> Mirëpo, përkundër kësaj, GjTh në Prishtinë më 26 prill 2018 e kishte konfirmuar këtë aktakuzë.<sup>27</sup>

Sipas aktakuzës, vepra penale ishte kryer nga periudha e pacaktuar kohore e deri më 30 qershor të vitit 2011, me ç’rast kompania “Elkos” në Fushë Kosovë, kishte keqpërdorur energjinë elektrike, duke i shkaktuar kështu dëm material KEK-ut.

Sipas prokurorisë, punëtorët e KEK-ut kishin shkuar për të bërë kontrolle në atë kompani dhe kanë hasur se i pandehuri me qëllim të vjedhjes ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, duke mos regjistruar dy të tretat e energjisë, pasi aty janë gjetur dy transformator të rrymës që kanë qenë jashtë matjes, ndërsa një përçues ishte shkëputur nga lidhja.

<sup>25</sup> “Aktgjykim refuzues ndaj deputetit Ramiz Kelmendi, pas rikualifikimit të veprës penale është arritur parashkrim”. Betimi për Drejtësi. 12 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-deputetit-ramiz-kelmendi-pas-rikualifikimit-te-vepres-penale-eshte-arritur-parashkrimi/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>26</sup> “Prokuroria bëhet pishman, kërkon nga Gjykata e Apelit që të hudhet poshtë aktakuza ndaj Ramiz Kelmendit për vjedhje të rrymës”. Betimi për Drejtësi 22 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-behet-pishman-kerkon-nga-gjykata-e-apelit-qe-te-hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-ramiz-kelmendit-per-vjedhje-te-rrymes/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>27</sup> “Pavarësisht kërkesës së Prokurorisë për pushimin e procedurës ndaj Ramiz Kelmendit, Gjykata konfirmon aktakuzën ndaj tij”. Betimi për Drejtësi 26 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pavaresisht-kerkeses-se-prokurorise-per-pushimin-e-procedures-ndaj-ramiz-kelmendit-gjykata-konfirmon-aktakuzen-ndaj-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019).

Në bazë të aktakuzës, me këto veprime, dy të tretat e energjisë elektrike nuk ishte regjistruar, me ç'rast KEK-ut i është shkaktuar dëm në vlerë prej 22.801.19 euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

GjTh në Prishtinë më 12 nëntor 2018 kishte marrë aktgjykim refuzues ndaj ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, pasi që prokuroria kishte bërë ricilësimin e veprës penale, nga “vjedhje e rëndë” në “vjedhje të shërbimeve komunale”, ku si rrjedhojë e kësaj, për veprën penale të ricilësuar tanimë kishte arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Rikualifikimi i kësaj vepre penale nga prokuroria ishte bërë pasi që në kohën e përpilimit të kësaj aktakuze, Kodi i Përkohshëm Penal (KPK), që ishte në fuqi deri në fund të vitit 2012, nuk kishte paraparë si vepër penale “vjedhjen e shërbimeve komunale”.

Në këtë rast, kallëzimi penal ishte ushtruar më **13 shtator të vitit 2011**, ndërsa pas **438** ditësh PTh në Prishtinë, kishte ngritur aktakuzë ndaj ish-deputetit Kelmendi.

Por, nga viti 2012 e deri 29 janar të vitit 2018 kur edhe ishte mbajtur shqyrtimi fillestar, GjTh në Prishtinë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim të vetëm procedural në këtë rast.

Gjykatës në këtë rast i janë dashur **1,873 ditë** deri në caktimin e seancës fillestare të procedurës gjyqësore, derisa neni 242.4 i KPPRK-së përcakton se shqyrtimi fillestar duhet të caktohet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës.

Ndërsa, nga mbajtja e seancës fillestare deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor kanë kaluar **254 ditë**.

**Dëmi i pretenduar:** 22.801.19 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

## 2. Pushohet gjykimi ndaj Frashër Krasniqit dhe 21 aktivistëve të VV-së

### GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: 3176/16

**Vepra penale:** “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”

**Gjykatësi:** Alban Ajvazi

**Prokuror:** Ali Hajdini

**Të pandehurit:** Frashër Krasniqi, Gëzon Kastrati, Bekim Gashi, Adem Megjuani, Egzon Azemi, Agron Kabashi, Petrit Ademi, Nora Fetoshi, Etleva Malushaj, Egzon Balaj, Rejhan Fejza, Fatos Sahiti, Pleurat Thaqi, Durim Elshani, Alban Makolli, Arbër Sejdiu, Flamur Pireva, Boiken Abazi, Zgjim Hyseni, Imer Fejza, Dritëro Çadraku dhe Arianit Manxhuka.

Gjykata Themelore në Prishtinë, në qershor të vitit 2019 kishte pushuar procedurën penale ndaj Frashër Krasniqit dhe të tjerëve, të cilët akuzoheshin për veprën penale “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”.

Ky vendim për hudhje të kësaj aktakuze ishte marrë pasi prokurori i PTH në Prishtinë, Ali Hajdini, më 18 prill 2019 ishte tërhequr nga akti akuzues, të cilin vet kjo prokurori e kishte ushtruar ndaj këtyre 22 të akuzuarve.<sup>28</sup>

Ish-deputeti Krasniqi dhe bashkë-partiaku i tij, Zgjim Hyseni, dhe zyrtarët e VV-së, Boiken Abazi e Etleva Malushaj, si dhe aktivistë të tjerë, akuzoheshin për “pjesëmarrje në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizëm”, lidhur me protestën e organizuar në janar të vitit 2015, në të cilën kërkoheshin shkarkimi i ministrit të atëhershëm për Komunitete dhe Kthim, Aleksandar Jabllanoviq.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTH Prishtinë më 16 janar 2015 kishte pranuar kallëzimin penal ndaj këtyre 22 të akuzuarve. Ndërsa, aktvendimin për fillim të hetimeve kjo prokurori e kishte nxjerrë më 21 qershor 2016, apo 523 ditë pas paraqitjes së kallëzimit penal.

Aktakuza ndaj Krasniqit dhe 21 të akuzuarve të tjerë ishte ngritur më 18 korrik 2016 apo 28 ditë pas fillimit të hetimeve dhe 550 ditë prej kohës së paraqitjes së kallëzimit penal në PTh.

Ndërsa, seanca fillestare në këtë çështje penale nuk kishte arritur të mbahej asnjëherë, ashtu që kjo lëndë kishte qëndruar e mbyllur në sirtarët e gjykatës për afro tre vite që nga ngritja e aktakuzës.

Kjo situatë paraqet shkelje të afatit ligjor, përkatësisht nenit 242.4 të KPPRK-së i cili ka përcaktuar obligimin e gjykatës që të caktoj shqyrtimin fillestar brenda 30 ditësh pas ngritjes së aktakuzës.<sup>29</sup>

---

<sup>28</sup> “Pushon procedura penale ndaj deputetit Frashër Krasniqi dhe të tjerëve lidhur me protestën për shkarkimin e ish-ministrit Jabllanoviq”. Betimi për Drejtësi. 5 Qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pushon-procedura-penale-ndaj-deputetit-frasher-krasniqi-dhe-te-tjereve-lidhur-me-protesten-per-shkarkimin-e-ish-ministrit-jabllanoviq/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)



Andaj, mos respektimi i këtij afati nga ana e gjykatës mund të cilësohet si një shkelje serioze në raport me ligjshmërinë e këtij procesi gjyqësor, me ç'rast 22 të akuzuarve në këtë rast u është pamundësuar e drejta që të njoftohen me veprën e cila u ngarkohej dhe rrjedhimisht edhe e drejta e tyre që në fazat e mëtutjeshme t'a kundërshtonin aktakuzën dhe të bënin kërkesë për hudhje të saj, para se prokurori të tërhiqej nga ndjekja penale, kur kishin kaluar tri vjet nga ngritja e aktit akuzues.

Ndërsa, akti i heqjes dorë të prokurorit nga akti akuzues, me arsyetimin se “provat që gjenden në shkresat e lëndës janë thelbësisht të pa mbështetshme dhe thelbësisht të pabesueshme dhe si të tilla nuk mund të vërtetojnë elementet qenësore të kësaj vepre penale”, tregon për një mungesë profesionalizmi të prokurorisë qysh në fazën e zhvillimit të hetimeve e më pas edhe me rastin e ngritjes së kësaj aktakuze.

Kjo pasi par.1 i nenit 240 ka përcaktuar se procedura në gjykatë mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit, e cila është rezultat i zhvillimit të hetimeve dhe në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale, dyshim ky i cili si duket nuk i ka tejkaluar suazat e një dyshimi të thjeshtë, i cili është i pamjaftueshëm për ngritjen e aktakuzës.<sup>30</sup>

Ndërsa, neni 240 i KPPRK-së ka përcaktuar saktë se aktakuza ngritet në rastet kur prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale dhe këtë dyshim të bazuar ai e mbështet në prova të siguruara gjatë hetimeve, kur ato janë zbatuar. Në të kundërtën, kur nuk ka prova të mjaftueshme që prokurori ta mbështes këtë dyshim të bazuar, ky kod përcakton se hetimet pushohen me aktvendim.<sup>31</sup>

Në këtë mënyrë, të pandehurit janë persekutuar afro 3 vite deri në kohën kur prokurori ka konstatuar se aktakuza e tij nuk mbështetet në prova.

Nga paraqitja e kallëzimit penal e deri në nxjerrjen e vendimit për fillim të hetimeve në këtë rast kanë kaluar 523 ditë. Ndërsa, kohëzgjatja e këtij procesi gjyqësor, që nga ngritja e kësaj aktakuze më 18 korrik 2016, e deri në pushimin e procedurës penale më 23 prill 2019, përfshin plot **1010 ditë**.

---

<sup>29</sup> Kodi i procedurës penale, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

<sup>30</sup> Kodi i procedurës penale të Kosovës, par.1 i nenit 240 “. Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit.

<sup>31</sup>Po aty, neni 240 parasheh “1. Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit. 2. Nëse hetimi ka përfunduar dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale ose vepra penale, prokurori i shtetit nxjerr aktvendim për pushimin e hetimit”.

Kjo është një shkelje serioze e parimit universal të njohur si e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parim ky i paraparë në nenin 6 të KEDNJ, si dhe i integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin 31<sup>32</sup> dhe në nenin 5 të KPPRK-së.

**Dëmi i pretenduar:** I pacaktuar.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<sup>32</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, par.2 i nenit 5 ndër të tjera përcakton “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”

### **3. Aktakuza ndaj ish-deputetit akoma nuk shqyrtohet në gjykatë**

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** 3235/16

**Vepra penale:** “Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”, neni 317 i KPK-së

**Gjykatësi:** Alban Ajvazi

**Prokuror:** Fatmir Behrami

**Të pandehurit:** Frashër Krasniqi, Vlorian Molliqaj dhe Faton Zeka

Gjykata Themelore në Prishtinë vetëm në vitin 2019 ka filluar ta trajtojë çështjen penale ku ish-deputeti Frashër Krasniqi dhe dy të akuzuarit e tjerë po akuzohen për veprën penale “Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”, e cila sipas prokurorisë dyshohet të jetë kryer në vitin 2010.

Ish-Deputeti Frashër Krasniqi dhe dy të tjerët, akuzohen nga prokuroria se më 12 Qershor 2010, në rrugën “Perandori Justinian” në Prishtinë, afër zyrave të Lëvizjes “Vetëvendosje”, me bashkëveprim dhe me dashje kanë sulmuar fizikisht personat zyrtarë, duke përdorur mjete të forta si shufra, gurë, xhama, pjesë të karrigeve, shishe etj, për ta penguar Policinë e Kosovës, në kryerjen e detyrës zyrtare, gjatë operacionit për arrestimin e Albin Kurtit sipas urdhrit të gjykatës.

Kallëzimi penal për këtë rast ishte paraqitur edhe ndaj të dyshuarve Salih Zyba dhe Nderim, mirëpo për ta ishte hedhur kallëzimi penal më 21 korrik 2016. Kjo pasi që sipas prokurorisë, në këtë rast kishte arritur afati i parashkrimit absolut i ndjekjes penale ndaj tyre.

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PTh në Prishtinë më 14 qershor 2010 kishte pranuar nga Policia e Kosovës kallëzimin penal të ushtruar ndaj të akuzuarve të lartcekur. Ndërsa, vendimin për fillim të hetimeve kjo prokurori e kishte marrë më 21 korrik 2016, pasi kishin kaluar më shumë se 6 vite nga ushtrimi i kallëzimit penal.

Aktakuza ndaj Krasniqit dhe dy të akuzuarve tjerë ishte ngritur më 21 korrik 2016.

Nëse shohim datën e ushtrimit të kallëzimit penal dhe datën kur është nxjerrë aktvendimi për fillim të hetimeve nga ana e prokurorisë, vërejmë se kanë kaluar më shumë se 6 vite.

Pra është e pakuptueshme dhe e palogjikshme se si ky kallëzim penal ka qëndruar në sirtarët e prokurorisë, për më tepër se 6 vite që nga paraqitja e tij, dhe pas kësaj kohe kaq të gjatë, prokuroria ka vendosur që të veprojë.

Më pas, fakti që kishte arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale ndaj të pandehurve Salih Zyba dhe Nderim Matoshi, tregon për një mos efikasitet të prokurorisë në ndërmarjen më kohë të veprimeve hetimore që do të pasonin eventualisht me ngritjen e aktit akuzues. Detyrat dhe kompetencat e Prokurorit të Shtetit janë përcaktuar qartë me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, i cili ligj mes tjerash, në par.1,6 të nenit 7 i jep detyrë dhe kompetencë Prokurorit të

Shtetit ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit, si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale.

IKD konsideron se amnistimi që u ka bërë prokuroria këtyre dy të pandehurve është në shpërputhje të plotë me detyrat dhe përgjegjësitë që kanë prokurorët në respektimin e afateve dhe procedurave ligjore. Po ashtu, IKD konsideron se në rastet e tilla, Prokurori duhet të mbahet përgjegjës dhe në raste të tilla të veprohet me kohë që kjo lëndë t'i transferohej një prokurori tjetër brenda prokurorisë, dhe jo të arrinte afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Sa i përket trajtimit të kësaj lënde në gjykatë, duhet përmendur se Gjykata Themelore në Prishtinë më 20 qershor dhe 24 korrik të këtij viti kishte tentuar mbajtjen e seancës fillestare, por pa sukses, pasi që tre të akuzuarit nuk i ishin përgjigjur thirrjeve të gjykatës. Po ashtu, edhe tentativa e tretë e kësaj gjykate për mbajtjen e seancës fillestare më 10 tetor 2019 ka rezultuar e dështuar, pasi që tre të akuzuarit nuk i janë përgjigjur ftesës së kësaj gjykate.<sup>33</sup>

Pra, pas më shumë se 3 viteve nga ngritja e aktakuzës ndaj tre të akuzuarve të lartëcekur, kjo gjykatë, duke vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e KPPRK-së, ka vendosur mbajtjen e këtij shqyrtimi, edhe pse KPPRK-ja në mënyrë shprehimore ka përcaktuar veprimet procedurale të gjykatës pas ngritjes së aktit akuzues. Pra në par.4 të nenit 242 përcaktohet se shqyrtimi fillestar caktohet brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës në gjykatë.<sup>34</sup>

Nga paraqitja e kallëzimit penal e deri në nxjerrjen e aktvendimit për fillim të hetimeve në këtë rast kanë kaluar **2230 ditë**, apo më shumë se 6 vjet. Ndërsa, aktakuza rezulton të jetë ngritur po të njejtën ditë me nxjerrjen e vendimit për fillim të hetimeve. Ndërsa, që nga ngritja e aktakuzës më 21 korrik 2016, e deri më 10 tetor 2019, kur së fundmi ishte tentuar të mbahej shqyrtimi fillestar, kanë kaluar më shumë se **1177 ditë**. Ky proces gjyqësor pritet të vazhdojë në dhjetor të këtij viti.

**Dëmi i pretenduar:** I pacaktuar.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<sup>33</sup> “Dështon gjykimi ndaj ish-deputetit Frasher Krasniqi dhe dy të tjerëve, akuzohen se sulmuan policët për të mos lejuar arrestimin e Albin Kurtit më 2010”. Betimi për Drejtësi. 10 Tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-ndaj-ish-deputetit-frasher-krasniqi-dhe-dy-te-tjereve-akuzohen-se-sulmuan-policet-per-te-mos-lejuar-arrestimin-e-albin-kurtit-me-2010/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>34</sup> Kodi i procedurës penale, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”

#### 4. Aktakuza ndaj ish-deputetëve për përplasje fizike në një emision televiziv

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** 5005/17

**Vepra penale:** “Lëndim i lehtë trupor”, “Kanosja”,

**Gjykatësi:** Hanefi Jashari

**Prokuror:** Fatmir Behrami

**Të pandehurit:** Frashër Krasniqi, Milaim Zeka

Aktakuza e ngritur nga PTH në Prishtinë ndaj ish-deputetëve Krasniqi e Zeka për përleshjen e “famshme” të 29 shtatorit 2017 në një studio televizive, ishte e mbajtur e fshehur për publikun për më shumë se një vit e gjysmë, derisa “Betimi për Drejtësi” më 19 korrik 2019 kishte raportuar ekskluzivisht për këtë aktakuzë.<sup>35</sup>

PTH në Prishtinë e akuzonte ish-deputetin Frashër Krasniqi se kishte kryer veprën penale “lëndimi i lehtë trupor”, ndërsa ish-deputetin Milaim Zeka e ngarkon me veprën penale “kanosja”.

Sipas aktakuzës, ish-deputetët Krasniqi dhe Zeka akuzohen se me 29 shtator 2017 në një studio televizive, kanë filluar ta fyejnë njëri-tjetrin, ashtu që i pandehuri Frashër Krasniqi ka sulmuar fizikisht deputetin Zeka duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, e më pas Zeka i ishte drejtuar Krasniqit me fjalët “me ty do të merrem pas emisionit”, me ç’rast tek Krasniqi ka shkaktuar ndjenjën e frikësimit se do ti shkaktohet ndonjë të keqe.

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PTH në Prishtinë më 30 shtator 2017 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj tani ish-deputetëve Krasniqi dhe Zeka dhe po të njëjtën ditë kjo prokurori ka nxjerrë edhe aktvendim për fillimin e hetimit.

Ndërsa, aktakuza ndaj dy deputetëve ishte ngritur më 26 tetor 2017, që nënkupton se aktakuza në këtë rast ishte ngritur në afat rekord.

Por, GjTh në Prishtinë vetëm më 23 korrik 2019 ndërmori veprimet e para procedurale për mbajtjen e shqyrtimit fillestar ndaj këtyre dy deputetëve. Por, shqyrtimi fillestar në këtë rast nuk ka arritur të mbahet, ngase dy të akuzuarit nuk u paraqitën në gjykatë.<sup>36</sup> Ndërsa, edhe dy përpjekje të tjera të gjykatës për mbajtjen e seancës fillestare, ajo e 7 gushtit dhe 20 shtatorit ishin treguar të pa suksesshme.<sup>37</sup>

---

<sup>35</sup> *Ekskluzive: Prokuroria ngritë aktakuzë ndaj Frashër Krasniqit dhe Milaim Zekës për përleshjen fizike në Klan Kosova.* Betimi për Drejtësi. 19 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-prokuroria-ngrite-aktakuze-ndaj-frasher-krasniqit-dhe-milaim-zekes-per-perleshjen-fizike-ne-klan-kosova/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>36</sup> *Mungojnë deputetët Frashër Krasniqi dhe Milaim Zeka, dështon të nis gjykimi për përleshjen fizike në Klan Kosova.* Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-deputetet-frasher-krasniqi-dhe-milaim-zeka-deshton-te-nis-gjykimi-per-perleshjen-fizike-ne-klan-kosova/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>37</sup> “Mungojnë ish-deputetët Frashër Krasniqi dhe Milaim Zeka, përsëri dështon të nis gjykimi për përleshjen fizike në Klan Kosova”, Betimi për Drejtësi, 20 shtator 2019 (Shih linkun

Pra, kësaj gjykate i janë dashur më shumë se një vit e gjysmë që të caktoj shqyrtimin fillestar ndaj dy të akuzuarve, veprim ky në kundërshtim me par.4 të nenit 242 të KPPRK-së, i cili përcakton afatin ligjore prej një muaji për mbajtjen e kësaj seance, pas ngritjes së aktakuzës.<sup>38</sup>

Fakti që kjo aktakuzë është mbajtur e “fshehur” si nga prokuroria ashtu edhe nga gjykata paraqet një qasje selektive të sistemit të drejtësisë. Përkundër faktit se në rastin konkret aktakuza ishte ngritur ndaj dy deputetëve të cilët ishin përleshur në një emision televiziv, as PTh në Prishtinë e as GjTh në Prishtinë nuk kishin njoftuar opinionin publik se çfarë ka ndodhur me këtë rast, kur dihet se veprime e tilla të cilat sipas prokurorisë përmbanin elemente të veprës penale, ishin kryer para syve të publikut. Në anën tjetër, në raste të ngjashme, Prokurori i Shtetit lëshon komunikatë për media, gjë të cilën nuk e ka bërë në këtë rast.

Për më tepër, përkundër dështimit të mbajtjes së shqyrtimit fillestar në rastin e parë, edhe dy tentativa të tjera të GjTh në Prishtinë për mbajtjen e shqyrtimit fillestar kanë rezultuar të dështuara, si ajo e 7 gushtit<sup>39</sup> dhe së fundmi, kjo e 20 shtatorit të këtij viti.

Pra, marrë parasysh faktin se kjo aktakuzë është ngritur më 26 tetor 2017, dhe deri më 20 shtator 2019 nuk ishte arritur të procedohej me seancën fillestare, mund të konstatojmë se kanë kaluar më shumë se **725 ditë** dhe ky proces gjyqësor akoma nuk ka filluar.

**Dëmi i pretenduar:** I pacaktuar.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-ish-deputetet-frasher-krasniqi-dhe-milaim-zeka-perseri-deshton-te-nis-gjykimi-per-perleshjen-fizike-ne-klan-kosova/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>38</sup> Kodi i procedurës penale, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

<sup>39</sup> *Mungon gjykatësi, dështon gjykimi ndaj Milaim Zekës dhe Frashër Krasniqit për përleshjen në studio televizive*, Betimi për Drejtësi, 7 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-gjykatesi-deshton-gjykimi-ndaj-milaim-zekes-dhe-frasher-krasniqit-per-perleshjen-ne-studio-televizive/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

## 5. Aktakuza ndaj ish-deputetëve për sulm dhe kanosje ndaj një ish-deputeti në sallën e Kuvendit të Kosovës

### GjTh në Prishtinë

**Numri i lëndës:** P.nr.1879/19

**Vepra penale:** “sulm”, “kanosje”

**Gjykatësi:** Kushtrim Shyti

**Prokuror:** Merita Shala-Muhaxhiri

**Të pandehurit:** Xhavit Haliti, Gani Dreshaj

Në vazhden e aktakuzave të ngritura ndaj politikanëve është edhe kjo të cilën PTh në Prishtinë e ka ngritur ndaj dy ish-deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti dhe Gani Dreshaj, të cilëve u rëndojnë akuzat për veprat penale sulm dhe kanosje ndaj ish-deputetit të LDK-së, Arben Gashi.

Edhe kjo aktakuzë, si në rastin e ish-deputetëve për përleshjen në një emision televiziv, , ishte mbajtur e fshehur për publikun, për tu zbuluar më pas ekskluzivisht për opinionin e gjerë nga “Betimi për Drejtësi”.<sup>40</sup>

PTh në Prishtinë e akuzonte Halitin se në seancën e 18 majit 2018 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me dashje e ka sulmuar tanimë ish-deputetin, përkatësisht të dëmtuarin, Arben Gashi, duke e shtyrë me krah dhe bërryl në gjoks. Ndërsa, Dreshaj akuzohet se pas këtij kontakti fizik mes Halitit dhe Gashit, i ishte drejtuar këtij të fundit me fjalët “kom me ta prish fytyrën”, duke shkaktuar tek i dëmtuari Gashi ndjenjën e ankthit dhe frikës.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 22 qershor 2018 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj Halitit dhe Dreshajt. Kjo prokurori, për këtë rast nuk kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, por kishte ushtruar aktakuzë të drejtpërdrejtë, pasi që sipas saj, provat e siguruara vërtetonin pa mëdyshje se dy të akuzuarit kishin kryer veprat penale që u ngarkoheshin.

Aktakuza ndaj dy ish-deputetëve të Kuvendit të Kosovës ishte ngritur 31 maj 2019, por që nga ajo kohë GjTh në Prishtinë nuk ka ndërmarrë akoma asnjë veprim procedural lidhur me këtë çështje penale.

Kjo bie ndesh me par.4 të nenit 242 i cili në mënyrë shprehimore përcakton veprimet që duhet të ndërmarrë gjykata pas arritjes së aktakuzës në gjykatë. Neni i lartcekur obligon gjykatën që brenda 30 ditëve të caktoj seancën fillestare pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë<sup>41</sup>

---

<sup>40</sup> “Ekskluzive: Aktakuzë ndaj Xhavit Halitit dhe Gani Dreshajt për sulmin dhe kanosjen ndaj Arben Gashit”, Betimi për Drejtësi, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-aktakuze-ndaj-xhavit-halitit-dhe-gani-dreshajt-per-sulmin-dhe-kanosjen-ndaj-arben-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>41</sup> Kodi i procedurës penale, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

Andaj, deri në tetor të këtij viti kanë kaluar më shumë se 4 muaj dhe gjykata nuk ka nisur me trajtimin e këtij rasti, edhe pse KPPRK-ja e obligon për një gjë të tillë.

Veprime të tilla ku aktakuzat ndaj deputetëve mbahen të fshehura dhe shqyrtimi i këtyre aktakuzave zvarritet në procedura gjyqësore, krijojnë tek publiku mosbesim në punën e gjykatës dhe linden dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e saj, si dy parime fundamentale mbi të cilat ajo ndërtohet dhe funksionon.

**Dëmi i pretenduar:** I pacaktuar.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë



## 6. Aktakuza për rastin “Fondi 3%”

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.2022/2017, P.nr.1993/2019

**Vepra penale:** “shpërdorimi”, “shmangie nga tatimi”

**Gjykatësi:** Medie Bytyqi

**Prokuror:** Atdhe Dema

**Të pandehur:** Bujar Bukoshi, Naser Osmani dhe Atdhe Gashi

Ky proces gjyqësor i cili aktualisht është duke u zhvilluar pranë GjTH në Prishtinë është përcjellë me probleme të shumta.

Fillimisht ky rast i ishte ndarë për gjykim në maj të vitit 2018 gjykatëses Albina Shabani-Rama, e cila gjykonte në Departamentin për të Mitur të GjTH në Prishtinë, dhe opinioni publik kishte mësuar për zhvillimin e kësaj procedure vetëm gjatë këtij viti, edhe pse ky gjykim zgjon interesim të madh tek publiku, pasi për këtë fond dhe mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve është përfolur që nga paslufta dhe vazhdon të flitet edhe sot.<sup>42</sup>

Më pas, kjo lëndë në janar të vitit 2019 i ishte ndarë në punë gjykatëses Medie Bytyqi, e cila po procedon aktualisht me dy gjykime të ndara, atë ndaj Bukoshit dhe gjykimin tjetër ndaj dy të akuzuarve të tjerë Naser Osmani dhe Atdhe Gashi.

Bujar Bukoshi, po akuzohet se gjatë viteve 2008-2015, në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar mjete monetare në shumë mbi 90 mijë euro, nga i ashtuquajtimi “Fondi 3 %”, të deponuara në bankën “NLB”, para të cilat i ka tërhequr kesh, por pa arsyetuar se për çfarë qëllimi i ka shfrytëzuar.

Bujar Bukoshi, Naser Osmani dhe Atdhe Gashi, akuzohen se në bashkëkryerje, gjatë viteve 2006-2015, kanë përvetësuar kundërligjshëm mjete monetare në vlerë mbi 154 mijë euro nga banka “BPB”, mjete këto të destinuara për “Fondin 3 %”, pa arsyetuar se për çfarë qëllimi i kanë shfrytëzuar.

Po ashtu, Bujar Bukoshi akuzohet se si Kryetar i Bordit të “UFORK-ut”, i është shmangur pagesave tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës në shumën mbi 39 mijë euro, Naser Osmani se në cilësinë e anëtarit të këtij bordi ka kryer shmangie tatimore në vlerë mbi tre mijë euro dhe Atdhe Gashi për shmangie tatimore në vlerën mbi dy mijë euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PSRK-ja për këtë rast kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve më 8 dhjetor 2014 vetëm ndaj Atdhe Gashit për shpëlarje parash, ndërsa më 14 dhjetor 2015 ka zgjeruar hetimet edhe ndaj të pandehurve Bujar Bukoshi dhe Naser Osmani për shpërdorim. PSRK-ja, me vendimin e nxjerrë më 27 korrik 2016, ndaj të akuzuarve Gashi, Osmani dhe Bukoshi kishte zgjeruar hetimet edhe në drejtim të veprës penale shmangie nga tatimi.

---

<sup>42</sup> “Rasti “Fondi 3%”, caktohen seancat gjyqësore ndaj Bujar Bukoshit, Naser Osmanit dhe Atdhe Gashit”, Betimi për Drejtësi, 21 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-fondi-3-caktohen-seancat-gjyqesore-ndaj-bujar-bukoshit-naser-osmanit-dhe-atdhe-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

PTh në Prishtinë nuk ka ofruar informata se kur është ushtruar kallëzimi penal ndaj këtyre të pandehurve dhe nga kush, andaj është e pamundur që të krahasohet se a janë ndërmarrë këto veprime hetimore brenda afateve ligjore.

Aktakuza ndaj Bukoshit, Osmanit dhe Gashit është ngritur nga PSRK-ja më 28 prill 2017, ndërsa më 30 nëntor 2018 prokurori i PSRK-së Atdhe Dema kishte bërë plotësimin e kësaj aktakuze.

Pas ngritjes së aktakuzës në prill të vitit 2017, GjTh në Prishtinë vetëm në maj të vitit 2018 kishte filluar trajtimin e këtij rasti.

Pra, kjo gjykatë më 23 maj 2018 kishte caktuar shqyrtimin fillestar ndaj Bukoshit, Osmanit dhe Gashit, veprim ky i ndërmarrë një vit e 26 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Pra, caktimi i kësaj seance është ndërmarrë në kundërshtim me nenin 242 të KPPRK-së, i cili obligon gjykatësin që brenda 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës të caktojë seancën fillestare.

Ndërsa, shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale ishte mbajtur më 26 tetor 2018, pra 157 ditë pas mbajtjes së seancës fillestare. Edhe mbajtja e kësaj seance është bërë në kundërshtim me dispozitat procedurale, pasi KPPRK-ja, në par.5 të nenit 245 përcakton se shqyrtimi i dytë caktohet jo më herët se tridhjetë ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar.<sup>43</sup>

Më 23 maj të vitit 2018 ishte veçuar procedura penal ndaj Bujar Bukoshit, me arsyetimin se i njëjti kishte probleme shëndetësore.

Ndaj Bukoshit nuk është arritur të mbahet akoma seanca fillestare,<sup>44</sup> edhe pse kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 5 muaj që nga ngritja e kësaj aktakuze ndaj tij. Ndërsa, procesi gjyqësor është duke vazhduar ndaj Osmanit dhe Gashit në fazën e shqyrtimit gjyqësor.<sup>45</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 244.962 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>43</sup> Kodi i procedurës penale, par.5 i nenit 245 “Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar”.

<sup>44</sup> “Rasti “Fondi 3%”, mungon Bujar Bukoshi, shtyhet në kohë të pacaktuar seanca ndaj tij”, Betimi për Drejtësi, 12 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-fondi-3-mungon-bujar-bukoshi-shtyhet-ne-kohe-te-pacaktuar-seanca-ndaj-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>45</sup> “Rasti “Fondi 3%”, eksperti financiar thotë se Naser Osmani dhe Atdhe Gashi për 6 vjet tërhoqën mbi 800 mijë euro, s’ka dëshmi për mbi 150 mijë euro”, Betimi për Drejtësi, 15 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-fondi-3-eksperti-financiar-thote-se-naser-osmani-dhe-atdhe-gashi-per-6-vjet-terhoqen-mbi-800-mije-euro-ska-deshmi-per-mbi-150-mije-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

## **7. Rasti për mashtrim prej 300 mijë euro transferohet në Prishtinë**

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës: P.nr.3651/2018**

**Vepra penale: “mashtrimi”**

**Gjykatësi: Medie Bytyqi**

**Prokuror: Rukije Shasivari**

**I pandehur: Rrahim Hashimi dhe Kadri Rexhepi**

Lënda ndaj Rrahim Hashimit dhe Kadri Rexhepit fillimisht kishte filluar të gjykohej nga Gjykata Themelore në Ferizaj, por e njëjta më 6 gusht 2018, ishte shpallur jokompetente në pikëpamje territoriale, duke transferuar këtë lëndë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila kishte filluar të procedonte me këtë rast në qershor të vitit 2019.

PTH në Ferizaj e akuzon Hashimin dhe Rexhepin se ata në periudhën kohore prej 30 dhjetor 2011, deri më 24 korrik 2012, në Prishtinë, në zyrën e të dëmtuarit Faton Dalladaku, e cila gjendet në rrugën “Perandori Justinian”, në lagjen “Pejton, së bashku me të pandehurin tjetër Ekrem Lika, i cili ndodhet në arrati, prezantohen rrejshëm para të dëmtuarit dhe atë i akuzuari Rrahim Hashimi, si i afërm i ish-kryeparlamentarit Kadri Veselit dhe ish-deputetit Xhavit Halitit, ndërsa i akuzuari Ekrem Lika si dhëndër i Veselit, ashtu që të tre së bashku kinse po ndërmjetësonin për blerjen e Qendrës Kardiake të Kosovës SH.P.K në Prishtinë nga i dëmtuari Dalladaku.

Prokuroria pretendon se ky ndërmjetësim pretendohej të realizohej kinse mes personit të quajtur Ekrem Lluka si shitës dhe Faton Dalladaku si blerës, ashtu që e nxisin të njëjtin të veprojë në dëm të pasurisë së tij, duke i prezantuar draft-kontrata sipas të cilave arrijnë ta bindin se i akuzuari Rrahim Hashimi, është pronar i Qendrës Kardiake të Kosovës, me 20 për qind të aksioneve, ndërsa Ekrem Lluka me 80 për qind, me ç’rast arrijnë të marrin nga i dëmtuari Dalladaku shumën e përgjithshme të të hollave prej 290 mijë e 810 euro.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

I dëmtuari Faton Dalladaku më 27 korrik 2016 në Drejtorinë e Krimeve të Rënda pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës në Prishtinë kishte deklaruar se nga viti 2011 kishte qenë viktimë e mashtrimit nga grupet kriminale të organizuara.

Më pas, Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike (NJHKEK) në Ferizaj kishte dorëzuar më 26 shtator 2017 materiale dhe shkresa që ndërlidheshin me raportimet e të dëmtuarit Dalladaku, derisa PTH në Ferizaj më 2 nëntor 2017 kishte kërkuar nga NJHKEK në Ferizaj ndërmarrjen e veprimeve hetimore ndaj të dyshuarve Hashimi, Rexhepi dhe Lika.

Vetëm më 29 janar 2018 kjo prokurori kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga NJKEK ndaj Rrahim Hashimit, Kadri Rexhepi dhe Ekrem Likës.

Nëse llogarisim kohën kur i dëmtuari ka paraqitur rastin në polici, pra datën 27 korrik 2016, dhe kohën kur kallëzimi penal është dorëzuar në prokurori nga ana e policisë, 29 janar 2018, rezulton se kanë kaluar 552 ditë, apo më shumë se një vjet e gjashtë muaj.

KPPRK në paragrafin 4 të nenit 70, e obligon policinë që brenda 24 orësh ti dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare.<sup>46</sup>

Ndërsa, NJHKEK vetëm më 26 shtator 2017 kishte dorëzuar një raport të tillë tek PTh në Ferizaj, apo 427 ditë pas i dëmtuari kishte paraqitur rastin në polici.

Aktvendimi për fillim të hetimeve ndaj të pandehurve të lartëcekur ishte marrë 31 janar 2018, ndërsa aktakuza ndaj Hashimit, Rexhepit ishte ngritur më 21 mars 2018, brenda afatit të paraparë ligjorë për ngritjen e aktit akuzues.

Edhe pse aktakuza ishte ngritur më 21 mars 2018, GjTh në Ferizaj nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për caktimin e seancës fillestare, por e njëjta në gusht të vitit 2018 ishte shpallur jokompetente në pikëpamje territoriale për gjykimin e kësaj lënde, duke e transferuar atë në GjTh në Prishtinë.

Pra, GjTh në Ferizaj, i janë dashur afër 5 muaj për ta vlerësuar se a është kompetente në pikëpamje territoriale për t'a gjykuar këtë çështje penale.

Lidhur me këtë, KPPRK-ja në nenin 29 për caktimin e kompetencës territoriale ka theksuar se ajo në parim i jepet gjykatës themelore, brenda territorit të së cilës është kryer ose është tentuar vepra penale ose brenda territorit ku është shkaktuar pasoja.<sup>47</sup>

Andaj, bazuar në aktakuzën e ngritur nga PTh në Ferizaj, dhe sipas përshkrimit faktik të vendit të kryerjes së kësaj vepre penale, rezulton se kjo veprë penale është kryer në Prishtinë, dhe rrjedhimisht duke vepruar konform nenit 29 të KPPRK-së, del se kompetente për gjykimin e kësaj lënde që nga fillimi është dashur të jetë GjTh në Prishtinë.

Andaj, përballë faktit se ligji është shumë i qartë në këtë rast, IKD konsideron se veprimi që lidhur me këtë lëndë të procedohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ka qenë veprim i gabuar, i palogjikshëm dhe i paarsyeshëm, pasi pikërisht për këtë arsye, kjo gjykatë më vonë ishte tërhequr nga gjykimi i këtij rasti, duke ndikuar në zvarritjen e këtij gjykimi.

Tutje, KPPRK-ja ka përcaktuar edhe kritere shtesë për caktimin e kompetencës territoriale, në rastet kur ajo nuk mund të përcaktohet sipas dispozitës së lartcekur. Pra, ky kod në nenin 32 të tij parasheh edhe kritere dytësore për caktimin e kompetencës territoriale, sipas së cilës kompetencë territoriale për të proceduar me rastin ka edhe gjykata në territorin e së cilës i

---

<sup>46</sup> Kodi i procedurës penale, par.4 i nenit 70 “Posa policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t’i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale”.

<sup>47</sup> Po aty, neni 29 “Kompetenca territoriale në parim i jepet gjykatës themelore, brenda territorit të së cilës është kryer ose është tentuar vepra penale ose brenda territorit ku është shkaktuar pasoja”.

akuzuari ka vendbanimin ose vendqëndrimin, kjo në rastet kur nuk dihet territori i përshkruar në paragrafin 1 të nenit 29 të këtij Kodi ose kur ky vend nuk është në territorin e Kosovës.<sup>48</sup>

Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte caktuar seancën fillestare ndaj Hashimit dhe Rexhepit vetëm me 26 qershor 2019, apo 325 ditë pas ngritjes së aktakuzës, apo kur kishin kaluar afër një vit pas pranimit të kësaj lënde nga kjo gjykatë.

Caktimi i seancës fillestare pas 325 ditësh, është në kundërshtim të plotë me afatin e paraparë ligjor për mbajtjen e seancës fillestare, ku par. 4 i nenit 242 të KPPRK-së shprehimisht parasheh caktimin e saj brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë.<sup>49</sup>

Shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale nuk është mbajtur, mirëpo kundërshtimet dhe kërkesat për hudhjen e të akuzuarve janë paraqitur më 24 dhe 27 korrik nga mbrojtja, e të cilat janë refuzuar nga gjykata me vendimin e nxjerrë më 14 gusht 2019. Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale pritet të vazhdojë më 25 tetor.

GjTh në Prishtinë, dy të akuzuarve, Hashimi dhe Rexhpi, në seancën e 14 gushtit u'a ka vazhduar masën e paraburgimit deri më 29 gusht 2019.<sup>50</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 290.810 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<sup>48</sup> Kodi i procedurës penale, par.1 i nenit 242 “Në qoftë se nuk dihet territori i përshkruar në paragrafin .1 të nenit 29 të këtij Kodi ose kur ky vend nuk është në territorin e Kosovës, kompetente është gjykata në territorin e së cilës i pandehuri e ka vendbanimin ose vendqëndrimin”.

<sup>49</sup> Po aty, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

<sup>50</sup> “Pas kthimit në rivendosje u vazhdohet paraburgimi të akuzuarve për mashtrim, Rrahim Hashimi e Kadri Rexhepi”, Betimi për Drejtësi, 14 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/afere-e-fajdeve-pas-kthimit-ne-rivendosje-u-vazhdohet-paraburgimi-rrahim-hashimit-e-kadri-rexhepit/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

## 8. Ish-Drejtori i Kolegjit ISPE, Avni Mazreku dënohet me 3 vjet burgim

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.1946/16

**Vepra penale:** “legalizim i përmbajtjes së rreme”

**Gjykatësi:** Fatime Dërmaku

**Prokuror:** Dren Paca

**I pandehuri:** Avni Mazreku

Procesi gjyqësor që kishte nisur në vitin 2018 ndaj ish-drejtorit të ISPE-së Avni Mazreku, të akuzuar për veprën penale “legalizim i përmbajtjes së rreme”, mori epilogun e tij në prill të vitit 2019.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 3 prill të vitit 2019 shpalli fajtorë Mazrekun për legalizim të përmbajtjes së rreme, duke i shqiptuar atij dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 viteve.<sup>51</sup>

Mazreku akuzohej se më 30 qershor 2014 kishte vënë në lajthim Agjencinë e Kosovës për Akreditim, që në një dokument publik, libër apo regjistër, të vërtetojë një çështje të pavërtetë të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, se kinse e ka kryer pagesën e mbetur ndaj kësaj agjencie në vlerë 19.300 euro, ashtu që si rezultat i këtij veprimi aplikacioni i Kolegjit ISPE ishte akredituar nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Prokuroria Themelore në Prishtinë më 15 janar 2015 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj të pandehurit Avni Mazreku. Më 16 mars 2015, kjo prokurori kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, pra 3 muaj pas pranimit të kallëzimit penal.

Aktakuza që e ngarkonte Mazrekun me veprën penale “Legalizim i përmbajtjes së rreme” ishte ngritur nga PTh në Prishtinë më 26 prill 2016, duke respektuar afatin ligjor për kohëzgjatjen e hetimeve.<sup>52</sup>

Pas pranimit të kësaj aktakuze, Gjykatës Themelore në Prishtinë, i janë dashur afër dy vite që të caktoj seancën fillestare, e cila ishte mbajtur më 19 mars 2018, me ç’rast Mazreku ishte deklaruar i pafajshëm.<sup>53</sup>

---

<sup>51</sup> “Avni Mazreku dënohet me 3 vjet burgim për legalizimin të përmbajtjes së rreme”, Betimi për Drejtësi, 3 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/avni-mazreku-denohet-me-3-vjet-burgim-per-legalizimin-te-permbajtjes-se-rreme/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>52</sup> Kodi i procedurës penale, par.1 i nenit 159 “Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet”.

<sup>53</sup> “Profesori Avni Mazreku deklarohet i pafajshëm për legalizim të përmbajtjes së rreme”, Betimi për Drejtësi, 19 mars 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/profesor-avni-mazreku-deklarohet-i-pafajshem-per-legalizim-te-permbajtjes-se-rreme/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

Pra, caktimi i shqyrtimit fillestar pas dy viteve paraqet shkelje të afatit për mbajtjen e kësaj seance, për arsye se KPPRK-ja ka përcaktuar që gjykata duhet t'a caktojë seancën fillestare brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës.

Më 23 prill 2018, kjo gjykatë kishte refuzuar kundërshtimet dhe kërkesën për hedhje të aktakuzës të ushtruar nga i akuzuari Mazreku, duke proceduar tutje me shqyrtimin gjyqësor.<sup>54</sup>

Nëse marrim parasysh faktin se kallëzimi penal është ushtruar më 15 janar 2015, ndërsa vendimi për fillim të hetimeve nga prokuroria është nxjerrë më 16 mars të po atij viti, mund të konkludojmë se prokurorisë i janë dashur 61 ditë për analizimin e kallëzimit penal.<sup>55</sup>

Kjo aktakuzë është ngritur më 26 prill 2016, ndërsa procesi gjyqësor ka përfunduar në shkallë të parë më 3 prill të vitit 2019. Pra, gjykatës i janë dashur plot **1074** ditë për ta zgjidhur këtë rast, apo 2 vjet e nëntë muaj. Aktualisht kjo lëndë ndodhet në GjA dhe për ankesat e ushtruar ndaj këtij aktgjykimi nuk është vendosur akoma në shkallë të dytë.

**Dëmi i pretenduar:** 19.300 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<sup>54</sup> “Refuzohet kërkesa për hudhje të aktakuzës ndaj Avni Mazrekut, i akuzuar për legalizim të përmbajtjes së rreme”, Betimi për Drejtësi, 23 prill 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohet-kerkesa-per-hudhje-te-aktakuzes-ndaj-avni-mazrekut-i-akuzuar-per-legalizim-te-permbajtjes-se-rreme/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>55</sup> Kodi i procedurës penale, neni 82 “Prokurori i shtetit me aktvendim e hudh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se: 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale; 1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; 1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; 1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose 1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen”.

## **9. Lirohen nga akuza të akuzuarit se kërcënuan kryetarin e OSHP-së për tenderin 21 milionësh**

### **GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.1158/18

**Vepra penale:** “Detyrim”

**Gjykatësi:** Fatime Dërmaku

**Prokuror:** Blerim Igrishta

**Të pandehur:** Naim Sallahu dhe Shaban Lushtakut

Gjykata Themelore në Prishtinë më 4 mars 2019 kishte liruar nga akuza Naim Sallahun dhe Shaban Lushtakun, të cilët nga PTh në Prishtinë akuzoheshin se kanë frikësuar dhe detyruar kryetarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Blerim Dina, lidhur me një tender në vlerë prej 21 milion euro.

Ky aktgjykim liruës ishte shpallur me arsyetimin se nuk ishte provuar se dy të akuzuarit Sallahu e Lushtaku kanë kryer veprën penale me të cilën i ngarkonte aktakuza e PTh në Prishtinë.<sup>56</sup>

PTh në PRishtinë i akuzonte Sallahun dhe Lushtakun se përmes forcës dhe kanosjes, kanë detyruar të dëmtuarin Blerim Dina, në cilësinë e personit zyrtar si kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), që të kryej ndonjë veprim në dëm të pasurisë publike. Sipas prokurorisë, dy të akuzuarit e kanë ndalur të dëmtuarin kinse për të biseduar në lidhje me një tender në shumë prej 21.000.000 euro, i cili ishte në shqyrtim e sipër pranë OSHP-së, e ku të akuzuarit kishin aplikuar.

Më pas prokuroria pretendon se dy të akuzuarit e kanë kanosur seriozisht për jetë të dëmtuarin Dina, duke i'u drejtuar me fjalë se “ky tender ka vlerën e njëzet e një milion eurove, kjo punë duhet të kryhet dhe kushton me jetë”.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PTh në Prishtinë më 18 tetor 2017 kishte pranuar kallëzimin penal nga Policia e Kosovës të ushtruar ndaj Naim Sallahut dhe Shaban Lushtakut dhe po të njejtën ditë prokuroria ka nxjerrë edhe aktvendim për fillim të hetimeve.

Aktakuza ndaj Sallahut dhe Lushtakut ishte ngritur më 6 mars 2018, ndërsa seanca fillestare në këtë rast ishte mbajtur më 12 mars 2018, në përputhshmëri të plotë me afatin e përcaktuar në par.4 të nenit 242 të KPPRK-së.<sup>57</sup>

Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur më 18 prill 2018, apo 38 ditë pas mbajtjes së seancës fillestare. Edhe caktimi i shqyrtimit të dytë në këtë rast është bërë konform par.5 të

---

<sup>56</sup> “Shpallen të pafajshëm të akuzuarit se kërcënuan kryetarin e OSHP-së për tenderin 21 milionësh”, 4 Mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallen-te-pafajshem-te-akuzuarit-se-kercenuan-kryetarin-e-oshp-se-per-tenderin-21-milionesh/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>57</sup> Kodi i procedurës penale, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.



nenit 245 të KPPRK-së, i cili parasheh mbajtjen e kësaj seance jo më herët se tridhjetë ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, ky kod ka paraparë mundësinë e paraqitjes së propozimeve deri në datën e caktuar, por jo më vonë se tridhjetë ditë nga shqyrtimi fillestar, kjo sipas kërkesës së gjykatësit”.<sup>58</sup>

Nëse analizojmë kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor, që nga ngritja e aktakuzës më 6 mars 2018, e deri në shpalljen e këtij aktgjykimi më 4 mars 2019, del se kësaj gjykate i janë dashur **364** ditë për ta përfunduar gjykimin në shkallë të parë. Aktgjykimi lirues i nxjerrë në shkallë të parë është vërtetuar edhe nga GjA me vendimin e nxjerrë më 9 korrik të këtij viti.

**Dëmi i pretenduar:** 21.000.000 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>58</sup> Po aty, par.5 i nenit 245 “Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar”.

## 10. Pushon procedura ndaj ish-këshilltares së ish-ministrit, Blerand Stavileci

### GjTh në Prishtinë

**Numri i lëndës:** P.nr.4658/16

**Vepra penale:** “mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare”

**Gjykatësi:** Adnan Isufi

**Prokuror:** Shpend Krasniqi

**Të pandehur:** Alisa Limaj

Gjykata Themelore në Prishtinë në korrik të vitit 2019 e kishte pushuar procedurën penale ndaj ish-këshilltares së jashtme në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Alisa Limaj, e cila akuzohej për mos deklarim të pasurisë.

Shkak për pushimin e kësaj procedure penale ishte bërë heqja dorë e prokurorit të rastit nga ndjekja penale ndaj të akuzuarës Limaj.

PTh në Prishtinë e akuzonte Limajn se në periudhën kohore nga 1 deri më 31 mars të vitit 2016, në cilësinë e zyrtares së lartë publike, edhe pse ka qenë e detyruar ta bëjë deklarin e pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, ajo nuk ka deklaruar pasurinë në AKK për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2015.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 6 maj 2016 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga AKK ndaj Alisa Limaj, ndërsa vendimin për fillim të hetimeve kjo prokurori e kishte nxjerrë më 30 qershor 2016, apo 56 ditë pas pranimit të kallëzimit penal.

Aktakuza ndaj Limaj ishte ngritur më 4 nëntor 2016, apo kur kishin kaluar **128** ditë pas nxjerrjes së aktvendimit për fillim të hetimeve, duke respektuar në përpikmëri nenin 159 të KPPRK-së, që rregullon kohëzgjatjen e hetimeve, e sipas të cilit hetimi i filluar duhet të përfundohet brenda dy viteve, dhe nëse brenda këtij afati prokuroria nuk ka krijuar dyshim të bazuar mirë për ngritje të aktakuzës apo nuk ka pezulluar hetimet, duhet ta pushojë menjëherë hetimin.<sup>59</sup>

Pas shumë përpjekjeve të dështuara të gjykatës për mbajtjen e shqyrtimit fillestar, më 3 korrik 2019 gjykata kishte arritur të sigurojë pjesëmarrjen e të akuzuarës Limaj në këtë gjykim, duke plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e kësaj seance.

Po në seancën e 3 korrikut 2019, prokurori Krasniqi ishte tërhequr nga ndjekja penale me arsyetimin se e akuzuara e kishte kryer këtë vepër penale si pasojë e pakujdesisë.

Mirëpo nëse analizojmë kualifikimin juridik të kësaj vepre penale, e cila ishte e inkriminuar në nenin 437 të KPRK-së, shohim se aty nuk përcaktohet fare shkalla e fajësisë si element i

---

<sup>59</sup> Kodi i procedurës penale, par.1 i nenit 159 “Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet.

kësaj vepre penale. Por ky nen ka precizuar se është penalisht përgjegjës për kryerjen e kësaj vepre penale, çdo person i cili nuk kishte bërë deklarinimin e pasurisë brenda afatit ligjor, dhe i cili sipas ligjit obligohej të bënte një gjë të tillë.<sup>60</sup>

Ndërsa, Ligji Nr. 04/L-050 Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, ka përcaktuar në mënyrë të qartë personat të cilët janë të obliguar që të bëjnë deklarinimin e pasurisë. Sipas nenit 1.1.3 të këtij ligji, del se një obligim i tillë bie edhe mbi këshilltarët politikë,<sup>61</sup> si persona të cilët ushtrojnë autorizime të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj.

Për më tepër, as vet Prokurori i Shtetit në këtë rast nuk ka deklaruar se në rastin konkret pala nuk ka qenë e obliguar që të bëjë deklarinimin e pasurisë, por se ka thënë “Është tërësisht e kuptueshme se nga pakujdesia e saj ka ardhur deri te mos deklarimi i saj i pasurisë. Andaj, unë si Prokuror i çështjes lidhur me këtë çështje tërhiqem nga ndjekja penale ndaj të akuzuarës Alisa Limaj, konform nenit 52 të Kodit të Procedurës Penale”.<sup>62</sup>

Andaj, IKD konsideron se veprimi i prokurorit në këtë rast për tu tërhequr nga ndjekja penale nuk ka asnjë bazë ligjore dhe është i paligjshëm, sepse e akuzuara Limaj, sipas ligjit për deklarinimin e pasurisë kishte obligim që ta deklaronte pasurisë si rezultat i pozitës së saj si zyrtare e lartë publike, pa marrë parasysh faktin se a ka gjeneruar ajo të hyra nga kjo punë dhe pa marrë parasysh shkallën e dashjes të manifestuar në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale.

Nëse analizojmë kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor që nga ngritja e aktakuzës më 4 nëntor 2016, e deri në përfundimin e këtij procesi gjyqësor më 3 korrik 2019, del se ai ka zgjatur plot 971 ditë apo 2 vjet e tetë muaj.

**Dëmi i pretenduar:** I pacaktuar.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>60</sup> Kodi penal i Republikës së Kosovës, i cili ishte në fuqi deri më 14 prill 2019, par.1 i nenit 437 “Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarinimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës”.

<sup>61</sup> Ligji për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, par.1, pika 1.1.3 “Zyrtar i Lartë Publik - janë: 1.1.3. Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, Zëvendës Ministrat, Këshilltarët politik, Shefat e kabineteve si dhe të gjithë të emëruarit nga ta”.

<sup>62</sup> “Prokurori tërhiqet nga ndjekja penale për mos deklarim të pasurisë ndaj ish-këshilltares së ish-ministrit, Blerand Stavileci”, Betimi për Drejtësi, 3 Korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-terhiqet-nga-ndjekja-penale-per-mos-deklarim-te-pasurise-ndaj-ish-keshilltares-se-ish-ministrit-blerand-stavileci/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

## 11. Parashkruhet lënda në gjykatë për dy të akuzuar

### GjTh në Prishtinë

**Numri i lëndës:** P.nr.2903/11

**Vepra penale:** “mashtrimi”, “mashtrimi i blerësve”.

**Gjykatësi:** Hanefi Jashari

**Prokuror:** Merita Lumezi

**Të pandehur:** Veton Bajgora, Fadil Idrizi dhe Ismet Syla

Procesi gjyqësor ndaj të akuzuarve Veton Bajgora, Fadil Idrizi dhe Ismet Syla kishte nisur qysh në shtator të vitit 2011 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për të përfunduar më 7 maj 2019, pasi kishin kaluar 7 vjet e 8 muaj, apo **2806 ditë** që nga nisja e tij.

Mirëpo, dy të akuzuarit Idrizi dhe Syla, kanë arritur që ti “shpëtojnë” ligjit, pasi ndaj tyre sipas gjykatës, për veprën penale “mashtrimi i blerësve”, kishte arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale qysh në vitin 2016.<sup>63</sup>

Prokuroria Themelore në Prishtinë e akuzonte Bajgorën se me 13 shtator 2010 kishte lidhur kontratë me Policinë e Kosovës për furnizimin e tyre me tonerë, mirëpo i njëjti nuk i ishte përmbajtur kësaj kontrate, duke dërguar tonerë të falsifikuar, ashtu që nga sasia e përgjithshme prej një mijë e 35 copë, 840 ka rezultuar se ishin të falsifikuar, me ç’rast tonerët janë konfiskuar nga Policia e Kosovës.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 23 dhjetor 2010 kishte pranuar kallëzimin penal ndaj të akuzuarve Bajgora, Syla dhe Idrizi të ushtruar nga Policia e Kosovës, dhe po të njëjtën ditë prokuroria edhe kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve.

Aktakuza ndaj tyre ishte ngritur më 20 qershor 2011, brenda afatit të paraparë ligjor për ngritjen e aktit akuzues, të përcaktuar me par.1 dhe 2 të nenit 159 të KPPRK-së.<sup>64</sup>

Seanca e parë në këtë çështje penale ishte tentuar të mbahej më 1 shtator 2011, dhe pas shumë dështimeve të njëpasnjëshme, kjo lëndë më 18 janar 2019 ishte transferuar tek gjykatësi Hanefi Jashari, nga gjykatësja Violeta Namani.

Gjykatësi Jashari, më 4 prill të këtij viti kishte caktuar shqyrtimin fillestar, por mungesa e të akuzuarve kishte bërë që të dështonte kjo seancë.

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur vetëm më 7 maj 2019, ku i akuzuari Bajgora ishte dënuar me 8 muaj burgim me kusht, pasi kishte pranuar fajësinë për një vepër penale e cila sipas prokurorisë supozohet të jetë kryer në shtator të vitit 2010.

---

<sup>63</sup> “Dënohet me kusht njëri i akuzuar për dallavere në tenderin për furnizim me tonerë, për dy të tjerët arrihet parashkrimi”, Betimi për Drejtësi, 7 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-kusht-njeri-i-akuzuar-per-dallavere-ne-tenderin-per-furnizim-me-tonere-per-dy-te-tjeret-arrihet-parashkrimi/>)

<sup>64</sup> Kodi i procedurës penale, par.1 i nenit 159 “Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraparak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet”

Pra, kësaj gjykate i janë nevojitur plot shtatë vite e 10 muaj që të arrinte të mbante shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale. Mbajtja e kësaj seance pasi kishte kaluar një periudhë kaq e gjatë kohore, paraqet një shkelje serioze të par. 1 të nenit 5 të KPPRK-së, ku është paraparë e drejta që çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme.<sup>65</sup>

Mirëpo, po në seancën e 7 majit, gjykatësi Jashari kishte konstatuar se për dy të akuzuarit, Sylja dhe Idrizi kishte arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale qysh në vitin 2016, për veprën penale “mashtrimi i blerësve”, që u vihej atyre në barrë.

Siç dihet, parashkrimi i ndjekjes penale është institut procedural i cili është paraparë edhe në nenin 106 të KPRK-së, dhe i cili pamundëson ndërmarrjen e veprimeve procedurale kur tejkalohet një afat i caktuar ligjor.<sup>66</sup> Ky institut ka për qëllim që shtojë efikasitetin tek organet e ndjekjes dhe gjykatat, që t’i procedojnë dhe zgjidhin rastet me kohë.

Pra, ka qenë neglizhenca e gjykatës, e cila duke mos ndërmarrë veprime për sigurimin e kushteve ligjore mbajtjen e këtij gjykimi, ka sjellë deri te “amnistimi” i këtyre dy të akuzuarve.

Për më tepër, ndaj të akuzuarve Sylja dhe Idrizi ka pasur një aktakuzë aktive edhe në kohën kur veprat penale për të cilat të njëjtit janë akuzuar veçse janë parashkruar. Në këtë mënyrë, edhe për veprën penale për të cilën nuk mund të zhvillohet ndjekje penale, të akuzuarit kanë pasur një aktakuzë në proces kundër tyre.

Në këtë mënyrë, IKD konsideron se gjykata ka vepruar në kundërshtim me par.2 të nenit 5. i cili shprehimisht obligon që gjykatën që të kujdeset me qëllim që procedura të zhvillohet normalisht dhe pa zvarritje, duke pamundësuar çdo keqpërdorim të të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.<sup>67</sup>

Ky kod, i ka dhënë mundësinë gjykatës që të zbatojë edhe masa të tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurve në procedurë penale, në rastet kur ata nuk i përgjigjen thirrjeve të saj për tu paraqitur në sallat e gjyqit. Fillimisht KPPRK-ja, në par.1 të nenit 175 i ka dhënë mundësinë gjykatës që të lëshojë urdhër arrest kur plotësohen këto kushte ligjore: në rastet kur i pandehuri i cili pasi është ftuar me rregull nga gjykata por nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij, ose kur thirrja nuk ka mundur t’i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i ai i shmanget pranimit të thirrjes”.<sup>68</sup>

---

<sup>65</sup>Kodi i procedurës penale, par.1 i nenit 5 “Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme”.

<sup>66</sup> Kodi penal i Republikës së Kosovës, neni 106 “Përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme...”

<sup>67</sup> Kodi i procedurës penale, par.2 i nenit 5 “Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë”

<sup>68</sup> Po aty, par.1 i nenit 175 “Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të lëshojë urdhërarrest me kërkesë të prokurorit të shtetit, ose në rrethana të ngutshme me kërkesë të policisë kur ekzistojnë kushtet nga paragrafi 1 i nenit 187 të këtij Kodi, ose kur i pandehuri i cili pasi është thirrur me rregull nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij ose kur thirrja nuk

KPPRK-ja ka rregulluar edhe situatën kur i pandehuri gjendet në arrati, ashtu që në par.1 të nenit 535 ka paraparë mundësinë që ndaj tij të lëshohet letër rreshtimi, kur plotësohen kushte të caktuara ligjore.<sup>69</sup> Ndaj të akuzuarit i cili nuk gjendet në Kosovë ose ka prova se ai banon jashtë Kosovës, kodi ka paraparë mundësinë që ndaj tij të lëshohet letër rreshtimi ndërkombëtar.<sup>70</sup>

Pra, janë të gjitha këto mundësi ligjore, të cilat gjykata ka mundur t'i zbatojë në mënyrë që të siguronte rrjedhë normale të këtij procesi dhe rrjedhimisht edhe gjykimin brenda një afati më të arsyeshëm kohor.

Nëse krahasojmë kohën që i është dashur gjykatës këtë gjykim, që nga ngritja e aktakuzës më 20 qershor 2011, e deri më 7 maj kur ka përfunduar i tërë procesi, del se asaj i janë dashur plot **2879** ditë, apo shprehur në vite, 7 vjet e 10 muaj.

**Dëmi i pretenduar:** 67 mijë 500 euro.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

ka mundur t'i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i pandehuri i shmanget pranimit të thirrjes”.

<sup>69</sup> Po aty, par.1 i nenit 535 ““Letërreshtimi mund të urdhërohet kur i pandehuri gjendet në arrati, e kundër të cilit është filluar procedura penale për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për të cilën vepër mund të shqiptohet sipas ligjit dënim me të paktën dy (2) vjet burgim dhe kur është lëshuar urdhërarrest ose aktvendim për caktimin e paraburgimit”.

<sup>70</sup> Po aty, par.4 i nenit 535 “Letërrreshtimi ndërkombëtar mund të kërkohet në cilëndo nga situatat e parapara sipas këtij neni, nga ana e autoritetit përkatës kur personi i kërkuar nuk gjendet në Kosovë ose ka prova se personi banon jashtë Kosovës”.

## **12. Neglizhenca qon drejt parashkrimit rastin e të akuzuarve për mashtrim e falsifikim**

### **GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.619/15

**Vepra penale:** “Legalizim i përmbytjes së rreme” “Falsifikimi i dokumenteve”.

**Gjykatësi:** Rustem Begolli

**Prokuror:** Hava Krasniqi

**Të pandehurit:** Ardian Balaj, Fetah Ahmeti, Gëzim Bajrami, Bekim Bajrami.

Sipas aktakuzës së ngritur nga PTh në Prishtinë më 19 shkurt 2015, të pandehurit Ardian Balaj dhe Fetah Ahmetaj me 18 janar 2013, në kompaninë “Amar”, pronë e të pandehurit Fetah Ahmetaj, kishin falsifikuar dokumentet në atë mënyrë që kishin përpiluar kontratën e shitblerjes në mes Sedat Ramadanit dhe të pandehurit Ardian Balaj, për veturën e cila ishte pronë e të dëmtuarit Kadri Sijarina.

Për shkak se i pandehuri Ardian Balaj, me po këtë kontratë kishte regjistruar automjetin e tij në Qendrën e Regjistrimit në Ferizaj, Prokuroria Themelore e Prishtinës atë e ngarkon edhe për kryerjen e veprën penale të legalizimit të përmbytjes së rreme.

Për falsifikim të kontratave për shitjen e automjeteve, pronë e të dëmtuarit Kadri Sijarina, akuzohen edhe Gëzim Abazi dhe Bekim Bajrami.

Në aktin akuzues thuhet se me 15 janar 2013 në Kompaninë e Sigurimeve “Kroacia” në Ferizaj, i pandehuri Gëzim Abazi kishte falsifikuar dokumentin dhe kishte lidhur kontratën në mes Rama Mengjiqit si shitës dhe Munish Janozit si blerës, ku objekt i kontratës ishte vetura e të dëmtuarit Kadri Sijarina.

Ndërsa, sipas aktakuzës, Bekim Bajrami për shitjen e veturës së të dëmtuarit Kadri Sijarina, kontratën e kishte falsifikuar me 9 nëntor 2012 në kompaninë e sigurimeve “Grave Elsing” në Prishtinë.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Më 5 dhjetor 2018 “Betimi për Drejtësi” kishte prezantuar hulumtimin “Vjetërsimi i lëndëve në Gjykatë?”, i cili kishte prezantuar gjetjet lidhur me këtë rast.

Në këtë hulumtim, “Betimi për Drejtësi” kishte gjetur se kjo lëndë është pranë parashkrimit, dhe se deri tek ky parashkrim kishte ardhur për arsye se në mungesë të palëve, seancat ishin shtyer vazhdimisht. Për më tepër, përkundër kërkesave të palëve, Gjyqtari i rastit, Rustem Begolli, nuk kishte ndërmarrë veprimet ligjore për sigurimin e prezencës së të pandehurve në procedurë.

Kjo kishte ndodhur vetëm pas prezantimit të hulumtimit në emisioni “Betimi për Drejtësi”.<sup>71</sup>

Pikat kryesore në të cilat ishte gjetur neglizhencë ishin lëshimi i fletërreshtimit vendor dhe ndërkombëtar nga PTh në Prishtinë si dhe lëshimi i urdhërarresteve vendore dhe ndërkombëtare nga gjyqtari i rastit, Rustem Begolli.

Ndryshe, kallëzimi penal në këtë rast ishte ushtruar më 19 qershor të vitit 2013, ndërsa PTh në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë në këtë rast më 19 shkurt të vitit 2015.

E për më shumë se një vit lënda kishte qëndruar në sirtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë, derisa me të ishte ngarkuar gjykatësi Rustem Begolli.

Shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale ishte mbajtur më 18 prill 2016, që i bie se gjykatës, që nga ngritja e aktakuzës deri në shqyrtim fillestar i janë nevojitur **424 ditë**. Ndërkaq, shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 7 mars 2017, apo **336 ditë** nga mbajtja e seancës fillestare, përkundër që sipas KPPRK-së është paraparë që afati për mbajtjen e shqyrtimi të dytë duhet të jetë jo më pak se 30 ditë dhe jo më vonë se 40 ditë nga mbajtja e seancës fillestare.

Mungesa e të akuzuarve dhe mos sigurimi i pranisë së tyre përmes mekanizmave ligjorë, po ashtu edhe mos lëshimi i fletërreshtimi ndërkombëtarë duke e ditur vendodhjen e të akuzuarit, kanë bërë që të zvarritet procedura ndaj të akuzuarve.

Ky rast dëshmon atë që IKD e thotë tash e disa vite, se në parashkrimin e lëndëve nuk ndikojnë vetëm aspektet objektive, siç potencojnë përfaqësuesit e sistemit gjyqësor. Por, në këtë proces ndikojnë edhe faktorët subjektivë, përkatësisht neglizhenca e gjyqtarëve përkitazi me këto raste, që për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit, nuk mund të marrin epilog.

Krahas këtij rasti si dhe sqarimeve të dhëna në këtë raport mbi dukurinë e parashkrimit të rasteve, IKD vlerëson se KGJK-ja përmes mekanizmave të saj për kontrollimin e sistemit gjyqësor, duhet të mbajë përgjegjës gjyqtarët, për neglizhencën e të cilëve lëndët arrijnë afatin e parashkrimit. Arsyetimi se lëndët parashkruhen për shkak të numrit të madh të lëndëve dhe mungesës së gjyqtarëve, nuk është argument i qëndrueshëm në secilin rast.

**Dëmi i pretenduar:** Dy vetura

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>71</sup> “Vjetërsimi i lëndëve në Gjykatë?” Betimi për Drejtësi. 5 dhjetor 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/vjetersimi-i-lendeve-ne-gjykate/>). (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2019).



### **13. Dënohet me burg pasi që kishte blerë pula e gjela të vjedhur**

#### **GjTh në Prishtinë - Dega në Lipjan**

**Numri i lëndës:** P.nr.124/17

**Vepra penale:** “Blerja, pranimi, ose fshehja e sendeve të përfituara e kryerjen e veprës penale”

**Gjykatësi:** Selman Salihi

**Prokuror:** Remzush Latifi

**Të pandehurit:** Kastriot Gashi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, në dhjetor të vitit 2018, kishte shqiptuar dënim prej një muaji burg për të akuzuarin Kastriot Gashi, pasi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dyshohej se kishte blerë nëntë pula dhe dy gjela të vjedhur.

Ky dënim i shqiptuar, me pëlqimin e të akuzuarit është shëndrruar në dënim me gjobë, në lartësi prej 200 euro.

Ai akuzohej për veprën penale “blerje pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale”, pasi që sipas prokurorisë, i akuzuari Gashi me qëllim që vetit t’i sjellë pasuri të kundërligjshme, i kishte blerë nëntë pula dhe dy gjela, nga dy persona të mitur në vlerë prej 60 euro, pronë e tani të dëmtuarit Skender Bislimi.

Në aktakuzë thuhet se i akuzuari Gashi, ka mundur t’a dijë se të njëjtat janë përfituar me kryerjen e veprës penale, me ç ‘rast të dëmtuarit Bislimi, i ka shkaktuar dëm material.

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Prokuroria Themelore në Prishtinë për këtë rast, më 6 shkurt 2016 kishte ngritur aktakuzë, kur kishin kaluar më shumë se një vit pas ushtrimit të kallëzimit penal.

E seanca fillestare ishte mbajtur më 20 dhjetor 2018, apo **925 ditë** pas ngritjes së aktakuzës, përkundër faktit që KPPRK-ja ka përcaktuar se seanca fillestare duhet të caktohet menjëherë dhe atë brenda 30 ditësh nga ngritja e aktakuzës në gjykatë.

Ndërsa shqyrtimi i dytë nuk është caktuar fare në këtë proces gjyqësor, pasi që i akuzuari kishte pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar dhe me këtë edhe kishte përfunduar procedura penale në fjalë.

Përpos kësaj, IKD, ka gjetur se në këtë rast kemi të bëjmë me rastet ku gjykata e prokuroria zhvillojnë procedura gjyqësore ndaj personave që dyshohet se kanë kryer vepra penale të cilat sipas KPRK-së janë kategorizuar si “*vepra të rëndësisë së vogël*”

Ndonëse vepra të tilla plotësojnë elementet e veprave penale, ato nuk përbejnë rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Vepra këto që sipas, KPRK-së përkufizohen si “*Nuk përbën veprë penale ajo veprë e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj, paraqet veprë të rëndësisë së*

*vogël. Vepra është e rëndësishme së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit”<sup>72</sup>*

Përkundër kësaj prokuroria ka ngritur aktakuzë e gjykata ka zhvilluar procedurë ndaj personit të akuzuar për blerjen e pulave e gjelave të vjedhur, ku shuma totale e të cilëve shkon rreth 60 euro.

**Dëmi i pretenduar:** 60 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>72</sup> “Kodi Penal i Republikës së Kosovës” neni 315 par.2

#### **14. Gjashtë muaj burg me kusht për blerjen e një akululatori 5 euro**

**GjTh në Mitrovicë, dega në Vushtri**

**Numri i lëndës P.nr.89/18**

**Vepra penale:** “Blerja, pranimi, ose fshehja e sendeve të përfituara e kryerjen e veprës penale”

**Gjykatësi:** Agron Maxhuni

**Prokuror:** Danijela Batkovic

**I/E Pandehur:** Nasuf Strana

Nasuf Strana u dënua me 6 muaj burg me kusht, pasi me 5 euro që kishte blerë një akumulator i cilili sipas prokurorisë kishte qenë i vjedhur.

Lidhur me këtë rast, i akuzuari Strana në seancën e mbajtur më 20 dhjetor 2018, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtri e kishte pranuar fajësinë për veprën që i vihej në barrë.<sup>73</sup>

Ky pranim i fajësisë ishte aprovuar nga gjykata, e cila të akuzuarit Strana në seancën e 21 dhjetorit i kishte shqiptuar aktgjykim dënues, duke e dënua me gjashtë muaj burgim me kusht. Ky dënim i shqiptuar ndaj Stranës nuk do të ekzekutohet, nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti.<sup>74</sup>

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PTh në Mitrovicë, më 1 mars 2018, kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë<sup>75</sup> ndaj të akuzuarit Nasuf Strana, me pretendimin se ai kishte blerë një bateri të veturës (akumulator) në shumën prej pesë euro, për të cilin, sipas prokurorisë, e ka ditur se ka qenë i vjedhur nga e mitura, B.M.

Ndërsa, për rastin në fjalë PTH në Mitrovicë kishte pranuar kallëzimin penal më 7 prill 2016 nga Policia e Kosovës, me dyshimin që i njejtë kishte kryer vepër penale.

Pas ngritjes së aktit akuzues në mars të vitit 2018, shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale ishte mbajtur më 20 dhjetor të po atij viti, apo rreth 205 ditë pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë, duke mos u respektuar afati prej 30 ditës i paraparë me KPPRK.

Ndërsa shqyrtimi i dytë nuk është caktuar fare në këtë proces gjyqësor, pasi që i akuzuari kishte pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar dhe me këtë edhe ka përfunduar procedura penale ndaj tij.

---

<sup>73</sup> “Pranon fajësinë i akuzuari se bleu për pesë euro një bateri të vjedhur”. Betimi për Drejtësi. 20 Dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pranon-fajesine-i-akuzuari-se-bleu-per-pese-euro-nje-bateri-veture-te-vjedhur>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>74</sup> “Dënohet me gjashtë muaj burg me kusht i akuzuari qe-pranoi-se-bleu-per-pese-euro-nje-bateri-veture-te-vjedhur”. Betimi për Drejtësi. 21 Dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-gjashte-muaj-burg-me-kusht-i-akuzuari-qe-pranoi-se-bleu-per-pese-euro-nje-bateri-veture-te-vjedhur>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>75</sup> Kodi i Pcedures Penale, neni 101 par.2 “kur ka dyshim të bazuar, për një vepër penale të cilat nuk dënohen më shumë se 3 vjet, mund të ngris aktakuzë të drejtpërdrejtë, pa zhvilluar hetime”

Ndryshe, këtu kemi të bëjmë me rastet ku gjykata e prokuroria zhvillojnë procedura gjyqësore ndaj personave që dyshohet se kanë kryer vepra penale të cilat sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës janë kategorizuar si vepra të rëndësisë së vogël.

Ndonëse vepra të tilla plotësojnë elementet e veprave penale, ato nuk përbejnë rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Vepra këto që sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkufizohen si *“Nuk përbën veprë penale ajo veprë e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj, paraqet veprë të rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit”*<sup>76</sup>

E se vepra penale e cila përmban shkallë të vogël të rrezikshmërisë, ndonëse mbetet e kundërligjshme nuk konsiderohet veprë penale thuhet edhe në komentarin e KPRK-së.<sup>77</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 80 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<sup>76</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës

<sup>77</sup> Shënim: *“Instituti i veprës së rëndësisë së vogël është paraparë për rastet e lehta të veprave penale, të cilat jo rrallë kryhen në jetën e përditshme. Përkatësisht, ky institut duhet të aplikohet për rastet e veprave penale të lehta, siç janë, p.sh., dëmtimi i pasurisë, vjedhja, mashtrimi, fshehja, lëndime të lehta trupore, kanosje, privimi i kundërligjshëm i lirisë që zgjatë shumë shkurt (një apo dy orë) etj.. Veprat e këtilla humbasin karakterin kriminal për shkak të rëndësisë së vogël, të parëndësishme të kundërligjshmërisë dhe fajësisë. Nga kjo del qartë se për të drejtën penale nuk është i rëndësishëm çdo lloj i realizimit të figurës ligjore të veprës penale, çdo lloj i rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës juridike. Përkundrazi, në të drejtën penale, si vepra penale konsiderohen veprat që përmbajnë në vete një vëllim a intensitet të caktuar të rrezikimit apo të dëmtimit të së mirës juridike, që është e mbrojtur me të drejtën penale”*

## **15. E pandehura figurë publike, mbyllet për publikun**

**GjTh në Ferizaj, Dega në Kaqanik**

**Numri i lëndës P.nr.697/17**

**Vepra penale:** “Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”

**Gjykatësi:** Shabi Idrizi

**Prokuror:** Agim Kuka

**I Pandehur:** Morena Taraku

Më 22 nëntor 2018, ishte paraparë të mbahet seanca fillestare ndaj këngëtarës Morena Taraku, e cila po akuzohej se kishte kryer veprën penale “pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”

Me arsyetimin se e akuzuara Morena Taraku është fytyrë publike, kjo seancë ishte mbyllur për publikun.

Sipas prokurorisë, Taraku më 17 maj 2014, në Han të Elezit, përkatësisht në pikën kufitare në hyrje nga Republika e Maqedonisë, gjatë kontrollit nga zyrtarët policor, pasi fillimisht i kishte fyer rëndë, ka tentuar të pengojë zyrtaren policore-të dëmtuarën Fitore Mjaku në kryerjen e detyrës zyrtare.

Sipas aktakuzës, Taraku, nuk i ishte bindur urdhrin zyrtar, dhe kishte rezistuar duke e shtyrë policen, dhe duke e lënduar atë në gishtin e parë të dorës së djathtë, me ç ‘rast të dëmtuarës Mjaku i shkakton lëndim të lehtë trupor.

E lidhur me këtë rast gjykatësi Idrizi më 29 janar 2019, ka hedhur aktakuzën me aktvendim i cili është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 15 shkurt 2019, duke u refuzuar kështu ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Sipas aktakuzës, vepra penale pretendohet të jetë kryer më 17 maj të vitit 2014, ndërsa aktakuza në këtë rast është ngritur pas **1,276 ditësh**, më 9 nëntor 2017.

Ndërsa, 365 ditë pas ngritjes së aktakuzës, ishte mbajtur seanca fillestare në këtë rast.

### **Përjashtimi arbitrar i publikut**

Në seancën fillestare të mbajtur në nëntor të vitit të kaluar, gjykatësi Shabi Idrizi, kishte vendosur që seanca ngaj këngëtares Taraku **të mbyllet, me arsyetimin se e njëjta ishte fytyrë publike.**

Por arsyetimi me të cilin ishte mbyllur për publikun, nuk është paraparë me nenin 294 të KPPRK-së, dhe se përjashtimi i publikut në mënyrë të kundërligjshme, përbën shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedures Penale.<sup>78</sup>

“Arsyetimi i aktvendimit duhet të jetë konkret, pa ndonjë qasje shablloni dhe rutinore. Ai duhet të përmbajë bazën ligjore sipas të cilës është përjashtuar publiku, e bazë ligjore mund të jetë vetëm ndonjëri prej shkaqeve të parapara në nenin 294” thuhet në Komentarin e KPPRK-së.

**Dëmi i pretenduar:** Nuk është caktuar

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>78</sup> Shënim: “Neni 294 [Përjashtimi i publikut] 1. Nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për: 1.1. Ruajtjen e fshehtësisë zyrtare; 1.2. Ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohet nga shqyrtimi i hapur; 1.3. Ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit; 1.4. Mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë; 1.5. Mbrojtjen e interesave të fëmijëve; ose 1.6. Mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, siç parashihet në Kapitullin XIII të këtij Kodi.

## **16. Lirohen përfundimisht nga aktakuza HIP Petrol dhe Drejtori i saj për furnizim me naftë jociësore.**

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës** P.nr.3988/15

**Vepra penale** : “Mashtrimi i Blerësve” “Mashttrim”

**Gjykatësi:** Rustem Begolli

**Prokuror:** Atdhe Dema

**I Pandehur:** Kujtim Bucaliu, Kompani “HIB” Petrol

PTh në Prishtinë, më 6 korrik 2015 kishte ngritur aktakuzë ndaj “HIB” Petrol sh.p.k dhe pronarit të saj Kujtim Bucaliu, të cilët ngarkoheshin me veprën penale mashtrim dhe mashtrim i blerësve.

Sipas Prokurorisë, nga viti 2012 e deri në vitin 2014, “HIB Petrol” sh.p.k dhe e dëmtuara–Komuna e Prishtinës, kishin nënshkruar kontratë për furnizimin me naftë të 44 institucioneve edukativo-arsimore brenda territorit të Komunës së Prishtinës për ngrohje dhe gjenerator. Personi përgjegjës i personit juridik “HIB Petrol” sh.p.k me vetëdije kishte mashtruar Komunën e Prishtinës me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të fondeve publike për vete. Të njëjtit kishin siguruar vajra gazore për ngrohje nga burime të paidentifikuara, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve përmes fletëpagesave lidhur me përmbajtjen dhe cilësinë e naftës.

“HIB Petrol”, sipas kontratës e kishte mashtruar Komunën e Prishtinës që të veprojë në dëm të pasurisë së saj, duke i ofruar naftën e cila nuk përkonte me kriteret dhe cilësitë e karburanteve të lëngëta të naftës të parapara me neni 7 të udhëzimit administrative. Si dhe duke tejkuluar prezencën prej 10,0mg/kg të sulfurit në naftë, madje sipas ekspertit të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor nafta kishte sasi sulfuri 13 herë më shumë se sa lejohet.

Andaj sipas gjykatësit Rustem Begolli, ishte vërtetuar se të akuzuarit ishin kryerës të kësaj vepre penale, dhe me rastin e shpalljes së aktgjykimit më 18 maj të vitit 2018, drejtorit gjeneral të “HIB Petrol”, Kujtim Bucaliut i kishte shqiptuar një dënim unik prej katër vjetësh burgim dhe 15 mijë euro gjobë.

Ndërsa “HIB Petrol”, me përfaqësuesin Shkelzen Hetaj, për mashtrim ishte dënuar me 25 mijë euro gjobë, kurse për atë të mashtrimit të blerësve ishte dënuar me tetë mijë euro gjobë, me një dënim unik prej 30 mijë euro

Por i pakënaqur me vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë ishte i akuzuari Bucaliu, cili në 24 shtator i ishte drejtuar Gjykatës së Apelit, nga e cila kishte kërkuar lirimin nga akuza apo kthimin e rastit në rigjykim.

Gjykata e Apelit më 26 shtator të vitit 2018, rastin e kishte kthyer në rigjykim, ku kishte kërkuar përshkrimin e veprimeve inkriminuese ndaj të akuzuarve.

Pas kthimit në rigjykim, më 13 nëntor 2018, gjykatësi i rastit Rustem Begolli kishte kërkuar nga PTh në Prishtinë që të bënte plotësimin e kësaj aktakuze duke përkrahur në mënyrë të detajuar veprimet inkriminuese të të akuzuarve.

“Aktakuza nuk i përmban në mënyrë të detajuar veprimet inkriminuese të dy të pandehurve, dhe veprat për të cilat akuzohen veç e veç, andaj prokuroria ta plotësojë aktakuzën sa i përket veprimeve inkriminuese”, kishte deklaruar gjykatësi Begolli.<sup>79</sup>

GjTh në Prishtinë, më 10 maj 2019, kishte nxjerrë aktgjykim me të cilin i kishte liruar përfundimisht nga akuza “HIB” Petrol sh.p.k dhe Drejtorin gjeneral të saj Kujtim Bucaliu.

Sipas gjykatësit Begolli, pas analizimit të provave gjykata ka arritur në përfundimin se nuk është tejkualuar dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari dhe kompania e tij kanë kryer veprat penale që u ngarkoheshin.<sup>80</sup>

Kjo lëndë, më 1 tetor të këtij viti është pranuar në GjA, ku tani për herë të tretë pritet të vendoset për këtë çështje penale.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Komuna e Prishtinës, më 27 maj të vitit 2014, kishte ushtruar kallëzim penal të datës 22 maj 2014 kundër “ Hib” Petrol sh.p.k dhe personit përgjegjës të personit juridik për veprat penale “mashtrimi” dhe “mashtrimi i blerësve”, “legalizim i përmbajtjes së rreme” dhe “ mbajtja e paligjshme e substancave dhe mbeturinave të rrezikshme”.

PTh në Prishtinë, më 6 korrik 2015, apo **406 ditë** pas pranimit të kallëzimit penal, kishte ngritur aktakuzë ndaj “HIB” Petrol sh.p.k dhe pronarit të saj Kujtim Bucaliu.

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 2 dhjetor të vitit 2015, apo **149 ditë** pas ngritjes së aktakuzës në Departamentin e Krimeve të Rënda, dhe pas katër muajsh nga ngritja e aktakuzës, gjykatësi Florent Latifaj, lëndën e kishte deleguar në Departamentin e Përgjithshëm me arsyetimin se kjo lëndë binte në kompetencë të këtij departamenti.

Një veprim të tillë gjykatësi e kishte bërë pas **6 ditësh** nga mbajtja e shqyrtimit fillestar. Kjo lëndë më pas ishte trajtuar nga Rustem Begolli, ku shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 14 shkurt të vitit 2017, 1 vit e gjysëm pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar apo **449 ditë**.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<sup>79</sup> “Gjykata kërkon plotësimin e aktakuzës në rigjykimin e rastit “HIB Petrol”, prokuroria e mbrojtja e kundërshtojnë”, Betimi për Drejtësi, 13 Nëntor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-kerkon-plotesimin-e-aktakuzes-ne-rigjykimin-e-rastit-hib-petrol-prokuroria-e-mbrojtja-e-kundershtojne/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>80</sup> “Pas rigjykimit, drejtori i “HIB Petrol” lirohet nga akuzat për furnizim me naftë jociësore në shkollat e Prishtinës”, Betimi për Drejtësi, 10 Maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-drejtori-i-hib-petrol-lirohet-nga-akuzat-per-furnizim-me-nafte-jocilesore-ne-shkollat-e-prishtines/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)



## 17. Akuzohet gabimisht personi për vjedhje rryme

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.963/16

Vepra penale: “vjedhja e shërbimeve komunale”,

Gjykatësi: Kushtrim Shyti

Prokuror: Ajshe Ferati

Të pandehur: Abdullah Xhemajli

Gjykata Themelore në Prishtinë në maj të këtij viti kishte marr vendim për hedhjen e aktakuzës ndaj të akuzuarit për vjedhje të rrymës, Abdullah Xhemajli.

Ky aktgjykim ishte rrjedhojë e tërheqjes nga ndjekja penale të prokurores së PTh në Prishtinë, pasi sipas saj, është vërtetuar se personi i akuzuar nuk është ai që ka kryer një vepër të tillë penale, por që bëhet fjalë për një person tjetër që ka emrin e njëjtë.<sup>81</sup>

PTh në Prishtinë e akuzonte Abdullah Xhemajlin, se prej datës së pavërtetuar deri më 13 mars 2014, kishte shfrytëzuar pa autorizim energjinë elektrike në shtëpinë e tij dhe me një kablo është kyçur direkt në rrjet, jashtë njehsorit, kështu që energjia e shpenzuar elektrike nuk është regjistruar fare, me çka ka shkaktuar dëm material në shumën prej 903.62 euro.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 17 qershor 2014 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga KEDS-i ndaj Abdullah Xhemajlit.

Kjo prokurori nuk kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, por më 26 shkurt të vitit 2016, kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj të akuzuarit Xhemajli.

KPPRK-ja, në par.2 të nenit 101 ka paraparë mundësinë e ngritjes së aktakuzave të drejtpërdrejtë, pa zhvillim të hetimeve, për veprat penale të dënueshme deri në tri vjet burgim.<sup>82</sup>

Seanca fillestare në këtë rast ishte caktuar më 2 maj 2019, apo kur kishin kaluar **1162 ditë**, apo shprehur në vite, tre vite e dy muaj që nga data e ngritjes së kësaj aktakuze.

Kjo paraqet shkelje të afatit të paraparë me par.4 të nenit 242 të KPPRK-së, ku përcaktohet qartë obligimi që ka gjykata në caktimin e kësaj seance brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktit akuzues.<sup>83</sup>

---

<sup>81</sup> “Prokuroria tërhiqet nga ndjekja penale pasi që ka akuzuar gabimisht personin për vjedhje rryme”, Betimi për Drejtësi, 2 Maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-ndjekja-penale-pasi-ge-ka-akuzuar-gabimisht-personin-per-vjedhje-rryme/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>82</sup> Kodi i procedurës penale, par.2 i nenit 101 “Kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një vepër penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim, dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi”.

<sup>83</sup> Po aty, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

Po në seancën e 2 majit të këtij viti, prokurorja e PTh në Prishtinë, kishte marrë vendim për t'u tërhequr nga ndjekja penale, me arsyetimin se Abdullah Xhemajli, nuk ishte personi që kishte kryer këtë vepër penale, por se bëhet fjalë për një person tjetër që kishte rastisur të ketë emër të ngjashëm si tani i akuzuari.

Kjo bie në kundërshtim të plotë edhe me dispozitën e nenit 241, ku në nënpar.1.2 të par.1 të këtij neni përcaktohen qartë elementet të cilat duhet t'i përmbajë një aktakuzë, e mes tjerash përmendet “emri dhe mbiemri i të pandehurit dhe të dhënat e tij personale”.<sup>84</sup> Pra është veprim i papranueshëm i prokurorit të rastit, që të mos bëjë verifikimin e të dhënave personale të personit i cili dyshohet se ka kryer një vepër penale të caktuar, por vetëm të bazohet në kallëzimin penal të ushtruar nga KEDS-i.

Veprime të tilla shpërfaqin një mungesë profesionalizmi dhe kanë ndikuar që shumë persona të persekutohen pa të drejtë nga organet e ndjekjes, apo të mbahen në evidencat penale për vite të tëra pa të drejtë, për shkakun e vetëm që prokuroria ka ngritur aktin akuzues, bazuar në informatat e siguruar nga një kallëzim penal, apo për faktin e vetëm se kanë një emër i cili ngjason me dikë tjetër.

Nëse analizojnë kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor që nga ngritja e aktakuzës më 26 shkurt të vitit 2016 dhe përfundimin e këtij procesi më 2 maj 2019, del se ky rast kishte marrë epilog pasi kishin kaluar **1162 ditë**. Pra, në këtë rast është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e paraparë me nenin 31 të saj. Në par.2 të këtij neni, përcaktohet se “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.<sup>85</sup>

**Dëmi i pretenduar:** 903.62 euro.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>84</sup> Po aty, nënpar.1,2, par.1 i nenit 24, ku thuhet: Aktakuza përmban “emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale...”

<sup>85</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, par.2 i nenit 31 “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

## **18. Akuzohet gabimisht se kishte vjedhur pyllin**

**GjTh Gjakovë, dega Malishevë**

**Numri i lëndës:** P.nr.190/17.

**Vepra penale:** “vjedhja e pyllit”.

**Gjykatësi:** Lulzim Paçarizi.

**Prokurori:** Ramiz Buzhala.

**I Pandehur:** Bajram Rudi.

Në GjTh në Gjakovë, dega në Malishevë më 27 dhjetor 2018, ishte paraparë të mbahej seanca fillestare ndaj të akuzuarit për vjedhje pylli, Bajram Rudi.

Por gjatë kësaj seancë u vërtetua se personi që ishte thirrur si i akuzuar, nuk është ai që dyshohej se kishte kryer veprën penale, por që bëhet fjalë për një person tjetër, i cili kishte emër të njëjtë.<sup>86</sup>

Në rrethana të tilla, Gjykatësi i çështjes Lulzim Paçarizi, pas kërkesës së prokurorit për plotësim të aktakuzës, kishte marrë aktvendim që aktakuza ndaj Bajram (Zymer) Rudi, të kthehej në plotësim, pasi që i njëjti po akuzohej gabimisht, dhe sipas kallëzimit penal kishte të bënte me një person tjetër, me emër dhe mbiemër të njëjtë.

PTH në Gjakovë, më 8 qershor 2017 kishte ngritur aktakuzë ndaj Bajram (Zymer) Rudit, dhe ai akuzohej se me qëllim që vetit t’i sillte përfitim pasuror, me qëllim vjedhje, kishte prerë 230 copë dru, të llojit bingu dhe qarri, me ç’rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Njësia Pyjore në Malishevë, i kishte shkaktuar dëm në vlerë prej 368 euro.

### **Neglizhenca në trajtimin e rastit, shkeljet e afateve ligjore dhe moskordinimi midis prokurorive**

Si rezultat i mos zhvillimit të hetimeve dhe ngritjes së aktakuzës së drejtpërdrejtë, prokuroria nuk kishte verifikuar saktë identitetin e personit të akuzuar, dhe si rrjedhojë gabimisht është akuzuar një person për një vepër që ai nuk e ka kryer, me arsyetimin se kishte emrin dhe mbiemrin e njëjtë me një person tjetër, i cili ishte kryerës potencial i kësaj vepre penale.

Një ngatërresë e tillë ishte kuptuar qysh në seancën fillestare të caktuar nga GjTh në Gjakovë, pasi që sipas vet prokurorit, Ramiz Buzhala, kishte një mospërputhje në mes të dhënave personale të përfshira në kallëzim penal dhe në aktakuzë.

PTH në Gjakovë më 14 Nëntor të vitit 2016 kishte pranuar kallëzimin penal ndaj tani të akuzuarit Bajram Rudi, ndërsa më 8 qershor 2017 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj tij.

---

<sup>86</sup> “ Prokuroria-ne-gjakove-gabimisht-akuzon-personin-per-vjedhje-pylli-kthehet-ne-plotesim-aktakuza”. Betimi për Drejtësi. 27 dhjetor 2018 (Shih linkun. <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ne-gjakove-gabimisht-akuzon-personin-per-vjedhje-pylli-kthehet-ne-plotesim-aktakuza>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

Ndërsa, seanca e shqyrtimit fillestar për këtë çështje penale ishte mbajtur më 27 dhjetor 2018, pra 18 muaj apo **537 ditë** pas kalimit të afatit të paraparë ligjorë.

**Dëmi i pretenduar:** I pa caktuar

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

## **19. Akuzohet gabimisht për vjedhje**

### **GjTH Ferizaj**

**Numri i lëndës:** P.nr.1798/13.

**Vepra penale:** “vjedhja”.

**Gjykatësi:** Hakile Ilazi.

**Prokurori:** Valdet Avdiu.

**I Pandehur:** Mentor Abazi.

Policia e Kosovës kishte paraqitur kallëzim penal ndaj Mentor Abazit më 30 korrik 2013. Ndërsa, Prokuroria Themelore në Ferizaj, më 6 dhjetor 2013 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj Mentor Abazit, duke e akuzuar atë për dy raste të vjedhjes, por në njërin prej tyre, ka rezultuar se aktakuza ishte ngritur gabimisht ndaj tij.

Në aktakuzën e parë, ai akuzohej për vjedhjen e disa gypave të metalit, e që për këtë veprë kishte pranuar fajësinë, ndërsa për aktakuzën e dytë të ngritur më 22 maj 2014, për vjedhje të një portofoli, ai ishte deklaruar i pafajshëm, duke mohuar aktakuzën ndaj tij

Personi ndaj të cilit kishte ngritur aktakuzë Prokuroria Themelore në Ferizaj, kishte të njëjtin emër dhe mbiemër me personin që po akuzohej në këtë seancë, por adresa e vendbanimit dhe data e lindjes ishin të ndryshme. Këto të dhëna nuk ishin identifikuar në seancën fillestare nga prokurorja Mimoza Sylja dhe gjykatësja Hakile Ilazi.

Prokurori Valdet Avdiu, që ka përfaqësuar lëndën në këtë seancë, pasi i kishte marrë të dy aktakuzat, kishte arritur në përfundimin se janë dy persona të ndryshëm, por që kanë rastisur të jenë me emër të njëjtë.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më 5 tetor 2018, i akuzuari Abazi, është liruar nga gjykimi për akuzën me të cilin ai ishte ngarkuar gabimisht, derisa për rastin e vjedhjes që e kishte pranuar fajësinë, ai është dënuar me pesë muaj burgim me kusht dhe 200 euro gjobë. Por, ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen veprë tjetër penale brenda një viti.<sup>87</sup>

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PTh në Ferizaj kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë më 22 maj 2014, me të cilën gabimisht e kishte ngarkuar të akuzuarin Mentor Abazi, me veprën penale të vjedhjes. E se aktakuza ishte ngritur gabimisht është kuptuar në seancën fillestare të mbajtur lidhur me këtë rast më 21 shtator 2018.

Shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale është mbajtur më 21 shtator të vitit 2018 , pasi që nga ngritja e aktakuzës kishin kaluar **1,582 ditë**.

**Dëmi i pretenduar:** I pa caktuar

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<sup>87</sup> “ *Pas-dy-seancave-gjyqesore-gjykata-e-prokuroria-ne-ferizaj-gjejne-se-personi-gabimisht-po-akuzohej-per-njerin-rast-te-vjedhjes*”. Betimi për Drejtësi. 5 tetor 2018 ( Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-dy-seancave-gjyqesore-gjykata-e-prokuroria-ne-ferizaj-gjejne-se-personi-gabimisht-po-akuzohej-per-njerin-rast-te-vjedhjes>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

## **20. Akuzohet sërish për veprën penale për të cilën ishte dënuar një herë**

**GjTH Pejë, dega në Istog**

**Numri i lëndës:** P.nr.189/19.

**Vepra penale:** “ndryshimi i njehsorit të shërbimeve”, “lidhja e paautorizuar në shërbime”.

**Gjykatësi:** Arben Mustafaj.

**Prokurori:** Lumturije Vuçetaj.

**I Pandehur:** Tahir Gorqaj.

PTH në Pejë për herë të parë më 5 shkurt 2018 kishte ngritur aktakuzë kundër të akuzuarit Tahir Gorqaj, për veprën penale “ndryshimi i njehsorit të shërbimeve”. Lidhur me këtë rast, seanca fillestare ishte mbajtur më 5 qershor të këtij viti, pesë muaj pas kalimit të afatit ligjor, në Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Istog, ku i pandehuri e kishte pranuar fajësinë për veprën me të cilën ngarkohej.

Gjykatësi Gani Rugova kishte shpallur aktgjykimin më 20 korrik të vitit 2018, sipas të cilit Tahir Gorqaj u shpall fajtor dhe u dënua me gjashtë muaj burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti nuk kryen vepër të re penale brenda një viti.

Mirëpo, ky rast nuk përfundoi këtu. Për të njëjtin rast, bazuar në kallëzimin penal të 16 korrikut 2018 të parashtruar nga KEDS-i, prokurorja e Prokurorisë Themelore në Pejë, Lumturije Vuçetaj më 20 gusht 2018, kishte ngritur aktakuzë tjetër ndaj Tahir Gorqajt, për veprën penale “lidhja e paautorizuar në shërbime”.

Por në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur për herë të dytë më 21 nëntor të atij viti, në po të njëjtën gjykatë, i pandehuri Gorqaj deklaroi se ka qenë i dënuar më parë për këtë vepër, për të cilën po akuzohej përsëri.

Në rrethana të tilla, prokurorja Vuçetaj hoqi dorë nga aktakuza në fjalë, me arsyetimin se për këtë çështje penale tanimë ishte zhvilluar procedurë gjyqësore më parë dhe se asnjë person nuk mund të gjykohej dy herë për të njëjtën vepër penale.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PTH në Pejë më 20 gusht 2018, kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj të akuzuarit Tahir Gorqaj, ndonëse i njëjti më parë ka qenë i gjykuar për të njëjtën vepër penale.

Shikuar nga data e ngritjes së aktakuzës në gjykatë, seanca fillestare ishte mbajtur afërsisht dy muaj pas kalimit të afatit ligjor apo **94 ditë**. KPPRK-ja, në nenin katër të tij, e inkorporon parimin kushtetues “*ne bis in idem*”, sipas të cilit askush nuk mund të ndiqet penalisht dhe të dënohet për vepër penale, nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

**Dëmi i pretenduar:** I pa caktuar

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

## 21. Prokuroria ngrit aktakuzë ndaj personit që ka vdekur në vitin 2007

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.5436/16

**Vepra penale:** “vjedhja e shërbimeve komunale”

**Gjykatësi:** Kushtrim Shyti

**Prokuror:** Nebahate Salihu

**I pandehuri:** Avdush Gashi

Gjykata Themelore në Prishtinë më 23 korrik të vitit 2019 kishte hedhur aktakuzën e ngritur nga PTH në Prishtinë, dhe kishte pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarit për vjedhje të shërbimeve komunale, Avdush Gashi.<sup>88</sup>

Ky vendim ishte marrë nga gjykata pas marrjes së konfirmimeve zyrtare nga Policia e Kosovës dhe nga Shërbimi i Gjendjes Civile se i akuzuari Gashi kishte vdekur qysh më 18 janar të vitit 2007.

PTH në Prishtinë e akuzonte Gashin se ai më 16 dhjetor 2015, në shtëpinë e tij në fshatin “Hajvali”, Komuna e Prishtinës, kishte shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, duke bërë anashkalimin e njësisë matëse-njehsorit elektrik dhe duke bërë lidhje direkte jashtë pikës matëse pa autorizimin e furnizuesit përkatës, KEDS-it.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PTH në Prishtinë më 14 qershor 2016 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar ndaj të akuzuarit Gashi nga zyra ligjore e KEDS-it.

Më pas, kjo prokurori më 20 dhjetor 2016 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj të akuzuarit Gashi, pa zbatuar veprime hetimore.

Edhe përkundër faktit që kodi i procedurës penale në par.2 të nenit 101 ka krijuar bazën ligjore që prokurorët të ngrisin aktakuza të drejtpërdrejta për veprat e dënueshme deri në 3 vjet burgim, pa zbatuar hetime,<sup>89</sup> kjo zgjidhje në praktikë ka krijuar situata të pakëndshme, ashtu që në cilësinë e të akuzuarve kanë përfunduar edhe personat që kishin vdekur shumë kohë para ngritjes së aktakuzës. Kjo për arsye se në këto raste, ngritja e aktakuzës pa zhvilluar fare hetime është bërë tanimë parim.

Ndërsa, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte ndërmarrë veprime procedurale për zgjidhjen e këtij rasti vetëm pasi kishin më shumë se dy vite e gjysmë nga ngritja e kësaj aktakuze. Pra,

---

<sup>88</sup> “Prokuroria ngrit aktakuzë ndaj personit që ka vdekur në vitin 2007, gjykata pushon procedurën penale”, Betimi për Drejtësi, 23 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrit-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-ne-vitin-2007-gjykata-pushon-proceduren-penale/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>89</sup> Kodi i procedurës penale, par. 2 i nenit 101 “Kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një vepër penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim, dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi”

kjo gjykatë më 18 korrik kishte caktuar shqyrtimin fillestar, ku kishte munguar i akuzuari Gashi.

Pra caktimi i kësaj seance fillestare në korrik të këtij viti, edhe pse aktakuza ishte ngritur në dhjetor të vitit 2016, sërish vë në pah tendencën e gjykatës për mos respektimin e afateve ligjore të përcaktuara me KPPRK-në.

Nëse krahasojmë kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor që nga ngritja e aktakuzës më 20 dhjetor 2016 e deri në pushimin e kësaj procedure penale më 23 korrik 2019, del se ky gjykim mori epilogun e tij pas më shumë se **946 ditëve**.

**Dëmi i pretenduar:** 452.36 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë



## 22. Akuzohet për vjedhje rryme personi që ka vdekur në vitin 2010

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.4118/16

**Vepra penale:** “vjedhja e shërbimeve komunale”

**Gjykatësi:** Adnan Isufi

**Prokuror:** Rrahim Podvorica

**I pandehuri:** Adem Shabani

Gjykata Themelore në Prishtinë më 15 korrik 2019 kishte marrë vendim për pushimin e procedurës penale ndaj të akuzuarit për vjedhje të shërbimeve komunale, Adem Shabani, pasi ishte konstatuar se ai kishte vdekur në vitin 2010.<sup>90</sup>

PTH në Prishtinë e ka akuzuar Shabanin se që nga data e pavërtetuar e deri më 27 janar 2014, në shtëpinë e tij në Prishtinë, me qëllim të fshehjes se keqpërdorimeve dhe shmangies së pagesës së energjisë elektrike të cilën e kishte shpenzuar pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, ka manipuluar pllombat shtetërore si dhe numëruesin e njehsorit.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTH në Prishtinë më 4 mars 2014 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar ndaj të akuzuarit Shabani nga ana e KEDS-it. Prokuroria për këtë rast nuk kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, por më 27 shtator 2016 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj të akuzuarit Shabani.

Pra edhe në këtë rast, prokuroria ka vepruar konform par.2 të nenit 101 duke ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë pa zbatuar veprime hetimore, ngase për këtë vepër penale parashihej dënim me gjobë dhe me burgim deri në tri vite.

Pas ngritjes së aktit akuzues, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte caktuar shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale më 15 korrik të këtij viti, për afërsisht tre vite pas ngritjes së kësaj aktakuze. Ky veprim i vonuar i ndërmarrë nga gjykata është në kundërshtim të plotë me par.4 të nenit 242 të përcaktuar KPPRK-ja për mbajtjen e shqyrtimit fillestar, ku shprehimisht përcaktohet afati 30 ditë për mbajtjen e tij pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë.

Nëse analizojmë datën e ngritjes së aktakuzës në gjykatë, që është 27 shtator 2016 dhe ditën kur është marrë vendimin për hedhje të kësaj aktakuze, 15 korrik 2019, vërejmë se kësaj gjykate i janë dashur **1022** ditë për ta përfunduar këtë gjykim.

**Dëmi i pretenduar:** 162.93 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

---

<sup>90</sup> “Prokuroria ngritë aktakuzë për vjedhje të shërbimeve komunale ndaj personit që ka vdekur në vitin 2010”, Betimi për Drejtësi, 15 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrite-aktakuze-per-vjedhje-te-sherbimeve-komunale-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-ne-vitin-2010/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

### **23. Aktakuzë për vjedhje rryme ndaj personit që kishte vdekur në vitin 2005**

**GjTH në Mitrovicë.**

**Numri i lëndës:** P.nr.331.2018

**Vepra penale:** “vjedhja e shërbimeve komunale”.

**Gjykatësi:** Bekim Veliqi.

**Prokurori:** Sllobodan Bakiq

**I Pandehur:** Bedri Fazliu

PTh në Mitrovicë, më 25 prill të vitit 2018, ka ngritur aktakuzë kundër Bedri Fazliut, duke e ngarkuar me veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”.

Kësaj aktakuze, i kishte paraprirë kallëzimi penal i KEDS-it i 12 dhjetorit 2017, kundër të pandehurit Bedri Fazliu, nën dyshimin për kryerjen e veprës penale “vjedhja e shërbimeve komunale”.

Aktakuza e ngarkon Fazliun se veprën penale e ka kryer në qershor të vitit 2017. Por, nga dokumentet zyrtare, del se personi ndaj të cilit është ngritur aktakuzë, ka vdekur në vitin 2005. Policia e Kosovës, përmes një shkrese e kishte njoftuar Gjykatën Themelore në Mitrovicë, se i akuzuari në fjalë kishte ndërruar jetë më 17 maj të vitit 2005, me ç’rast të njejtimit njoftim i kishin bashkëngjitur edhe çertifikatën e vdekjes.

Policia më pas janë drejtuar në sektorin e gjendjes civile në Mitrovicë, dhe kanë marrë konfirmimin për vdekjen e të akuzuarit të Prokurorisë, Bedri Fazliut, më 15 maj 2005, të cilit njoftim thuhet se i kanë bashkëngjitur edhe çertifikatën e vdekjes. Gjykatësi i rastit, Bekim Veliqi ka thënë për “Betimi për Drejtësi” se pas këtyre informatave ai e ka pushuar procedurën penale në këtë rast.<sup>91</sup>

#### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

Lidhur me këtë rast PTh në Mitrovicë më 25 prill të vitit 2018 kishte ngritur aktakuzë ndaj një personi për veprën penale e cila dyshohej të ishte kryer në vitin 2017, derisa rezulton se personi i akuzuar kishte ndërruar jetë në vitin 2005, apo **12 vite e 11 muaj** para se te ngritej aktakuza.

**Dëmi i pretenduar:** I pa caktuar

**Sekuestrimit dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>91</sup>” *Prokuroria-ne-mitrovice-ngrite-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-para-13-vjetesh*”. Betimi për Drejtësi . 25 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-prokuroria-ne-mitrovice-ngrite-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-para-13-vjetesh>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

## 24. Pas rigjykimit i zbutet dënimi me burgim të akuzuarit për vjedhje të rëndë

### GjTh në Prishtinë

**Numri i lëndës:** P.nr.1794/19

**Vepra penale:** “Vjedhje e rëndë”

**Gjykatësi:** Adnan Isufi

**Prokuror:** Merita Shala-Muhaxhiri

**I pandehur:** Hidajet Haxholli

Pas kthimit të rastit në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë më 27 qershor 2019 kishte shqiptuar dënim burgimi prej tre viteve dhe 3400 euro gjobë ndaj të akuzuarit për pesë raste të vjedhjes së rëndë, Hidajet Haxholli, dënim ky më i ulët se sa ai i shqiptuar në gjykimin e parë.<sup>92</sup>

Fillimisht, ndaj Haxhollit, kjo gjykatë më 6 mars 2019, kishte shqiptuar një dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër viteve dhe katër mijë euro gjobë, pasi ai ishte shpallur fajtorë për tri raste të vjedhjes, ndërsa për dy raste në mungesë të provave ishte liruar nga akuza.<sup>93</sup>

Mirëpo, Gjykata e Apelit e kishte kthyer këtë lëndë në rigjykim në maj të këtij viti për dy vepra penale për të cilat ai ishte shpallur fajtorë, ato nën pikën I dhe V të këtij aktgjykimi, ndërsa ishte vërtetuar aktgjykimi sa i përket veprës së tretë penale, të përfshirë në pikën IV të këtij aktgjykimi.

Apeli kishte konstatuar se ky aktgjykim, sa i përket pjesës dënuese nën pikën I dhe V të dispozitivit ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, shkelje këto që kanë determinuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë në këto pjesë.

Në këtë rast ka qenë i akuzuar edhe Fatos Abazi, mirëpo për të njëjtin ish-in pezulluar hetimet më 3 janar 2019 nga ana e prokurorisë, me arsyetimin se ai gjendej në arrati.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTH në Prishtinë kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar ndaj të akuzuarit Haxholli më 10 tetor 2018, ndërsa vepra penale e përfshirë në pikën V të aktit akuzues, dyshohet të jetë kryer më 7 mars 2016.

Kjo situatë ngre dyshime se si ky kallëzim penal ka qëndruar në sirtarët e policisë për 948 ditë, apo 2 vjet e shtatë ditë që nga dita kur supozohet se është kryer kjo vepër penale.

Aktvendimi për fillim të hetimeve rezulton të jetë nxjerrë në po të njëjtën ditë me pranimin e kallëzimit penal.

---

<sup>92</sup> “Pas rigjykimit, i akuzuari për tri raste të vjedhjes dënohet me tre vjet burg dhe 3400 euro gjobë”, Betimi për Drejtësi, 27 Qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-i-akuzuari-per-tri-raste-te-vjedhjes-denohet-me-tre-vjet-burg-dhe-3400-euro-gjobe/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>93</sup> “I akuzuari dënohet me 4 vjet burg pasi shpallet fajtor për tri nga pesë rastet e vjedhjeve në Fushë Kosovë”, Betimi për Drejtësi (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-denohet-me-4-vjet-burg-pasi-shpallet-fajtor-per-tri-nga-pese-rastet-e-vjedhjeve-ne-fushe-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

Ndërsa, aktakuza për vjedhje të rëndë ndaj Haxhollit ishte ngritur më 3 janar 2019, dhe cila rezulton të jetë ngritur brenda afatit ligjor të përcaktuar me par.1 të nenit 159 i cili rregullon kohëzgjatjen e hetimeve.

GjTh në Prishtinë kishte caktuar shqyrtimin fillestar ndaj Haxhollit më 29 janar 2019, veprim ky i ndërmarrë në përputhje të plotë me afatin e përcaktuar me KPPRK për mbajtjen e kësaj seance pas ngritjes së aktakuzës.

Tutje, rrjedha e këtij procesi gjyqësor ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor, me dëgjimin e të dëmtuarve, dëshmitarëve, dhe ky proces mori epilogun në 6 mars të këtij viti.

Nëse krahasojmë intervalin kohor që prej ngritjes së aktakuzës më 3 janar 2019 e deri më 6 mars kur edhe ka përfunduar gjykimi në shkallë të parë, rezulton se kësaj gjykate i janë dashur plot **63** ditë për përfundimin e këtij procesi gjyqësor.

**Dëmi i pretenduar:** 1.500 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

## 25. Dy vjet burgim me kusht për vjedhje të akumulatorit

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.2832/17

**Vepra penale:** “Vjedhja e rëndë”

**Gjykatësi:** Fatime Dërmaku

**Prokuror:** Fatmir Behrami

**Të pandehur:** Granit Simnica, Flamur Stublla.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 30 maj 2019 kishte shpallur fajtorë dy të akuzuarit për vjedhje të akumulatorit, Granit Simnica dhe Flamur Stublla dhe ndaj tyre kishte shqiptuar burgim me kusht në kohëzgjatje prej dy viteve dhe nga 300 euro për secilin.<sup>94</sup>

Prokuroria i akuzonte Simnicën dhe Stubllën se më 9 mars 2016, rreth orës 23:00, në Prishtinë, në rrugën “Sali Nivica”, se pas marrëveshjes paraprake mes tyre, me përdorimin e forcës kanë hapur pjesën e përparme të veturës së tipit “Golf II”, pronë e tani të dëmtuarit Astrit Miftari dhe nga aty kanë arritur të marrin akumulatorin në vlerë prej 70 euro, me ç’rast i kanë shkaktuar atij dëm të konsiderueshëm material.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 12 maj 2017 kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve ndaj të pandehurve Simnica dhe Flamur Stublla.

Ndërsa, aktakuzën ndaj tyre kjo prokurori e kishte ngritur më 15 qershor 2017, apo 34 ditë pas fillimit të hetimeve, veprim ky i ndërmarrë konform nenit 159 të KPPRK-së, i cili parasheh që hetimet duhet të përfundojnë brenda dy viteve.<sup>95</sup>

Ndërsa, seanca fillestare në këtë rast ishte caktuar më 30 maj 2019, apo 715 ditë pas ngritjes së aktakuzës pranë kësaj gjykate.

Ky veprim i vonuar i gjykatës është në kundërshtim të plotë me par.4 të nenit 242 të KPPRK-së, sipas të cilit, gjykata është e obliguar që të caktojë shqyrtimin fillestar brenda 30 dite nga ngritja e aktakuzës.<sup>96</sup>

Shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale nuk ishte mbajtur pasi që dy të akuzuarit kishin pranuar fajësinë qysh në këtë seancë fillestare.

---

<sup>94</sup> “Dënohen me dy vjet burgim me kusht të akuzuarit që pranuan se vodhën akumulatorin e 70 eurove”, Betimi për Drejtësi, 30 Maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/denohen-me-dy-vjet-burgim-me-kusht-te-akuzuarit-qe-pranuan-se-vodhen-akumulatorin-e-70-eurove/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>95</sup> Kodi i procedurës penale, par.1 i nenit 159 “Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet”.

<sup>96</sup> Po aty, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

Në aspektin e kohëzgjatjes së këtij procesi që nga ngritja e aktakuzës më 15 qershor 2017, e deri në shpalljen e aktgjykimit më 20 maj të këtij viti, del se gjykatës i janë dashur një vit e 11 muaj për t'i dhënë fund këtij gjykimi në shkallë të parë.

**Dëmi i pretenduar:** 70 euro.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë

## 26. Dënohet i akuzuari që u prezantua rrejshëm si djali i Sami Lushtakut

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.1839/16

**Vepra penale:** “mashtrimi”

**Gjykatësi:** Hanefi Jashari

**Prokuror:** Musa Mehaj

**Të pandehur:** Ramadan Bunjaku

Gjykata Themelore në Prishtinë më 13 shkurt 2019 kishte shpallur fajtorë të akuzuarin për mashtrim, Ramadan Bunjaku, duke e dënuar me një vit burgim efektiv dhe 800 euro gjobë.<sup>97</sup>

Ky aktgjykim ishte shpallur pasi i akuzuari Bunjaku në seancë fillestare kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

PTh në Prishtinë e akuzon Bunjakun se ka vënë në lajthim Ministrin e Ministrisë së Mbrotjtjes së Republikës së Kosovës, Rustem Berisha, si dhe persona tjerë, duke u prezantuar rrejshëm si i biri i Sami Lushtakut, e më pas si ushtar i UÇK-së, dhe njëkohësisht si invalid i luftës, e duke u marrë atyre të holla kinse për shërimin e nënës së tij, pastaj para për varrimin e nënës së tij, apo se kinse babai i tij Sami Lushtaku gjendet në burgun e Dyzit dhe nuk qëndron mirë financiarisht, pasi që sipas tij i ka të bllokuara xhirollogaritë bankare dhe se familja e tij duhet ti jep 50.000 euro kaucion, që Lushtaku të lirohet dhe të shkoj në spital.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 6 shkurt 2016 kishte pranuar kallëzimin penal të ngritur ndaj Ramadan Bunjakut nga ana e Policisë së Kosovës dhe po të njejtën ditë prokuroria kishte nxjerrë edhe aktvendim për fillim të hetimeve.

Aktakuza që e ngarkon Bunjakun për mashtrim në vazhdimësi ishte ngritur më 21 prill 2016, apo kur kishin kaluar më shumë se dy muaj nga nxjerrja e vendimit për fillim të hetimeve, duke respektuar në përpikmëri afatin e përcaktuar me KPPRK-në.

Ndërsa, shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur vetëm më 13 shkurt 2019, apo dy vjet e nëntë muaj pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë.

Ky veprim i vonuar i ndërmarrë nga kjo gjykatë paraqet një shkelje serioze të par.4 të nenit 242 të KPPRK-së, ku shumë qartë precizohet se shqyrtimi fillestar caktohet brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës.<sup>98</sup>

---

<sup>97</sup> “Dënohet me burg dhe gjobë i akuzuari që përfitoi para duke u prezantuar rrejshëm si ushtar i UÇK-së dhe si i biri i Sami Lushtakut”, Betimi për Drejtësi, 13 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-burg-dhe-gjobe-i-akuzuari-qe-perfitoi-para-duke-u-prezantuar-rrejshem-si-ushtar-i-uck-se-dhe-si-i-biri-i-sami-lushtakut/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>98</sup> Kodi i procedurës penale, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

Pra, fakti se ky proces gjyqësor mori epilogun e tij kur kishin kaluar **1029 ditë**, apo gati tri vjet që nga ngritja e aktakuzës, shpërfaq një jo efikasitet të sistemit gjyqësor që të procedojë në kohë në zgjidhjen e rasteve.

Zvarritja në procedimin e rasteve është një praktikë shumë e rrezikshme që cenon parimin e sigurisë juridike të qytetarëve dhe ndikon në uljen e besimit të publikut në punën e sistemit gjyqësor, kur kuptohet se është nevojitur një kohë kaq e gjatë në gjykimin e një rasti në dukje të thjeshtë për tu zgjidhur.

Andaj, IKD konsideron se është detyrë e sistemit të drejtësisë që tu ofroj mbrojtje efikase çdo qytetari i cili mund të bie viktimë e veprimeve mashtruese të tilla si ato të ndërmarra nga i akuzuari Bunjaku, dhe sikur ligji të vepronte me kohë do të parandalohet viktimizimi i personave të tjerë nga veprime të ngjashme.

**Dëmi i pretenduar:** 1092 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.



## 27. Dënohen me burg të akuzuarit për fajde

**GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.59/19

**Vepra penale:** “fajdeja”

**Gjykatësi:** Alban Ajvazi

**Prokuror:** Ajshe Ferati

**Të pandehur:** Nazmi Gashi, Ragip Fazlija, Avni Fazlija

Gjykata Themelore në Prishtinë më 3 qershor 2019 kishte shpallur fajtorë dy të akuzuarit për fajde, Nazmi Gashi dhe Avni Fazlija, ndërsa kishte liruar nga akuzat për këtë veprë penale të akuzuarin e tretë Ragip Fazlija.

Ndaj të akuzuarit Nazmi Gashi, ishte shqiptuar dënimi me dy vjet e gjashtë muaj burgim, ndërsa i akuzuari Avni Fazlija, është dënuar me dy vjet burgim.<sup>99</sup>

Prokuroria i ngarkon të akuzuarit Ragip Fazlija, Nazmi Gashi dhe Avni Fazlija, se nga janari i vitit 2018, e deri më 23 tetor 2018, në Prishtinë, kanë pranuar dhe kontraktuar një shumë dukshëm jo proporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për të dëmtuarin Xhevdet Uka, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të tij.

Në aktakuzë thuhet se i dëmtuari Xhevdet Uka në fillim të janarit 2018, kishte marrë para me fajde nga i akuzuari Ragip Fazlija, në vlerë prej 2000 euro, duke e obliguar të dëmtuarin që deri në kthimin e borxhit total të paguaj nga 400 euro, në çdo dy javë, ashtu që i akuzuari Nazmi Gashi deri më 23 tetor 2018, paratë e pranuar nga i dëmtuari në vlerë prej 8000 euro ia ka dorëzuar të akuzuarve Ragip dhe Avni Fazlija, kurse deri në fund të tetorit, i akuzuari Nazmi Gashi, e ka detyruar që t'i paguaj në emër të borxhit për fajde edhe 7700 euro.

Gjithnjë sipas aktakuzës, nëse i dëmtuari vonohej në pagesën e këstit, kishte për të paguar deri në 100 euro për çdo ditë, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

### Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 31 tetor 2018 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj Nazmi Gashit, Avni dhe Ragip Fazlisë. Ndërsa, aktvendimin për fillim të hetimeve kjo prokurori e kishte nxjerrë më 18 dhjetor 2018, apo 49 ditë pas pranimin të këtij kallëzimi nga policia.

Aktakuza ndaj tre të akuzuarve për fajde ishte ngritur më 16 janar 2019, apo 30 ditë nga nxjerrja e vendimit për fillim të hetimeve, dhe ky veprim ishte ndërmarrë konform par.1 dhe 2 të nenit 159 të KPPRK-së, i cili rregullon afatet kohore për zhvillim të hetimit.<sup>100</sup>

---

<sup>99</sup> “Dënohen me mbi katër vjet burg dhe gjashtë mijë euro gjobë dy të akuzuarit për fajde, i treti shpallet i pafajshëm”, Betimi për Drejtësi, 3 Qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-mbi-kater-vjet-burg-dhe-gjashte-mije-euro-gjobe-dy-te-akuzuarit-per-fajde-i-treti-shpallet-i-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

Seanca e shqyrtimit fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 4 mars 2019, apo 48 ditë pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë. Ky veprim i ndërmarrë nga gjykata për mbajtjen e seancën fillestare bie ndesh me par.4 të nenit 242 ku përcaktohet caktimi i kësaj seance brenda 30 dite nga ngritja e aktit akuzues.<sup>101</sup>

Shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale është mbajtur më 17 prill 2019, apo 45 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me ç'rast është tejkaluar afati ligjor i paraparë me par.5 të nenit 245 të KPPRK-së, ku përcaktohet se kjo seancë duhet të mbahet jo më herët se tridhjetë ditë dhe jo më vonë se dyzet ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë ditë nga shqyrtimi fillestar”.<sup>102</sup>

Ky proces gjyqësor, marrë parasysh ngritjen e aktakuzës më 16 janar 2019 dhe 3 qershorin e këtij viti kur gjykata kishte shpallur aktgjykimin dënues ndaj tre të akuzuarve, del se kishte përfunduar brenda 139 ditëve.

**Dëmi i pretenduar:** 15.700 euro

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

---

<sup>100</sup> Kodi i procedurës penale, par.1 dhe 2 i nenit 159 “1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet. 2. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim deri në gjashtë (6) muaj të hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme”.

<sup>101</sup> Po aty, par.4 i nenit 242 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

<sup>102</sup> Po aty, par.5 i nenit 246 “Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar.

## **28. Një vit e gjysmë burgim ndaj të akuzuarit që la të vdekur këmbësorin në Bardhosh**

### **GjTh në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.1496/19

**Vepra penale:** “rrezikimi i trafikut publik”

**Gjykatësi:** Kujtim Krasniqi

**Prokuror:** Musa Mehaj

**Të pandehur:** Besnik Maliqi

Gjykata Themelore në Prishtinë më 6 maj 2019 kishte dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim të akuzuarin për rrezikim të trafikut publik, Besnik Maliqi.<sup>103</sup>

Ky aktgjykim ishte shpallur pasi i akuzuari Maliqi, paraprakisht në seancë fillestare e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë që i ngarkohej.

PTh në Prishtinë e ka akuzuar Maliqin se ai më 3 prill 2019 në rrugën nacionale Prishtinë-Podujevë, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit, dhe me pjesën e përparme ballore të anës së veturës e tij e ka goditur këmbësorin, tani të ndjerin N.G, i cili në momentin e aksidentit ishte duke e kaluar rrugën nga ana e majtë në anën e djathtë, me ç’rast i ndjeri më 3 prill 2019 ndërron jetë në spital si pasojë e lëndimeve të marra nga ky aksident.

### **Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit**

PTh në Prishtinë më 3 prill 2019 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar ndaj Maliqit nga ana e Policisë së Kosovës, ndërsa aktvendimin për fillim të hetimeve kjo prokurori e ka nxjerrë një ditë më vonë, pra më 4 prill 2019.

Ndërsa aktakuza ndaj Maliqit për rrezikim të trafikut publik është ngritur më 26 prill 2019, apo 22 ditë pas fillimit të hetimeve, veprim ky i ndërmarrë në përputhje me par.1 të nenit 159 të KPPRK-së, ku përcaktohen afatet kohore sa i përket kohëzgjatjes së hetimeve. Në mënyrë decisive aty është përcaktuar se hetimi parimisht zgjat dy vite, me mundësi të vazhdimit edhe për gjashtë muaj sipas autorizimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.<sup>104</sup>

Shqyrtimi fillestar ndaj Maliqit ishte mbajtur më 3 maj të këtij viti, apo 8 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Ky veprim i ndërmarrë nga gjykata ishte bërë në përputhje me par.4 të nenit 242 të KPPRK-së, ku përcaktohet obligimi i gjykatës që të caktojë shqyrtimin fillestar brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë.

---

<sup>103</sup> “Një vit e gjashtë muaj burg ndaj të akuzuarit që pranoi fajësinë për aksidentin në Bardhosh, ku humbi jetën këmbësori”, Betimi për Drejtësi (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-vit-e-gjashte-muaj-burg-ndaj-te-akuzuarit-qe-pranoi-fajesine-per-aksidentin-ne-bardhosh-ku-humbi-jeten-kembesori/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2019)

<sup>104</sup> Kodi i procedurës penale, par.1 dhe 2 i nenit 159 “1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet. 2. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim deri në gjashtë (6) muaj të hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme”.

Nëse analizojmë kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor, që nga ngritja e aktakuzës më 26 prill 2019 e deri në shpalljen e këtij aktgjykimi më 6 maj 2019, del se ky gjykim kishte marrë epilogun brenda nëntë ditëve nga ngritja e aktit akuzues.

**Dëmi i pretenduar:** I pacaktuar.

**Sekuestrimi dhe Konfiskimi:** Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

## XI. REKOMANDIMET

1. KGJK dhe KPK të bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse të ngarkesës së DP-ve me lëndë, në mënyrë që të kenë mundësi të ndërmarrin hapa për stabilizimin e këtyre departamenteve, veçanërisht sa i përket lëndëve të cilat barten vit pas viti.
2. KGJK dhe KPK të ri analizojnë rregulloret mbi normat orientuese, në mënyrë që të krijohen indikatorë të saktë mbi matjen e efikasitetit të secilit gjyqtar dhe prokurorë.
3. KGJK dhe KPK të harmonizojnë bazat e të dhënave të tyre në mënyrë që këto institucione të kenë të dhëna unike dhe të informohet publiku në baza mujore për progresin dhe sfidat e DP-ve të Gjykatave dhe Prokurorive.
4. KGJK dhe KPK të marrin masa ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët nuk respektojnë afatet ligjore në trajtimin e rasteve në krimet e rënda. Në këtë drejtim, KGJK dhe KPK duhet ta kenë të qartë se raportet e saja periodike shërbejnë për informim të publikut dhe për t'i mundësuar këtyre institucioneve ndërmarrjen e masave konkrete për të sanuar pasojat, dhe jo vetëm për evidentimin statistikor të fakteve.
5. KGJK të adresojë urgjentisht dukurinë e parashkrimit të rasteve.
6. Në Gjykatat e Republikës së Kosovës lëndët të ndahen dhe caktohen brenda afatit më të shkurtë kohor tek gjyqtarët, dhe mos të mbesin në administratën apo sirtarët e gjykatës për një kohë të gjatë.
7. Prokurorët mos të zvarrisin rastet për shkak të përcaktimit të kompetencës. Përcaktimi i kompetencës është aspekti i parë të cilin duhet ta vlerësojnë prokurorët, dhe këtë duhet ta bëjnë brenda një afati të arsyeshëm kohor.
8. KPK dhe KGJK të mbajnë statistika të sakta mbi kohëzgjatjen e trajtimit të një lëndë.
9. Prokurorët në aktet e tyre akuzuese të parashtrajnë kërkesë për konfiskimin e dëmit të pretenduar.
10. Gjyqtarët mos të mbyllin seancat publike në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrare, sikurse rastet që ka identifikuar IKD në monitorim.
11. Prokurorët të kenë kujdes me rastin e ngritjes së aktakuzave të drejtpërdrejta dhe ngritjen e aktakuzave në këtë mënyrë mos ta bëjnë parim për raste të caktuara.
12. Prokurorët mos të ngrisin aktakuza për vepra penale të rëndësisë së vogël.
13. Gjyqtarët të hudhin poshtë aktakuzat, të cilat ngarkojnë të pandehurit për kryerjen e veprave penale të rëndësisë së vogël.
14. Prokurorët të njoftojnë publikun për ngritjen e aktakuzave me rëndësi për opinionin publik.
15. Në rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore për shkak të mos prezencës së palëve në procedurë, gjyqtarët të shfrytëzojnë mundësitë ligjore për sigurimin e prezencës së palëve në procedurë penale.